

UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY



FAKULTETI JURIDIK
ПРАВЕН ФАКУЛТЕТ
FACULTY OF LAW

FAKULTETI JURIDIK

STUDIMET PASDIPLOMIKE - CIKLI I DYTË

TEZA:

**“Dëshmia e dëshmitarit si provë në procedurë penale në
Republikën e Maqedonisë së Veriut, edhe nga aspekti
krahases”**

KANDIDATI:

Besjan Pollozhani

MENTORI:

Prof. dr. Ismail Zejneli

Tetovë, 2020

FALËNDERIM

Falënderimet dhe lavdërimet i takojnë Zotit të Madhëruar të cilit i përulem me krenari!

“Gjëja më e bukur në botë është të shohësh prindërit e tu të buzëqeshin dhe të dish se ti je arsyëja e asaj buzëqeshjeje”

Për gjithë këtë arritje, shpreh falënderime të thella dhe të sinqerta për mentorin tim, *Prof.Dr. Ismail Zejneli*, i cili me këshillat dhe sygjërimet e tij të vyera ndihmoi për vazhdimësinë dhe përfundimin me sukses të punës sime. Përkrahja dhe mbështetja e tij e palodhshme ka filluar prej ditës së parë të fillimit të studimeve deridiplomike, e deri sot kur unë para tij e mbroj me krenari punimin tim të magjistraturës.

Falënderime të mëdha shpreh ndaj *Z.Adi Useini*, gjykatës në Gjykatën Themelore në Strugë, *Z.Xhemal Lloga*, prokuror në Prokurorinë Publike në Strugë, gjykatësin nga Departamenti për Krime të Rënda të Gjykatës Themelore në Pejë, i cili dëshironte të mbetej anonim, *Z.Ibrahim Arslanoski*, avokat në qytetin e Strugës, për kontributin dhe ndihmën e dhënë në drejtim të përfundimit të intervistave me shkrim dhe dëshmime të dëshmitarëve në praktikë, me të cilat u bë i realizueshëm dhe u finalizua punimi im i masterit. Gjithashtu, falënderoj edhe *znj. Arjeta Pollozhani*, mësuese e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe e cila realizoj edhe fazën më të rëndësishme të këtij punimi, lektorimin e temës së magjistraturës.

Falënderoj edhe drejtorin e Agjencisë për Zbatimin e Gjuhës, *Prof.Doc. Ylber Sela* i cili më ka qëndruar në ndihmë në çdo kohë dhe sidomos në fillimin e hapave të para drejt ngritjes sime profesionale.

Së fundmi, meritat dhe falënderimet e mia më të sinqerta si dhe të gjitha arritjet e mia, ua dedikoj familjarëve e në veçanti prindërve të mi fisnikë, babait *Afrim* dhe nënës *Gzime*, të cilët sakrifikuan që unë sot të përfundoj edhe këtë kapitull.

I Juaji, Besjani

LËNDA E HULUMTIMIT

Lëndë e hulumtimit të këtij punimi është dëshmia e dëshmitarit si provë në procedurë penale në Republikën e Maqedonisë së Veriut, edhe nga aspekti krahasues, duke filluar që nga aspekti historik i saj e deri tek e drejta pozitive ose bashkëkohore, gjegjësisht analizimi i aspekteve të përgjithshme që lidhen me dëshminë e dëshmitarit, siç janë: nocionet e dëshmisë dhe dëshmitarit, kushtet që duhet të plotësohen për t'u paraqitur në cilësinë e dëshmitarit, personat që mund të paraqiten në cilësinë e dëshmitarit, personat që nuk mund të paraqiten në cilësinë e dëshmitarit, të drejtat e dëshmitarit gjatë marrjes në pyetje, procedura e pyetjes së dëshmitarit, llojet e dëshmitarëve, obligimi i dëshmitarit për të dëshmuar, aspekti psikologjik në procesin e të dëshmuarit si dhe aspekte të tjera.

Dëshmia e dëshmitarit paraqet një nga provat që kërkon analizë dhe studime të thella. Në vendin tonë studime dhe analiza mbi këtë çështje hasim edhe nga hulumtime të tjera shkencore, mirëpo e njëjta nuk është analizuar edhe nga aspekti krahasues.

Pra, në këtë hulumtim shkencor kjo çështje do të analizohet edhe në aspektin krahasues, se si ky proces është i rregulluar edhe në vendet tjera, si psh. në Shqipëri dhe Kosovë. Zgjerimi i studimit dhe analizimit të dëshmisë së dëshmitarit edhe në vendet tjera, këtij punimi shkencor i jep rëndësi edhe më të veçantë, në krahasim me punimet tjera në lidhje me këtë temë.

QËLLIMET E HULUMTIMIT

Synimi kryesor i këtij hulumtimi është hartimi i një punimi shkencor me vlera akademike dhe respektimi i standardeve akademike.

Qëllimi i hartimit të këtij punimi është përmbushja e nevojave akademike me qëllim që të kalojë me sukses edhe këtë sfidë të studimeve, si dhe t'i trajtojë hollësisht të gjitha aspektet, që nga fillimi i hartimit të punimit e deri tek mbrojtja e tij para komisionit vlerësues.

Si qëllimi tjetër themelor parashtrohet edhe analizimi i procesit të të dëshmuarit në procedurë penale në vendin tonë edhe në aspekt krahasues, kështu që përmes këtij hulumtimi shkencor do të arrijmë të nxjerrim dallimet dhe ngjashmëritë ndërmjet këtyre shteteve në procesin e dëshmimit në procedurë penale, si dhe rëndësinë e dëshmisë së dëshmitarit në zbardhjen e rastit konkret dhe marrjen e një vendimi gjyqësor të drejtë dhe objektiv.

Gjatë hulumtimit të objektit të studimit do t'i përdor disa metoda, përmes të cilave shpresoj të siguroj arritjen e objektivave të hulumtimit, që i referohen dëshmisë së dëshmitarit si provë në procedurë penale.

METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Metodologjia e përdorur për përgatitjen e këtij punimi bazohet në një studim të kujdesshëm dhe hulumtim të thellë. Hulumtimi i kësaj teme është i mbështetur nga të dhëna dhe burime të ndryshme.

Duhet të potencohet se udhëzimet dhe këshillat e mentorit kanë rol të rëndësishëm në përpilimin e këtij punimi.

Materialet dhe literatura e përdorur për punimin e kësaj teze të magjistraturës kanë për qëllim të nxjerrin në pah rëndësinë e dëshmisë së dëshmitarit e cila ka një ndikim të madh në zbardhjen e plotë të një rasti të caktuar dhe sjelljen e një vendimi gjyqësor të drejtë dhe objektiv.

Metodat kryesore që janë përdorur për mbledhjen e të dhënave janë:

1. Leximi i literaturës së përshkruar më poshtë;
2. Intervistimi;
3. Të dhëna nga interneti.

Në punimin shkencor me titull: “Dëshmia e dëshmitarit si provë në procedurë penale në Republikën e Maqedonisë së Veriut, edhe në aspektin krahasues” për t’iu qasur hulumtimit kam përdorur këto metoda:

1. Metodën dogmatiko-juridike,
2. Metodën empirike apo historike.

RËNDËSIA E PUNIMIT

Punimi shkencor me titull: “Dëshmia e dëshmitarit si provë në procedurë penale në Republikën e Maqedonisë së Veriut, edhe nga aspekti krahasues” është i një rëndësie të veçantë për vetë faktin se bëhet fjalë për një materie shumë të rëndësishme me impakt të jashtëzakonshëm në jetën shoqërore.

Përveç tjerash rëndësia e këtij punimi vjen në shprehje, ngaqë trajton një ndër aspektet kyçe të së drejtës së procedurës penale, që nënkupton dëshminë e dëshmitarit në procesin penal për të arritur një pasqyrë më të qartë dhe më të saktë mbi rastin e caktuar.

Bëhet fjalë për një studim autentik, për të cilin ka nevojë literatura juridike dhe që do të shërbejë për t’ua hapur rrugën studiuesve të rinj, të cilët janë të interesuar të hulumtojnë tema të ngjashme, si dhe të kenë një pasqyrë më të qartë rreth rregullimit të kësaj çështjeje sipas legjislacionit penal të vendit tonë, si dhe të Shqipërisë dhe Kosovës.

PËRMBAJTJA

Falënderim.....	I
Lënda e hulumtimit.....	II
Qëllimet hulumtimit.....	II
Metodologjia e hulumtimit.....	III
Rëndësia e punimit.....	III
Hyrje.....	1

Kapitulli I

1.Vështrimi historik i dëshmisë së dëshmitarit në procedurë penale.....	3
1.1.Dëshmitari në procedurë penale akuzatore.....	3
1.2.Dëshmitari në procedurë penale inkuizitore.....	4
1.3.Dëshmitari në procedurë penale mikste.....	5
1.4.Dëshmitari në të drejtën zakonore shqiptare.....	5
2.Aspekte krahasimore të dëshmitarit si provë në vendet anglosaksone.....	6
2.1.Dëshmia e dëshmitarit në të drejtën angleze.....	6
2.2.Dëshmia e dëshmitarit në të drejtën e SHBA-ve.....	7
3.Nocioni i dëshmisë dhe dëshmitarit në procedurë penale.....	8

Kapitulli II

1.Dëshmia e dëshmitarit si provë në procedurë penale në Republikën e Maqedonisë së Veriut.....	10
1.1.Personat të cilët mund të paraqiten në cilësinë e dëshmitarit.....	10
1.2.Personat të cilët nuk mund të paraqiten në cilësinë e dëshmitarit.....	11
1.3.Personat të cilët janë të liruar nga obligimet për të dëshmuar.....	13
1.4.Dëshmitari pamor (okular).....	13
1.5.Dëshmitari sipas dëgjimit.....	14
2.Vetitë e deklaruesit të cilat mund të ndikojnë në dëshmi të dëshmitarit.....	14
2.1.Vetitë biologjike të cilat mund të ndikojnë në dëshmi të dëshmitarit.....	15
2.1.1.Mosha e dëshmitarit si veti biologjike.....	15
2.1.2.Gjinia e dëshmitarit si veti biologjike.....	16
2.2.Vetitë psikike dhe fizike të cilat ndikojnë në dëshmi të dëshmitarit.....	17
2.2.1.Vetitë psikike.....	17

2.2.2. Vetitë fizike.....	17
2.3. Ndikimi i ambientit të dëshmitarit të marë në pyetje.....	18
2.3.1. Familja, rrethi fqinjësor dhe i punës.....	18
2.3.2. Arsimimi.....	29
2.4. Ndikimi i mjeteve të informacionit masiv në formimin e deklaratës së dëshmitarit.....	20
3. Thirrja e dëshmitarit për të dëshmuar.....	21
3.1. Metoda e marrjes në pyetje e dëshmitarit.....	22
3.1.1. Pyetjet direkte ose të drejtpërdrejta.....	23
3.1.2. Pyetjet e kryqëzuara.....	24
3.1.3. Pyetjet plotësuese.....	25
3.2. Dhënia e dëshmisë së rrejtshme.....	25
3.3. Ballafaqimi i dëshmitarëve.....	27
4. Mbrojtja e dëshmitarëve të rrezikuar.....	27
4.1. Mbrojtja e dëshmitarëve të rrezikuar në procedurë paraprake.....	28
4.2. Mbrojtja e dëshmitarëve të rrezikuar në seancën kryesore.....	29
4.2.1. Marrja në pyetje nën pseudonim.....	30
4.2.2. Marrja në pyetje duke përdorur pajisje teknike për transmetimin e imazhit dhe tonit.....	30
4.2.3. Marrja në pyetje e viktimave dhe dëshmitarëve, posaçërisht atyre të pambrojturve.....	31

Kapitulli III

Shqyrtimi i dëshmisë së dëshmitarit si provë në procedurë penale të Shqipërisë

1. Dëshmia e dëshmitarit si provë në procedurë penale të Shqipërisë.....	33
1.1. Personat të cilët mund të merren në pyetje si dëshmitarë në bazë të nenit 156 të KPP-së të Shqipërisë.....	33
1.2. Personat të cilët nuk detyrohen që të dëshmojnë sipas KPP-së të Shqipërisë.....	34
1.3. Ruajtja e sekretit profesional.....	34
1.4. Ruajtja e sekretit shtetëror.....	35
1.5. Përfshirja e sekretit.....	35
2. Thirrja e dëshmitarit për të dëshmuar.....	36
2.1. Procedura e marrjes në pyetje të dëshmitarit.....	36
2.1.1. Pyetja e dëshmitarëve të mbrojtur.....	38

2.1.2. Dëshmitari me identitet të fshehur.....	39
2.1.3. Pyetja e dëshmitarëve të mitur.....	40
2.1.4. Përgjegjësia për dëshmi të rreme ose refuzimi për të dëshmuar.....	41
2.2. Marrja e dëshmisë së nënpunësve diplomatikë.....	42
2.3. Ballafaqimi i dëshmitarëve.....	43
Shqyrtimi i dëshmisë së dëshmitarit si provë në procedurë penale të Kosovës	
1. Dëshmia e dëshmitarit si provë në Procedurë Penale të Kosovës.....	43
1.1. Dëshmitarët e privilegjuar.....	44
1.2. Dëshmitarët okularë.....	46
1.3. Dëshmitarët sipas dëgjimit.....	46
1.4. Dëshmitarët bashkëpunues.....	47
1.4.1. Kërkesa për shpalljen e personit dëshmitar bashkëpunues.....	48
1.4.2. Procedura për shpalljen e personit dëshmitar bashkëpunues.....	48
1.4.3. Revokimi i shpalljes si dëshmitar bashkëpunues.....	49
2. Marrja e dëshmisë së dëshmitarit në procedurë paraprake- fazën e hetimit.....	50
2.1. Kushtet e përgjithshme për marrjen në pyetje në procedurë paraprake, marrjen e deklaratës në procedurë paraprake ose mundësinë hetuese të veçantë sipas nenit 130 të KPP-së.....	52
2.1.1. Marrja në pyetje në procedurë paraprake sipas nenit 131 të KPP-së.....	52
2.1.2. Marrja e deklaratës në procedurë paraprake sipas nenit 132 të KPP-së.....	53
3. Thirrja e dëshmitarit për të dëshmuar në procedurë penale kryesore.....	54
3.1. Procedura e marrjes në pyetje të dëshmitarit.....	54
3.1.1. Marrja e drejtpërdrejtë në pyetje e dëshmitarëve.....	56
3.1.2. Marrja e tërthortë në pyetje e dëshmitarëve.....	57
3.1.3. Rimarrja në pyetje.....	58
3.2. Përdorimi i dëshmisë së mëparshme të dëshmitarit.....	58
3.3. Leximi i deklaratave të tjera të dhëna më parë.....	59
3.4. Ballafaqimi i dëshmitarëve.....	60
4. Mbrojtja e dëshmitarëve.....	60
4.1. Kërkesa për masë mbrojtëse ose anonimitet.....	61
4.1.1. Urdhri për masa mbrojtëse.....	61
4.1.2. Urdhri për anonimitet nga publiku.....	62
4.1.3. Urdhri për anonimitet prej të pandehurit.....	63

Kapitulli IV

1.Raste nga praktika të dëshmimeve të dëshmitarëve.....	65
--	-----------

INTERVISTA ME SHKRIM

1.Intervistë me shkrim me gjykatësin Adi Useini nga Gjykata Themelore në Strugë lidhur me dëshminë e dëshmitarit në procedurë penale.....	70
2.Intervistë me shkrim e realizuar me prokurorin Xhemal Lloga nga Prokuroria Publike në Strugë lidhur me dëshminë e dëshmitarit si provë në procedurë penale.....	73
3.Intervistë me shkrim me gjykatës nga Departamenti për Krime të Rënda të Gjykatës Themelore në Pejë lidhur me dëshminë e dëshmitarit në procedurë penale.....	76
4.Intervistë me shkrim me gjykatësin Ervin Sulaj nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë lidhur me dëshminë e dëshmitarit në procedurë penale.....	77
Përfundim	80
Literatura	83

HYRJE

Kriminaliteti si fenomen i ndërlikuar ka ekzistuar prej në të kaluarën dhe ende vazhdon të shfaqet në përmasa edhe më të mëdha. Format e shfaqjes dhe manifestimit të tij gjatë tërë rrjedhës së historisë njerëzore janë nga më të ndryshmet. Edhe pse ekziston një numër i madh i dispozitave juridike të cilat janë të inkorporuara në legjislacionet penale për ndëshkimin e veprimeve të kundërligjshme, ato përsëri shfaqen dhe në vazhdimsi po ndërmerren veprime kriminale në shoqëri, ku për këtë arsye angazhimi i organeve kompetente për parandalimin e kriminalitetit si dhe risocializimin e kryerësve të atyre krimeve, paraqitet si synim kryesor.

Ky interesim i organeve është shfaqur prej në të kaluarën dhe po vazhdon edhe në ditët e sotme, me ndërmarrjen e masave adekuate për parandalimin e këtij fenomeni ose dukurie që ndikon negativisht në shoqëri.

Interesi kryesor në çdo sistem juridik është vërtetimi i së vërtetës në procedurë penale, interes i cili paraqet një proces të vështirë për gjykatën që të arrijë deri në vërtetimin e çështjes konkrete penale. E vërteta në procedurë penale nënkupton vërtetimin e plotë të të gjitha fakteve relevante juridike nga të cilat varet zbatimi i së drejtës penale materiale, duke e përputhur gjendjen e vërtetuar faktike me ngjarjen reale e cila është marrë si vepër penale.¹ Synimi kryesor dhe më i rëndësishëm i ndërmarrjes së të gjitha veprimeve procedurale në procedurë penale është zbardhja e çështjes penale konkrete dhe marrja e një vendimi të drejtë dhe objektiv. Në realizimin e këtij synimi në procedurë penale merren dhe shqyrtohen një sërë provash në procesin e të provuarit, ku një ndër to është edhe dëshmia e dëshmitarit e cila është edhe objekt studimi i këtij hulumtimi shkencor.

Për të arritur deri tek periudha bashkëkohore e marrjes së dëshmisë së dëshmitarit, fillimisht duhet të hulumtojmë aspektin historik se si ka qenë e rregulluar dëshmia e dëshmitarit si provë në procedurat penale në të kaluarën, me ç'rast në fund të kësaj pjese të mund të bëjmë një krahasim se si dëshmia e dëshmitarit si provë në procedurë penale ka ndryshuar në të gjitha këto vite.

Në këtë hulumtim shkencor, ky objekt studimi, pra dëshmitari dhe dëshmia e tij, do të analizohen në këndvështrime të ndryshme ku do të paraqiten karakteristikat kryesore të cilat kanë të bëjnë me dëshmitarin dhe dëshminë e tij. Këtij objekti të studimit, pra dëshmisë së dëshmitarit do t'i kushtohet rëndësi jo vetëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut, por hulumtimi do të zgjerohet duke u analizuar edhe në aspekt krahasues, pra se si ajo është e rregulluar sipas legjislacionit të Kosovës dhe Shqipërisë.

Si pjesë e këtij hulumtimi shkencor do të paraqiten edhe intervistat e realizuara me prokuror publik nga Prokuroria Publike në Strugë, gjykatës nga Gjykata Themelore në Strugë, gjykatës nga Departamenti i Krimeve të Rënda të Gjykatës Themelore në Pejë, gjykatës nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, të cilët do të na japin sqarime edhe më të qarta mbi rëndësinë e dëshmisë së dëshmitarit në procedurë penale duke pasur përvojat e tyre në sferën praktike.

¹E.Sahiti & I.Zejneli, e drejta e procedurës penale, Shkup 2017, fq 158.

Gjithashtu, në këtë hulumtim shkencor do të paraqiten edhe dëshmi të dëshmitarëve të dhëna përpara trupit gjykues, përmes të cilave do të bëhet më e qartë se si praktikohet në praktikë marrja në pyetje e dëshmitarëve nëpërmjet pyetjeve të drejtpërdrejta, pyetjeve të tërthorta si dhe pyetjeve plotësuese.

Në bazë të të gjitha hulumtimeve të kryera mbi objektin e këtij hulumtimi shkencor, do të konkludojmë se rëndësia e dëshmitarit për të dëshmuar në procedurë penale është shumë e rëndësishme, ngaqë dëshmia e tij e drejtë dhe objektive ndikon në atë që gjykata për çështjen e caktuar penale të marrë një vendim të drejtë dhe objektiv.

KAPITULLI I

1.Vështrimi historik i dëshmisë së dëshmitarit në procedurë penale

Dëshmia e dëshmitarit si provë e rëndësishme në procedurë penale ka ekzistuar që në të kaluarën, pra ajo është përdorur që në fazat e para të reagimit shoqëror për ndriçimin e të gjithë çështjeve konkrete penale dhe zbulimin e kryerësve të atyre veprimeve kriminale dhe vazhdon të jetë evidente dhe prezente edhe në procedurat penale bashkëkohore.

Duke u bazuar në aspektin historik, mënyrat e marrjes dhe shqyrtimit të dëshmisë së dëshmitarit në procesin e të provuarit, kanë pësuar ndryshime thelbësore duke u inkomporuar metoda më humane me të cilat garantohet respektimi i lirive dhe të drejtave themelore të njeriut dhe qytetarit, të parapara edhe si kategori kushtetuese.

1.1.Dëshmitari në procedurë penale akuzatore

Procedura penale akuzatore njihet si procedura e parë penale e cila është zbatuar në formë të kontestit ndërmjet palëve të lira dhe të barabarta. Kjo procedurë penale ka përfshirë të gjithë periudhën e shoqërisë skllavopronare dhe periudhën e feudalizmit të hershëm. Njihet si një procedurë e cila vihej në lëvizje në bazë të iniciativës së të dëmtuarit.²

Dëshmia e dëshmitarit si provë ka qenë e njohur në të gjitha procedurat penale të popujve të vjetër. Në procedurën penale akuzatore numri i nevojshëm i dëshmitarëve për t'u paraqitur dhe për të provuar ndonjë fakt nuk ka qenë i përcaktuar sipas ndonjë rregulli, mirëpo gjatë procesit të të provuarit në këtë procedurë penale nuk ka qenë e arsyeshme dhe e pëlqyeshme vetëm dëshmia e një dëshmitari, por përparësi i është dhënë dëshmisë së më shumë dëshmitarëve për të provuar ndonjë fakt. Roli i gjykatës (gjykatësve laik) ka qenë pothuajse krejtësisht pasiv, ku në këtë rast obligimi i sjelljes së provave para gjykatës ka qenë barrë kryesisht e palëve, pra edhe dëshmitarët kanë qenë të ngarkuar me detyrën që të paraqesin prova në procedurë penale akuzatore. Detyra e dëshmitarit përpara gjykatës ishte që të jepte përgjigje në pyetjet e parashtruara dhe jo të jep dëshminë e tij të plotë në formë të tregimit. Në rastet kur dëshmitari përpara gjykatës ka dhënë dëshmi të rrejshme, ndaj tij ka pasur mundësi që të shqiptohet edhe dënimi më i rëndë, pra dënimi me vdekje.³

Së pari, dëshmitari merrej në pyetje nga pala e cila e kishte thirrur në gjykatë e më pas nga pala kundërshtarë. Para se dëshmitari të jepte dëshminë e tij, duhej të jepte betimin. Gjykata nuk ka pasur autorizime që t'i parashtrojë pyetje dëshmitarit, por autorizimet e saj kanë qenë vetëm për të ndaluar përgjigjet në pyetjet që nuk kanë qenë të lejueshme t'i parashtrohen dëshmitarit nga ana e palës e cila e ka propozuar në gjykatë dhe nga ana e palës kundërshtarë. Kur si dëshmitar ka qenë i përcaktuar që të paraqitet dëshmitari skllav, gjykata ka pasur autorizime ta marrë në pyetje atë jashtë gjykatës, me ç'rast ndaj të cilit ka mundur të zbatohej edhe tortura për shkak të pozitës të cilën e kishin skllavërit në atë shoqëri. Lidhur

²E.Sahiti, dëshmia e dëshmitarit si provë në procedurë penale, Prishtinë 1993, fq 24.

³Po aty, fq 25.

me marrjen në pyetje të dëshmitarit jashtë gjykatës është përpiluar procesverbal nga ana e gjykatës, i cili në formë të shkresës përdorej më pas edhe si provë.⁴

1.2.Dëshmitari në procedurë penale inkuizitore

Kalimi nga një procedurë penale në procedurë tjetër penale nuk ka qenë e lehtë, përkundrazi ka qenë një procedurë e gjatë dhe e ndikuar nga shumë faktorë të ndryshëm, karakteristikë e së cilës është edhe kalimi nga procedura penale akuzatore në procedurë penale inkuizitore. Kjo lëvizje, prej në procedurën penale akuzatore në procedurën penale inkuizitore, karakterizohet me përparimin gradual të zhvillimit të zejtarisë dhe tregtisë, me çka ka ndikuar në procesin e qarkullimit të mallit, me të cilën ka filluar gradualisht të zhvillohet edhe ekonomia mall-para, që ka ndikuar edhe në ndërrimin e raporteve shoqërore. Për dallim nga procedura penale akuzatore, në procedurën penale inkuizitore funksionin gjyqësor nuk e kanë ushtruar gjyqtarët laik, por gjyqtarët të cilët kanë qenë profesionistë në këtë profesion. Në këtë tip të procedurës penale për dallim nga procedura penale akuzatore, delikti më nuk është llogaritur si një çështje private nga ana e të dëmtuarit, por ky funksion ka qenë i përqëndruar kryesisht në duart e shtetit dhe është trajtuar si delikt publik.⁵ Kjo nënkupton atë se ndjekja e kryerësve të veprimeve kriminale është realizuar në rrugë zyrtare nga ana e shtetit-**ex officio**.

Në procedurë penale inkuizitore pesha e procesit të të provuarit ishte e përqëndruar në provat e drejtpërdrejta, ku si prova të drejtpërdrejta konsideroheshin dëshmia e dy dëshmitarëve madhorë e cila ishte e paraparë si mbretëreshë e provave, si dhe pohimi i të pandehurit i cili ishte më i vështirë për t'u arritur. Si pasojë e legalizimit të torturës, gjykata e lejonte zbatimin e saj për të arritur qëllimin e duhur, pra pranimin nga ana e të pandehurit.⁶

Dëshmitarët gjatë procesit të dhënies së dëshmisë kanë dëshmuar vetëm për atë çka kanë parë ose dëgjuar mbi çështjen penale konkrete për të cilën edhe është zhvilluar procedura penale. Në rastet kur dëshmitari është orientuar në dhënien e dëshmisë së rrejshme, ndaj tij janë shqiptuar dënime të ashpra të parapara sipas legjislacionit penal. Duke u bazuar në rëndësinë e saj, dëshmia e dëshmitarit feudal ose personit fetar ka qenë më e vlefshme, sesa dëshmia e një qytetari të thjeshtë, kurse sa i përket aspektit gjinor, dëshmia e mashkullit është konsideruar si më e sigurt për dallim nga dëshmia e femrës.⁷

Në procedurën penale inkuizitore kanë ekzistuar **dëshmitarë të aftë ose klasikë**, të cilët është besuar se e tregojnë të vërtetën gjatë dhënies së dëshmisë për çështjen e caktuar; **dëshmitarë të paaftë** të cilëve për shkak të natyrës ose gjendjes së tyre nuk u besohej se mund të thonë të vërtetën; **dëshmitarë të dyshimtë** janë ata dëshmitarë kundër të cilëve ekzistojnë dyshime se për shkak të prezencës së shkaqeve të caktuara nuk mund ose nuk do ta thonë të vërtetën. Sipas legjislacionit penal, në këtë tip të procedurës penale kanë ekzistuar persona të cilët kanë qenë absolutisht të paaftë për të dëshmuar, ku në këtë grup kanë hyrë të sëmurët psikik, fëmijët si dhe personat që nuk meritojnë besimin.⁸

⁴E.Sahiti, dëshmia e dëshmitarit si provë në procedurë penale, Prishtinë 1993 fq 25.

⁵Po aty, fq 26.

⁶A.Hajdari, procedura penale me komentari, Prishtinë 2010, fq 17.

⁷E.Sahiti, dëshmia e dëshmitarit si provë në procedurë penale, Prishtinë 1993, fq 27.

⁸Po aty, fq 28

1.3.Dëshmitari në procedurë penale mikste

Zbatimi i procedurës penale inkuizitore për një periudhë të gjatë kohore ka ndikuar që të shfaqen kritika të ashpra nga opinioni i përgjithshëm publik mbi procedurën gjyqësore të deriatëhershme. Me ndryshimin e rrethanave shoqërore në Francë të cilat pasuan me liberalizimin ekonomik në gjysmën e dytë të shekullit XVIII, përkatësisht pas fitores së revolucioneve borgjeze, u vërejt edhe një zhvillim i mëtejshëm i procedurës penale. Zgjedhjet e reja kanë ardhur në shprehje në mënyrë të plotë në Kodin e Napoleon Bonapartës të vitit 1808, i cili u ka shërbyer si mostër edhe të drejtave tjera të procedurës penale në Evropën Kontinentale.⁹Shtetet kanë adoptuar kryesisht rregulla procedurale të cilat në vete mbartin karakteristikat si të sistemit procedural akuzator, poashtu edhe elemente të sistemit procedural inkuizitor.

Kjo formë e procedurës penale në brendësinë e saj përfshin kombinimin e elementeve nga të dy format e lartpërmendura të procedurës penale, pra të procedurës penale akuzatore dhe procedurës penale inkuizitore. Ushtrimi i ndjekjes penale në këtë tip të procedurës penale ishte obligim i Prokurorit Publik, funksion të cilin ai e kryente me përgjegjësi në interes të shtetit.¹⁰

Në tipin mikst të procedurës penale, shqyrtimi i pozitës së dëshmitarit kërkon një qasje më të posaçme. Në të gjitha të drejtat procedurale pozitive që i përkasin këtij tipi të procedurës penale është paraparë obligimi i qytetarëve që kur të thirren në cilësi të dëshmitarit, të paraqiten përpara gjykatës në të cilën janë thirrur për të dëshmuar dhe të përmbushin qëllimin kryesor për të cilin janë thirrur. Pra, të dëshmojnë drejt dhe në mënyrë objektive për çështjen penale konkrete, ngaqë për dëshmi të rrejshme ndaj tyre janë shqiptuar sanksione të përcaktuara sipas legjislacionit penal.¹¹

1.4. Dëshmitari në të drejtën zakonore shqiptare

Mosekzistimi i pushtetit qendror i cili do të organizonte dhe do të zbatonte jurisdikcionin në një periudhë më të gjatë kohore, ka ndikuar në atë që marrëdhëniet shoqërore këto popuj t'i rregullonin përmes institucionit të gjyqit popullor, i cili nëpërmjet elementit laik i ka zgjidhur konfliktet. Në gjyqin popullor në të drejtën zakonore shqiptare, funksionin gjyqësor e kanë ushtruar pleqnia-gjyqi i pleqve, ku në përbërje të pleqnisë kanë hyrë të parët e fiseve, bajraktarët, persona të shkathët të cilët në mjedisin e vet kanë gëzuar famën e njerëzve të mençur dhe të ndershëm. Gjatë procesit të të provuarit, e drejta zakonore shqiptare i ka njohur, si mjetet racionale provuese (dëshmia e të pandehurit, dëshmia e dëshmitarit, deklarata e ekspertit, kapucari, kapja e kryerësit në vepër, ndjekja e gjurmëve, njohja e sendeve, shkresat), ashtu edhe mjetet iracionale provuese siç janë betimi dhe bartja e gurit.¹²

Në cilësinë e dëshmitarit sipas të drejtës zakonore shqiptare ka mund të paraqitet çdo mashkull madhor i cili nuk ka pasur të meta psikike dhe fizike, kurse gratë dhe fëmijët nuk mund të paraqiten në cilësinë e dëshmitarit në procedurë para pleqnisë. Gjithashtu si

⁹ E.Sahiti, dëshmia e dëshmitarit si provë në procedurë penale, Prishtinë 1993, fq 28

¹⁰ A.Hajdari,procedura penale me komentari,Prishtinë 2010,fq 19.

¹¹E.Sahiti, dëshmia e dëshmitarit si provë në procedurë penale, Prishtinë 1993, fq 29.

¹²Po aty,fq 31

dëshmitarë nuk mund të paraqiten edhe personat që e kanë humbur nderin qytetar dhe ushtarak. Përpara gjyqit popullor dëshmitarët i propozojnë palët, mirëpo edhe pleqnia mund të thërrasë dhe të marrë në pyetje dëshmitarë të tjerë përkundër dëshirës së palëve. Dëshmitari dëshmon për atë që e ka dëgjuar me shqisat e tij, ose që e ka parë me sytë e tij.¹³

Rastet në të cilat më së shpeshti dëshmitarët paraqiten për të dëshmuar janë të sferës civile, kurse në ato të sferës penale janë më të rralla. Dëshmimet në çështjet penale janë më të rralla, për arsye se grupi gjinoro-farefisnor e parashihte si tradhti, nëse një anëtar i një grupi farefisnor do të dëshmontë në dëm të anëtarit të grupit të vet farefisnor, dhe me këtë rast sipas rregullave nuk do ta ngarkojë anëtarin e vet edhe në rastet kur ai ka kryer delikt. Edhe në rastet kur është dashur që një anëtar i një grupi farefisnor të dëshmojë kundër një anëtarit të një grupi tjetër farefisnor ka qenë një çështje problematike, pasi me dëshminë e tij ka krijuar mundësinë që të fillojnë kontaktet e armiqësisë në mes atyre dy fiseve. Për këtë shkak më së shpeshti dëshmia e dëshmitarit më pak përdoret si provë akuzuese, pasi më së shumti është paraparë si mjet i mbrojtjes për delikuentin. Në të drejtën zakonore shqiptare nuk janë të parapara sanksione për mosardhjen e tij para pleqnisë dhe për dëshmi të rrejshme të dëshmitarit, mirëpo dëshmia e tij e rrejshme më shumë ka ndikuar në aspektin moral të tij, si dhe në opinionin publik në vendin ku ka jetuar duke e konsideruar si një njeri jo të ndershëm ku nuk kanë munguar edhe rastet kur për dëshmi të rrejshme është bojkotuar. Përpara se dëshmitari të japë dëshminë e tij duhet të betohet, ku për betimin e dhënë sipas rregullave të pleqnisë dëshmitarit i takon e drejta e kompensimit, sepse konsiderohet se duhet të mjaftojë fjala e nderit dhe burrit.¹⁴

2. Aspekte krahasimore të dëshmitarit si provë në vendet anglosaksone

Sistemi *common law*, origjina e të cilit gjendet në përvojën angleze, u përhap në kolonitë angleze pa pësuar ndikimin romak. Ata që lanë gjurmë në këtë sistem ishin pikërisht gjykatësit. Ata prodhuan të drejtë jurisprudenciale, në të cilën roli i ligjit është më i vogël dhe norma konceptohet në sensin pragmatik, pra si një instrument për të zgjidhur mosmarrëveshjet konkrete. Sistemi *common law* bashkon të gjitha ato përvoja që e kanë origjinën e tyre në të drejtën angleze mesjetare dhe moderne. Ajo që qëndron në thelb është pikërisht tradita juridike anglosaksone e cila ashtu si edhe gjuha angleze bashkon, me ndonjë ndryshim ndërmjet tyre, Anglinë, Irlandën, Kanadanë (përvec Kuebekut), Shtetet e Bashkuara, Australinë dhe Zelandën e Re. Ajo ndikon, ndonjëherë edhe në mënyrë të theksuar edhe mbi të drejtën e vendeve të tjera.¹⁵

2.1. Dëshmia e dëshmitarit në të drejtën angleze

E drejta angleze, si e drejtë zakonore, është krijuar kryesisht në praktikën gjyqësore. Kjo e drejtë edhe më tutje vazhdon t'i përket tipit akuzator të procedurës penale, mirëpo në të janë parashikuar disa mënyra dhe forma më efikase në raport me procedurën provuese

¹³E.Sahiti, dëshmia e dëshmitarit si provë në procedurë penale, Prishtinë 1993, fq 31.

¹⁴Po aty, fq32

¹⁵<https://www.mekulipress.com/disa-karakteristika-te-sistemit-juridik-anglez-me-theks-te-vecante-e-drejta-procedures-penale/>

formale. Teoria provuese angleze gjyqtarit i ofron një liri e cila e bën gjyqtarin që gjatë vlerësimit të provave të jetë më i saktë dhe më objektiv.¹⁶ Në procedurën penale angleze gjithashtu është përcaktuar edhe dëshmia e dëshmitarit në procedurë penale, deklarata e të cilit më së shpeshti paraqitet si provë. Pjesëmarrja e personit të thirrur për të dëshmuar në të drejtën angleze është e obligueshme, pasi në të kundërt personi do të sillet me forcë për të dëshmuar. Dëshmitari gjatë marrjes në pyetje është i detyruar të përgjigjet në pyetjet të cilat i parashtrihen, pyetje të cilat kanë të bëjnë me faktet që ai i njeh në bazë të perceptimit personal. Dëshmitari sipas të drejtës angleze mund të mos përgjigjet në pyetjen e parashtruar, nëse me dhënien e asaj dëshmie do t'ia ekspozonte veten rrezikut për ndjekje penale, ose dëshmimi do të ketë pasoja të dëmshme për të.¹⁷

Për dallim nga sistemet tjera juridike, në të drejtën angleze i pandehuri mund të jetë dëshmitar në çështjen e vet, në të cilën ai detyrohet të dëshmojë drejt, sepse për dëshmi të rrejshme do të sanksionohet. Në të drejtën angleze çdo dëshmitar, para se të japë dëshminë e tij, duhet të japë betimin. Mohimi i dhënies së betimit e bën atë jokompetent për të dëshmuar.¹⁸

Marrjen në pyetje të dëshmitarit e realizon pala e cila e ka thirrë atë që të paraqitet në cilësinë e dëshmitarit, si dhe pala kundërshtare duke i parashtruar pyetje në mënyrë kryqëzore rreth çështjes së caktuar, në të cilën dëshmitari përgjigjet shkurtimisht e jo duke dhënë përgjigje të pandërprerë lidhur me rastin. Sipas legjislacionit anglez, si provë mund të konsiderohet vetëm dëshmia të cilën e jep dëshmitari në gjykatë dhe nuk mund të konsiderohet si provë dëshmia sipas dëgjimit dhe as dëshmia e dhënë jashtë gjykatës. Në procedurën provuese, në të drejtën angleze, së pari insistohet që palët t'i paraqesin provat e drejtpërdrejta, provat të cilat kanë fuqi më të madhe provuese. Mirëpo, gjykata jo çdo herë mbështetet vetëm në provat e drejtpërdrejta, ngaqë në disa raste edhe provat e prejardhura mund të kenë fuqi provuese. Roli i gjykatës nuk është pasiv, sepse ai intervenon në rastet kur pyetjet të cilat i parashtrihen dëshmitarit nuk kanë të bëjnë me lëndën e parashtruar, si dhe në paralajmërimin e dëshmitarit në dhënien e një dëshmie më të qartë. Dëshmia e një dëshmitari të aftë mund të provojë një fakt plotësisht, nëse dëshmia e tij është e besueshme, mirëpo në disa raste kërkohen dy dëshmitarë ose një dëshmitar i përforcuar me prova të tjera.¹⁹

2.2. Dëshmia e dëshmitarit në të drejtën e SHBA-ve

Procedura penale në Shtetet e Bashkuara të Amerikës pothuajse tërësisht përputhet me procedurën penale sipas të drejtës angleze. Procedura penale në SHBA zhvillohet nëpërmjet procedurës paraprake, që ka karakter të shqyrtimit paraprak të cilën e zhvillon gjyqtari të cilit i takon një e drejtë e gjerë që t'i thërrasë dëshmitarët sipas vlerësimit të vet dhe po të njejtët t'i marrë edhe në pyetje.²⁰ Kjo bëhet duke thirrur dëshmitarët të japin dëshmi dhe duke paraqitur prova fizike që do të dëshmojnë se i pandehuri është fajtor për krimin. Dëshmitarët janë njerëz që mund të japin dëshmi që do të ndihmojnë në vërtetimin e fajit të të pandehurit. Ata mund të kenë parë në të vërtetë ngjarje të lidhura me krimin, mund të kenë informacione përkatëse në lidhje me të pandehurin, ose mund të jenë në gjendje të japin dëshmi eksperte lidhur me provat ose të kenë informacione të tjera të rëndësishme.²¹

¹⁶E.Sahiti, Dëshmia e dëshmitarit si provë në procedurë penale, Prishtinë 1993, fq 44.

¹⁷ E.Sahiti, Argumentimi në procedurë penale, Prishtinë 2006, fq 226.

¹⁸E.Sahiti, Dëshmia e dëshmitarit si provë në procedurë penale, Prishtinë 1993, fq 46.

¹⁹Po aty, fq 48.

²⁰ E.Sahiti, Argumentimi në procedurë penale, Prishtinë 2006, fq 228.

²¹https://en.wikipedia.org/wiki/United_States_criminal_procedure

Deklarata e cila jepet nga ana e dëshmitarit duhet të jetë e shkurtër, duke u përgjigjur në pyetjet të cilat i parashtrohen atij dhe jo duke e bazuar dhënien e dëshmisë në formë të tregimit. Marrja në pyetje e tij është pothuajse e njëjtë si në të drejtën angleze, duke u marrë në pyetje në mënyrë kryqëzore. Detyra e gjyqtarit është që të bëjë ndalimin e parashtrimit të pyetjeve ndaj dëshmitarit, të cilat nuk kanë të bëjnë me çështjen për të cilën zhvillohet procedura penale.²²

Dëshmitari ka një detyrë pozitive dhe obligim të tregojë të vërtetën. Kjo do të thotë që ai / ajo në të vërtetë duhet të tregojë për gjithçka që ai / ajo di rreth çështjes me iniciativën e tij / saj. Ai / ajo gjithashtu duhet t'u përgjigjet pyetjeve të paraqitura. Nëse dëshmitari zbulohet se ka ndryshuar të vërtetën ose fshehur diçka, ai / ajo do të akuzohet për një deklaratë të pavërtetë. Ju mund të mbron veten ose të afërmin tuaj (partneri, ish-partneri, i fejuari (e), i afërmi në brezin ngjitës ose zbritës ose partneri ose ish-partneri i të afërmit të tillë, të afërmit, motrat ose motrat e motrës), kështu që një dëshmitar mund të refuzojë të dëshmojë dhe ai / ajo nuk ka pse të përgjigjet në pyetje të tilla, të cilat mund ta vendosin veten ose të afërmin e tij në rrezik. Një dëshmitar nuk ka pse të zbulojë ndonjë sekret profesional, përveç nëse ai / ajo është i detyruar me ligj. Dëshmimi është një detyrë qytetare që nuk mund të refuzohet, kurse në rast të refuzimit thirren me kërcënimin e gjobës. Ai / ajo duhet të marrë pjesë në gjykatë në kohën e përmendur, përveç nëse ai / ajo ka një pengesë të tillë për shkak të së cilës ai / ajo nuk mund të marrë pjesë. Një pengesë e tillë mund të jetë për shembull sëmundja ose ndërprerja e transportit publik. Pengesa miratohet nga kryetari i gjyqimit, d.m.th gjyqtari. Dëshmitari betohet për betimin e dëshmitarit ose siguron siguri. Betimi bëhet duke përsëritur fjalët e kryetarit të trupit gjykues, si në vijim: “Betohem se dëshmia që unë do të jap do të jetë e vërteta, e tërë e vërteta dhe asgjë tjetër përveç së vërtetës. Unë deklaroj solemnisht, sinqerisht dhe me të vërtetë deklaroj dhe pohoj se provat që do të jap do të jenë e vërteta, e tërë e vërteta dhe asgjë tjetër përveç së vërtetës.”²³

3. Nocioni i dëshmisë dhe dëshmitarit në procedurë penale

Deklarimi (dëshmia) konsiderohet “deklaratë” të cilën dikush (i pandehuri, dëshmitari, kallëzuesi i veprës penale, i dëmtuari, eksperti) e jep në cilësi të pjesëmarrësit procedural, se ai është “rezultat” i vërtetimit të fakteve të caktuara dhe se ai është burim njohjeje për faktet në procedurë penale.²⁴

Dëshmia e dëshmitarit si provë në procedurë penale ka ekzistuar prej në të kaluarën dhe përsëri vazhdon të paraqitet edhe në procedurën penale bashkëkohore, posaçërisht gjatë procesit të të provuarit. Sot, nuk ka pothuajse asnjë vend që nuk e ka përkrahur dëshmitarin në legjislacionin e vet penal si mjet prove. Për të pasur një pasqyrë më të qartë rreth dëshmitarit, sot hasim definicione të ndryshme në të gjitha legjislacionet penale të të gjitha vendeve të botës, përmes të cilave bëhet definimi i qartë i dëshmitarit dhe roli i tij në procedurë penale. Në të gjitha legjislacionet penale, nocioni i dëshmitarit dhe dëshmisë së tij

²²E.Sahiti, Dëshmia e dëshmitarit si provë në procedurë penale, Prishtinë 1993, fq 46.

²³<https://www.riku.fi/en/guides-and-instructions/instructions-for-the-witness-of-a-criminal-case/>

²⁴ E.Sahiti, psikologjia gjyqësore, Prishtinë 2007, fq 48

janë përshkruar në mënyrë të përpiktë, ku në thelb këto nocione përputhen pothuajse në të gjitha legjislacionet e të gjitha vendeve.

Sipas nenit 212, paragrafi 1 të LPP-së të Republikës së Maqedonisë së Veriut, si dëshmitar thirret personi për të cilin besohet se do të mund të japë njoftime për veprën penale, për kryerësin dhe për rrethanat e rëndësishme në lidhje me atë veprim në procedurë penale.²⁵

Sipas **Vodineliqit**, dëshmitar është personi fizik i pazëvendësueshëm, i ndryshëm nga i pandehuri, i cili tregon në bazë të perceptimeve shqisore vetanake dhe të vlerësimeve të thjeshta, për atë që ka të bëjë sipas rregullit me të kaluarën, e paraqitur sipas rregullit rastësisht dhe spontanisht jashtë procedurës penale. Sipas rregullit ka natyrë të njohjes laike, ndërsa ka të bëjë me faktet juridike-procedurale relevante, faktet indiciale dhe ndihmëse ad remi personal e që deklarohet para gjykate. Sipas autorit të njohur **Bajeri**, dëshmitar është personi i ndryshëm nga i pandehuri të cilit pak i janë të njohura faktet të cilat vërtetohen në procedurë penale dhe të cilin gjyqtari hetues ose trupi gjykues e ka ftuar që për ato fakte të japë deklaratën e vet. Autori i njohur **Eberhand Schmidt**, i definon dëshmitarët si persona të cilët janë të ndryshëm nga subjektet procedural, kurse dijnë diç për faktet që janë me rëndësi për konstatimin e së vërtetës, si fakte kryesore indiciale ose ndihmëse(dhe atë e dijnë) në bazë të perceptimeve vetanake pa urdhër procedural.²⁶

²⁵Ligji i Procedurës Penale,gazeta zyrtare e RMV nr 150,prej 18.11.2011 ,neni 212

²⁶E.Sahiti, dëshmia e dëshmitarit si provë në procedurë penale, Prishtinë 1993, fq 60.

KAPITULLI II

1. Dëshmia e dëshmitarit si provë në procedurë penale në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Nocionin e provës ne mund ta përcaktojmë si një proces ose fenomen i cili i përfshin të gjitha faktet dhe rrethanat e rëndësishme që kanë të bëjnë me çështjen penale kryesore, pra të gjykimit, me të cilën çështje përcaktohet fajësia e të pandehurit si element subjektiv dhe shqiptimi i dënimit të përcaktuar sipas legjislacionit penal. Në bazë të kësaj, gjykata në procedurë penale i ndërrmer të gjitha veprimet e përcaktuara sipas ligjit të procedurës penale, përmes të cilave e krijon bindjen mbi ekzistimin ose mos mosekzistimin e fakteve të cilat mund të ndikojnë në marrjen e vendimit nga ana e gjykatës.

Provat paraqesin të gjitha veprimet që i ndërrmarin palët në procedurë penale për të paraqitur dëshminë e tyre mbi çështjen kryesore ose dhënien e kundërshtimeve ndaj palës kundërshtarë. Pra, çdo provë e dhënë në procedurë penale flet për saktësinë e ndonjë fakti relevant juridik, fakte të cilat duhet të vërtetohen në procedurë penale.²⁷

Vërtetimi i saktësisë së ndonjë rasti relevant juridik në procedurë penale paraqet një proces të vështirë dhe më të gjatë për nga aspekti kohor për gjykatën, duke marrë parasysh se edhe vetë procedura penale paraqitet si një nga procedurat më të vështira për të arritur deri tek e vërteta, për dallim nga procedurat e tjera.

Dëshmia e dëshmitarit si provë në procedurë penale ekziston që nga kohët më të lashta duke e analizuar edhe aspektin historik, ku ajo ka pasur një rëndësi të veçantë si provë në zbardhjen e rastit konkret dhe shqiptimin e një sanksioni të drejtë dhe efektiv ndaj të pandehurit. Mirëpo dhënia e dëshmisë së dëshmitarit në raste të caktuara ka ndikuar edhe në vërtetimin e pafajësisë së të pandehurit ose të të akuzuarit.

Rëndësia e dëshmisë së dëshmitarit në procedurë penale ka vazhduar me hapa të shpejta në interes të zhvillimit të pozitës së dëshmitarit në procedurë penale bashkëkohore. Legjislacioni penal bashkëkohor ka paraparë një pozitë më të favorshme për dëshmitarin drejtuar paraqitjes së tij në procedurë penale si dhe dhënies së dëshmisë së tij në po atë procedurë. Pjesëmarrja e dëshmitarit në procedurë penale është pothuajse e patjetërsueshme duke pasur parasysh atë se dëshmia e tij mund të ndikojë në bindjen e gjykatës për marrjen e një vendimi i cili përputhet me dëshminë e dëshmitarit të dhënë në atë procedurë penale.

1.1. Personat të cilët mund të paraqiten në cilësinë e dëshmitarit

Sipas Ligjit të procedurës penale është përcaktuar në mënyrë të qartë se cilët persona në procedurë të caktuar penale mund të paraqiten në cilësinë e dëshmitarit për të dëshmuar mbi rastin konkret për të cilin edhe janë thirrur.

Sipas nenit 212 të Ligjit të procedurës penale të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në cilësinë e dëshmitarit mund të paraqiten:

- 1) Personat të cilët janë në gjendje të raportojnë për veprën penale dhe kryerësin e veprës penale, si dhe rrethanat e tjera të cilat kanë të bëjnë me atë vepër;

²⁷E.Sahiti, I.Zejneli, E drejta e procedurës penale, Shkup 2017, fq 162.

- 2) Pala e dëmtuar dhe paditësi privat mund të pyeten në cilësinë e dëshmitarit;
- 3) Çdo person i thirrur si dëshmitar është i detyruar të paraqitet në ftesë, përveç nëse përcaktohet ndryshe me këtë ligj, dhe ai është i detyruar të dëshmojë.²⁸

Dëshmia është e paraparë si e drejtë qytetare, e drejtë e cila në procedurë penale ka një rëndësi të veçantë. E paraparë si një e drejtë, ajo gjithashtu ka edhe obligimet e saj, pra obligimin për t'u paraqitur në ftesë nga ana e gjykatës dhe detyrën për të dëshmuar për çështjen e caktuar penale në kushtet e përcaktuara në këtë ligj. Dëshmitari është i obliguar që të dëshmojë drejtë dhe vetëm të vërtetën mbi të gjitha njohuritë të cilat ai i posedon dhe që kanë të bëjnë me veprën penale, kryerësin e veprës penale dhe rrethanat tjera në të cilat është kryer vepra penal. Në bazë të kësaj, si dëshmitar thirret secili person pa kufizime përsa i përket moshës, gjinisë si dhe cilësive të tij psikike dhe fizike dhe nga i cili besohet se do të japë njohuri të sakta mbi çështjen e caktuar penale. Gjithashtu, si dëshmitar mund të paraqitet edhe një oficer policie që ka ndërmarrë veprime për të zbuluar një veprë penale ose kryerës të veprës penale, por vetëm për vëzhgimet e tij të menjëhershme.²⁹

Në disa raste, nevoja për të pyetur të dëmtuarin në cilësinë e dëshmitarit është e pashmangshme. Në këtë situatë mund të vijë atëherë kur në çështjen e caktuar penale konkrete, përveç dëshmisë së dëshmitarit, nuk ka prova të tjera për të vendosur në procedurë penale. Viktima si dëshmitar okular percepton në mënyrë më të sigurt rastin konkret për dallim nga dëshmitari i rëndomtë, mirëpo në këtë rast duhet pasur parasysh faktin se viktima është i interesuar për rrjedhën e procedurës penale dhe dëshmia e tij edhe mund të mos jetë objektive.³⁰

1.2. Personat të cilët nuk mund të paraqiten në cilësinë e dëshmitarit

Në procedurë penale të RMV-së jo të gjithë personat mund të paraqiten në cilësinë e dëshmitarit për të dëshmuar, sepse në Ligjin e procedurës penale të RMV-së është e përcaktuar edhe kategoria e personave të cilët nuk mund të paraqiten në cilësinë e dëshmitarit për të dëshmuar.

Sipas nenit 213 të Ligjit të procedurës penale të RMV-së, në cilësinë e dëshmitarit nuk mund të paraqiten:

- 1) Personat të cilët me deklarin e vet do të shkelnin detyrën e ruajtjes së fshehtësisë zyrtare ose ushtarake, derisa organi kompetent nuk e liron nga ky detyrim;
- 2) Mbrojtësi i të pandehurit, ngaqë i pandehuri i ka besuar atij në cilësinë e mbrojtësit të vet, përveç kur këtë e kërkon vetë i pandehuri;
- 3) Personi i cili me deklaratën e tij do ta cënojë detyrën për ruajtjen e fshehtësisë afariste në lidhje me atë që e ka mësuar në kryerjen e profesionit të vet (predikues fetar, avokat dhe mjek), përveç nëse është i liruar nga ajo detyrë me rregull të posaçëm ose me shkresë,

²⁸ Ligji I procedurës penale, gazeta zyrtare e RMV nr.150 prej 18.11.2010., neni 212.

²⁹ G.Kalajdziev, G.Lazetic, L.Nedelkova, M.Denkovska, M.Trombeva, T.Vitlarov, P. Jankulovska, D.Kadieva
Komentimi i Ligjit të procedurës penale, Shkup 2018, neni 212.

³⁰ E.Sahiti, Argumentimi në procedurën penale, Prishtinë 2006, fq 235.

përkatësisht me deklaratën e dhënë në procesverbal të personit, në dobi të të cilit është vendosur ruajtja e fshehtësisë, përkatësisht me deklaratë të atillë të pasardhësit të tij juridik;

4) Personi i mitur i cili duke marrë parasysh moshën e tij dhe zhvillimin shpirtëror nuk është i aftë që ta kuptojë rëndësinë e së drejtës së tij se nuk duhet të dëshmojë, përveç nëse vetë i pandehuri e kërkon atë;

5) Personi i cili për shkak të sëmundjes së vet shpirtërore ose trupore, përkatësisht moshës së vet nuk është në gjendje të dëshmojë (neni 213).³¹

Duke u bazuar në pikën e parë të nenit të lartpërmendur mund të konkludojmë se dëshmitari nuk mund të merret në pyetje për rrethanat që lidhen me sekretin shtetëror ose ushtarak, sepse ajo është e parashikuar si pengesë absolute derisa organi të mos e lirojë nga obligimi i ruajtjes së fshehtësisë. Personi i tillë duhet t'i përgjigjet thirrjes së përcaktuar, mirëpo për çështjet të cilat paraqesin sekret duhet të refuzojë që të përgjigjet pasi zbulimi i paautorizuar i sekretit paraqet vepër penale.³²

Në bazë të pikës së dytë të këtij neni të LPP-së, në mes të pandehurit dhe mbrojtësit të tij janë krijuar marrëdhënie në të cilat mbizotëron mirëbesimi i plotë në mes tyre. Kjo nënkupton atë se në procedurë penale nuk mund të pyetet si dëshmitar mbrojtësi i të pandehurit për atë që i pandehuri ia ka besuar mbrojtësit të vet, përveç kur këtë e kërkon vetë i pandehuri.³³

Kur para gjykatës paraqitet dëshmitari i mitur, gjykata ex officio e vlerëson nëse i mituri është i aftë të kuptojë rëndësinë e të drejtës se nuk ka obligim të dëshmojë duke e pasur parasysh moshën dhe zhvillimin mendor. Vlerësimin mbi aftësinë e të miturit për të dëshmuar e vendos gjykata e cila vlerësimin e vet e arsyeton në aktgjykim. Në rastin kur gjykata konsideron se person i mitur nuk është i obliguar të dëshmojë, atëherë person i tillë faktikisht hyn në grupin e personave të cilët nuk mund të merren në pyetje si dëshmitar.³⁴ Pra në bazë të kësaj mund të konkludojmë se ndalimi i marrjes në pyetje të të miturit në cilësinë e dëshmitarit nuk është i karakterit absolut, ngaqë në raste të përcaktuara me ligj edhe i mituri mund të merret në pyetje në cilësinë e dëshmitarit.

Kategoria e fundit e përcaktuar sipas nenit 213 të LPP-së, për dallim nga kategoritë e tjera të lartpërmendura në po këtë nen, i përket karakterit absolut të ndalimit të marrjes në pyetje në cilësinë e dëshmitarit, personit i cili për shkak të sëmundjes së vet shpirtërore ose fizike, përkatësisht moshës së vet nuk është në gjendje që të dëshmojë. Në një rast të tillë, organi që zhvillon procedurën duhet të vlerësojë në çdo rast të veçantë nëse i mituri, duke pasur parasysh moshën e tij dhe sëmundjen mendore ose fizike, a mund të dëshmojë ose jo, gjithmonë duke përdorur ndihmën e profesionistëve, pedagogëve, psikologëve ose personave të tjerë të kualifikuar.³⁵

³¹E.Sahiti, I.Zejneli, E drejta e procedurës penale, Shkup 2017, fq 193.

³²E.Sahiti, Argumentimi në procedurën penale, Prishtinë 2006, fq 238.

³³Po aty, fq 240.

³⁴E.Sahiti, dëshmia e dëshmitarit si provë në procedurë penale, Prishtinë 1993, fq 81.

³⁵G.Kalajdziev, G.Lazetic, L.Nedelkova, M.Denkovska, M.Trombeva, T.Vitlarov, P. Jankulovska, D.Kadiev Komentimi i Ligjit të procedurës penale, Shkup 2018, neni 213,

1.3. Personat të cilët janë të liruar nga obligimet për të dëshmuar

Sipas nenit 214 të Ligjit të procedurës penale të RMV-së, nga detyra e dëshmitarit janë të liruar këta persona:

- 1) Bashkëshorti martesor dhe jashtëmartesor i të pandehurit;
- 2) Personi i gjinisë së gjakut në vijë të drejtë, ai në vijë anësore deri në shkallë të tretë, si dhe personat e gjinisë së krushqisë deri në shkallë të dytë;
- 3) I birësuari dhe birësuesi i të pandehurit (neni 214).³⁶

Duke u bazuar në këtë nen, personat e thirrur në cilësinë e dëshmitarit nuk janë të obliguar të japin dëshminë e tyre në procedurë penale, por ata janë të lirë që të vendosin nëse do të dëshmojnë në çështjen e caktuar penale ose nuk do të dëshmojnë.

Në këtë kategori janë përfshirë të gjithë personat të cilë janë në një marrëdhënie familjare ose farefisnore me të pandehurin, gjendje e cila i bën që këta persona të mos jenë të obliguar të dëshmojnë në çështjen penale konkrete. Organi procedural ka për detyrë që personave të lartëpërmendur, para se t'i marrë në pyetje, t'ua bëjë me dije të drejtën për të mos dëshmuar, me ç'rast gjykata paralajmërimin dhe përgjigjen e të pandehurit e regjistron në procesverbal.

1.4. Dëshmitari pamor(okular)

Me nocionin dëshmitar okular nënkuptojmë personin i cili gjatë kryerjes së një veprë penale ka qenë i pranishëm në atë moment dhe ka parë të gjithë mekanizmin se si është kryer ajo vepër penale. Këta persona nuk janë persona të cilët kanë qenë të udhëzuar që në momentin e kryerjes së veprës penale të jenë të pranishëm në atë vend, por këta persona i krijojnë vetë rasti si dëshmitarë okular, sepse në momentin e kryerjes së veprës penale janë ndodhur në vendin e ngjarjes dhe me shqisat e tyre e kanë vërejtur atë ngjarje.

Dëshmitari okular, me rastin e paraqitjes së tij në gjykatë është i detyruar që të japë një përshkrim në seancën gjyqësore, në lidhje me rrethanat të cilat ai i ka të njohura nga vepra penale konkrete. Ai duhet të japë një përshkrim në lidhje me identifikimin e autorit/autorëve të veprës penale, si dhe përshkrimin e të gjitha njohurive të tjera të cilat kanë të bëjnë me atë vepër penale. Mirëpo në bazë të disa hulumtimeve shkencore nga ekspertë të ndryshëm, tek dëshmitari okular gjatë dhënies së dëshmisë mund të paraqiten disa faktorë psikologjikë të cilët e çojnë dëshmitarin okular deri në shtrembërimin e kujtesës në lidhje me atë se çfarë ka parë në vendin e ngjarjes gjatë kryerjes së veprës penale. Në bazë të konkluzioneve të arritura nga hulumtimet shkencore, dëshmitari mund të ndikohet nga këto faktorë psikologjikë:

- Ankthi/stresi;
- Rindërtimi i kujtesës;
- Prezenca e armës së krimit;
- Mënyrat dhe taktikat e marrjes në pyetje të dëshmitarit okular;
- Kontaminimi i bashkëdëshmitarëve;
- Dezinformimi i kujtesës.³⁷

³⁶E.Sahiti, I.Zejneli, E drejta e procedurës penale, Shkup 2017, fq 193.

1.5. Dëshmitari sipas dëgjimit

Me nocionin dëshmitar sipas dëgjimit nënkuptojmë personin i cili gjatë kryerjes së veprës penale nuk ka qenë i pranishëm në vendin e ngjarjes, mirëpo për mënyrën dhe rrethanat në të cilat është kryer vepra penale ka dëgjuar nga personat e tretë, të cilët ia kanë përshkruar zhvillimin e veprës.

Në procedurën penale bashkëkohore çdoherë i jepet përparësi dëshmitarit okular për dallim nga dëshmia e dëshmitarit sipas dëgjimit, e cila paraqitet në rastet kur dëshmitari okular është i paarritshëm për të dhënë dëshmi në atë procedurë gjyqësore. Kjo ndodh për arye se dëshmitari sipas dëgjimit, veprimin kriminal nuk e ka perceptuar me shqisat e veta, por atë e ka mësuar nga personi i tretë, me ç'rast ekziston edhe mundësia që dëshminë e tij ta japë me përmbajtje të shtrembëruar.³⁷ Për këtë arsye, me rastin e marrjes së dëshmisë së dëshmitarit sipas dëgjimit, duhet analizuar së pari ambientin në të cilin do të japë dëshminë dëshmitari sipas dëgjimit si dhe pyetjet të cilat do t'i parashtrohen atij, ngaqë këto rrethana mund të ndikojnë negativisht tek dëshmitari duke e drejtuar atë që të japë një dëshmi e cila nuk do të përputhet me tregimin të cilin ia ka përshkruar dëshmitari okular. Si rrethana të tilla paraqiten faktorët psikologjikë të cilët ndikojnë negativisht tek dëshmitari sipas dëgjimit, të cilat e shtyjnë atë që të japë një dëshmi të shtrembëruar. Si faktorë psikologjikë tek dëshmitari sipas dëgjimit, gjithashtu mund të paraqiten:

- Ankthi/stresi;
- Rindërtimi i kujtesës;
- Prezenca e armës së krimit;
- Mënyrat dhe taktikat e marrjes në pyetje të dëshmitarit okular;
- Kontaminimi i bashkëdëshmitarëve;
- Dezinformimi i kujtesës.³⁸

2. Vetitë e deklartuesit të cilat mund të ndikojnë në dëshmi të dëshmitarit

Dhënia e dëshmisë së dëshmitarit në procedurë penale paraqet një nga obligimet e tij kryesore të cilën ai nuk mund që ta anashkalojë pa mos e arsyetuar. Momenti i dhënies së dëshmisë së dëshmitarit paraqet moment me një ngarkesë emocionale shumë të madhe për dëshmitarin, sepse ai për atë tregim do të mbartë edhe përgjegjësi penale.

Nga dëshmitari në secilin rast kërkohet që të flasë të vërtetën përmes të cilës edhe gjykatësit do t'i lehtësohet puna në marrjen e një vendimi të drejtë gjyqësor. Mirëpo, jo çdoherë dëshmitari jep një dëshmi të saktë, se në disa raste ai tregimin e tij e orienton në drejtim i cili nuk përputhet me të vërtetën për shkak të shkaqeve dhe arsyeve të ndryshme.

³⁷<http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2018/09/DOKTORATURA-BESIANA-PETANAJ-MUKA.pdf>

³⁸E.Sahiti, I.Zejneli, E drejta e procedurës penale, Shkup 2017, fq 196.

³⁹<http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2018/09/DOKTORATURA-BESIANA-PETANAJ-MUKA.pdf>

Deri në këto raste mund të arrihet me dëshirën ose vetëdijen e dëshmitarit, por gjithashtu edhe pa dëshirën ose pavetëdijen e dëshmitarit nga ndikimi i faktorëve dhe vetive të ndryshme të cilat ndikojnë në dëshmi të dëshmitarit.

Në bazë të hulumtimeve shkencore si veti të cilat mund të ndikojnë në dëshminë e dëshmitarit përmenden disa veti të cilat luajnë rol të rëndësishëm në çështjen e dhënies së dëshmisë së dëshmitarit.

2.1. Vetitë biologjike të cilat mund të ndikojnë në dëshmi të dëshmitarit

2.1.1. Mosha e dëshmitarit si veti biologjike

Mosha paraqet një ndër karakteristikat kryesore e cila duhet të hulumtohet dhe studiohet nga ana e psikologëve për të pasur njohuri më të veçanta dhe bashkëkohore përsa i përket kësaj karakteristike.

Në teori nga ana e psikologëve numërohen hulumtime dhe studime empirike të rralla, për këtë arsye në botën bashkëkohore kërkohen hulumtime më të gjëra mbi këtë çështje. Ndër të parat që ka bërë hulumtim të tillë ka qenë psikologjia gjermane Sharlota Byler në vitin 1930, e cila e ka përshkruar në 5 faza, faza të cilat u përgjigjen fazave biologjike të zhvillimit të njeriut. Faza e parë është faza progresive dhe zgjat deri në moshën 15 vjeçare. Faza e dytë, në të cilën zhvillohet aftësia e reprodukcionit zgjat prej moshës 15 vjeçare-25 vjeçare. Faza e tretë zgjatë prej 25 deri në 45 vjet dhe me atë rast stabilizohet organizmi. Faza e katërt zgjat prej 45 deri në 65 vjet. Faza e pestë paraqet fazën e fundit e cila zgjat prej vitit 65 e deri në fund të jetës e që karakterizohet me tërheqje të personit, meditim për të kaluarën, si dhe për ardhmërinë dhe vdekjen e cila vjen.⁴⁰

Fëmijët si dëshmitarë paraqesin një nga grupmoshat më delikate për të cilët vazhdojnë të qëndrojnë dyshimet se a duhet ata të paraqiten në cilësinë e dëshmitarit në procedurë penale ose nuk duhet të paraqiten. Në këtë grup hyjnë personat prej moshës 7 vjeçare deri në moshën 14 vjeçare.⁴¹ Legjislacione të ndryshme japin edhe zgjidhje të ndryshme. Në disa legjislacione këtyre personave u lejohej që të paraqiten në cilësinë e dëshmitarit me disa kufizime të veçanta, kurse në disa legjislacione të tjera ndalohet marrja e dëshmisë nga personat e kësaj grupmoshe. Praktika njih raste kur personat e kësaj grupmoshe kanë qenë dëshmitarët kryesor në zbardhjen e së vërtetës në çështjen penale konkrete e sidomos në rastet e problemeve familjare në mes prindërve.⁴²

Kategori tjetër që mund të paraqitet në cilësinë e dëshmitarit janë edhe të miturit të cilët i përkasin grupmoshës prej në 14 vjeç deri në moshën 18 vjeçare. Kjo paraqet një nga fazat më problematike për këto persona, meqë në këtë fazë vjen në shprehje paraqitja e pubertetit tek këta persona dhe mund të ketë një ndikim negativ gjatë paraqitjes së tyre në cilësinë e dëshmitarit. Pra në këtë fazë përcillen ndryshime të vullshme fizike dhe psikike. Tek i mituri në këto raste dëshmia e tij mund të përshkohet me fantazi, me çka bartet gjendja subjektive në botën objektive, gjë që mund të ndikojë në dhënien e një dëshmie të egzagjeruar

⁴⁰ E.Sahiti, Psikologjia Gjyqësore, Prishtinë 2007, fq. 63.

⁴¹ Po aty, fq. 65

⁴² Po aty, fq. 64

e cila nuk do të përputhet me realitetin.⁴³ Për këtë arsye, gjatë marrjes së dëshmisë nga i mituri si dëshmitar, policia, prokuroria dhe gjykata detyrohen që të kenë konsideratë për veçoritë personale dhe karakteristikat e të miturit për të mbrojtur interesat dhe zhvillimin e tij të rregullt. Gjithashtu vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet edhe individualitetit të tyre, si dhe ndikimeve të mundshme nga jashtë ose të rrethinës.

Kategori tjetër e personave të cilët paraqiten në cilësinë e dëshmitarit janë edhe personat të cilët e kanë mbushur moshën 18 vjeç. Cilësitë dhe kriteret të cilat duhet të përmbushen për t'u paraqitur në cilësinë e dëshmitarit në procedurë penale, janë të elaboruara në pjesën e lartpërmendur të këtij hulumtimi shkencor.

Si kategori tjetër shumë delikate në drejtim të paraqitjes në cilësinë e dëshmitarit paraqitet grupmosha e të moshuarve. Në këtë fazë personi fillon që dalngadalë të bie si në aspektin fizik po ashtu edhe në aspektin psikik. Tek këta persona fillojnë të paraqiten edhe sëmundje të ndryshme psikike dhe mendore, sëmundje të cilat ndikojnë negativisht në procesin e të menduarit të personit të moshuar, gjë që ndikon në dhënien e një dëshmie jo të përputhshme me realitetin.⁴⁴ Në këtë fazë tek person i moshuar fillon dobësimi i funksioneve shqisore si dhe ndryshimet drejt dobësimit të procesit të të menduarit ose kujtesës përmes të cilës ndodhitë e zhvilluara në të kaluarën fillojnë t'i harrojnë. Për këtë arsye, ndaj këtij grupi të personave dëshmia duhet të merret në një mënyrë më të veçantë, duke marrë parasysh aftësitë e tyre fizike, psikike, mendore etj.

2.1.2. Gjinia e dëshmitarit si veti biologjike

Si faktor i rëndësishëm i cili ka ndikim të drejtpërdrejtë në procesin e të dëshmuarit paraqitet edhe gjinia e personit të cilit jep dëshminë për rastin konkret. Në grupin e personave të cilët mund të paraqiten në cilësinë e dëshmitarit hyjnë dy kategori të personave, edhe atë:

1. Meshkujt si dëshmitarë;
2. Femrat si dëshmitare.

Përsa u përket personave në cilësinë e dëshmitarit që i përkasin gjinisë mashkullore e elaboruam në materialin e sipërpërmendur mbi cilësitë dhe procesin e paraqitjes së tyre në cilësinë e dëshmitarit në procedurë penale. Duke pasur parasysh se edhe personat e gjinisë femërore janë kryerëse të veprave penale, atëherë me automatizëm vlen të kuptohet se ato gjithashtu mund të paraqiten në cilësinë e dëshmitarit, duke plotësuar kushtet e përcaktuara sipas ligjit të procedurës penale të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Përsa i përket moshës nuk ka ndonjë dallim në mes dëshmitarëve të gjinisë mashkullore dhe femërore. Pra të gjitha pikat e lartpërmendura përsa i përket moshës së dëshmitarëve, janë të njëjta si për gjininë mashkullore ashtu edhe për gjininë femërore.

Përsa i përket procesit të dëshmisë, te gjinia femërore duhet pasur parasysh ngarkesat të cilat shfaqen tek femrat, ngarkesa të cilat mund të ndikojnë në dhënien e një dëshmie e cila nuk do të përputhet me realitetin. Për këtë arsye gjatë marrjes së dëshmisë nga personat e gjinisë

⁴³E.Sahiti, dëshmia e dëshmitarit si provë në procedurë penale, Prishtinë 1993, fq 186.

⁴⁴Po aty, fq.188

femërore duhet pasur një përkushtim më të veçantë duke respektuar gjininë, personalitetin, gjendjen fizike dhe psikike të saj.

Gjininë femërore e karakterizojnë ngarkesa biologjike të caktuara siç janë menstruacioni, graviditeti, klimakteriumi, të cilat mund të shkaktojnë ndjenjë të dobësisë, lodhjes dhe të reagimit me gjaknxehësi të shtuar. Kur këto ndodhi paraqiten në momentin e perceptimit ose në momentin e dhënies së deklaratës, ndikojnë që personi i caktuar të japë një deklaratë të shtrembëruar për shkak të gjendjes momentale të saj nga ngarkesat e mëdha biologjike e jo nga dëshira e saj për të dhënë një deklaratë e cila nuk përputhet me realitetin.⁴⁵ Pra të gjitha këto raste duhet të vërtetohen në procedurë penale, për të pasur një vendim të drejtë dhe objektiv.⁴⁶

2.2. Vetitë psikike dhe fizike të cilat ndikojnë në dëshmi të dëshmitarit

2.2.1. Vetitë psikike

Vetitë shpirtërore ose psikike paraqesin një faktor shumë të rëndësishëm në procedurë penale gjatë procesit të marrjes së dëshmisë së dëshmitarit. Paraqitja e gjendjeve të ndryshme shpirtërore tek dëshmitari paraqesin faktor negativ me ç'rast e bëjnë të padenjë dëshmitarin që të dëshmojë në atë procedurë penale, sepse dhënia e dëshmisë së dëshmitarit në ndikimin e gjendjeve të ndryshme shpirtërore ose psikike nuk adreson në një dëshmi të drejtë dhe në përputhshmëri me gjendjen reale.

Si persona të paaftë për të dëshmuar konsiderohen ata persona të cilët gjatë kohës së perceptimit ose dëshmimit kanë qenë në ndikimin e gjendjes së prapambetjes shpirtërore, të çrregullimit psikik ose sëmundjes psikike. Të gjitha rastet në të cilat paraqitet ndonjëra nga këto pengesat të cilat e bëjnë dëshmitarin të padenjë për të dëshmuar duhet të vërtetohen në procedurë penale nga ana e gjykatës, me ç'rast gjendjen e dëshmitarit gjykata e vlerëson si çështje faktike. Për shkak të rëndësisë së dëshmitarit në procedurë penale si mjet provues, gjykata e shfrytëzon ekspertin psikiatrik.⁴⁷

2.2.2. Vetitë fizike

Vetitë fizike paraqesin një veti tjetër të rëndësishme në procedurë penale gjatë marrjes së dëshmisë nga ana e dëshmitarit. Gjendja e tij fizike paraqet një faktor nga i cili do të përcaktohet nëse personi i caktuar do të mund të paraqitet në cilësinë e dëshmitarit. Jostabiliteti i gjendjes fizike të personit i cili paraqitet në cilësinë e dëshmitarit mund të ndikojë tek ai që dëshminë e tij ta drejtojë në një kahje e cila në përfundim nuk do të përputhet me realitetin. E gjithë kjo mund të ndodhë për shkak të mangësive fizike të personit të caktuar, për këtë arsye duhet kushtuar një rëndësi të veçantë vetive fizike të personit që merret në pyetje. Në rastet kur tek personi i caktuar paraqiten sëmundje kronike të parapara si sëmundje më të rënda shëndetësore, fillimisht paraqiten shenja të dhimbjeve të ndryshme, me ç'rast këto sëmundje krijojnë edhe gjendje psikologjike, frikë e në veçanti frikë nga vdekja. Me paraqitjen e këtyre simptomave njeriu nuk mund të reagojë normalisht, sepse ngacmimet

⁴⁵E.Sahiti, dëshmia e dëshmitarit si provë në procedurë penale, Prishtinë 1993, fq 189.

⁴⁶E.Sahiti, Psikologjia Gjyqësore, Prishtinë 2007, fq. 70

⁴⁷E.Sahiti, dëshmia e dëshmitarit si provë në procedurë penale, Prishtinë 1993, fq 191.

tek ai shkaktajnë reagime të cilat nuk janë adekuate dhe që manifestohen me shqetësim, me gjaknxehtësi dhe me resignacion. Pra në këto raste reagimi i personave të prekur nga këto sëmundjet nuk është i njëjtë si reagimi i personave të shëndoshë, me ç'rast edhe dëshmia e këtyre personave nuk është shumë profitabile në procedurë penale, ngaqë nën ndikim të atyre faktorëve, dëshmitari drejtohet në dhënien e një dëshmie të pa përputhshme me realitetin.⁴⁸

Si faktorë të tjerë paraqiten edhe mangësitë në shqisat e dëgjimit dhe shqisat e shikimit përmes të cilave paraqiten probleme gjatë procesit të perceptimit të ndonjë ngjarjeje ose të të gjithë ngjarjes. Gjithashtu si faktorë negativë tek njeriu paraqiten edhe mangësitë estetike, pamja e jashtme, rritja e stërmadhe trupore ose rritja trupore tepër e vogël, gungësia ose tullacia, që mund të shkaktajnë tek individit ndjenjë të inferioritetit dhe të lënies pasdore në jetë.⁴⁹

Të gjithë këta faktorë mund të ndikojnë në dhënien e dëshmisë së dëshmitarit e cila nuk përputhet me realitetin dhe me gjendjen reale se si ajo ka ndodhur, ku për këtë arsye gjyqtari është i detyruar që gjatë marrjes në pyetje të zbulojë nëse tek personi i caktuar ekzistojnë këto mangësi dhe në mënyrë kritike të vlerësojë deklarin e tij.

2.3. Ndikimi i ambientit të dëshmitarit të marrë në pyetje

Ambienti paraqet mjedisin në të cilin njeriu zhvillohet dhe kalon pothuajse të gjitha fazat e jetës, që nga lindja e tij e deri në vdekje. Njeriu paraqet qenie shoqërore që pothuajse kohën më të madhe e kalon në ambiente jetësore të përbëra nga grupacione njerëzore siç mund të jetë familja, rrethi fqinjësor ose ai i punës etj. Për këtë arsye edhe ndikimi i ambientit të dëshmitarit para dhënies së dëshmisë së dëshmitarit ose gjatë dhënies së dëshmitarit paraqet ndikim të drejtpërdrejtë mbi dëshmitarin. Ambientet në të cilat mbizotërojnë marrëdhëniet pozitive mes grupeve brenda ambientit të caktuar, paraqesin parakusht që dëshmitari të jetë më i saktë gjatë formulimit dhe dhënies së deklaratës. Kjo nënkupton faktin se ndikim pozitiv ose negativ mbi dëshminë e dëshmitarit mund të japin, si ambienti i jashtëm prej nga vjen dëshmitari, por gjithashtu edhe ambienti brenda hapësirave në të cilat personi thirret për të dëshmuar. Ambienti në të cilin dëshmitari e jep dëshminë luan një rol shumë të rëndësishëm në dhënien e dëshmisë, sepse nëse i njëjti frymon në frymë negative, ajo në mënyrë direkte ndikon dhe paraqet indicje që dëshmitari të mos japë dëshmi të drejtë. Për këtë arsye, për të fituar dëshmi të drejtë dhe të saktë nga ana e dëshmitarit, pikësepari duhet të sigurohet ambient në të cilin ai do të ndjehet i sigurt.

2.3.1. Familja, rrethi fqinjësor dhe i punës

Familja paraqet celulë themelore për zhvillimin dhe formimin e personalitetit të njeriut.⁵⁰ Prej në fëmijëri njeriu kërkon përkrahjen dhe përkujdesjen e familjes për të pasur zhvillim më të suksesshëm. E gjithë kjo varet edhe nga harmonia familjare, nga raportet brenda familjes. Nëse brenda familjes ekzistojnë raporte të mirësjellta dhe positive, atëherë

⁴⁸E.Sahiti,Psikologjia Gjyqësore,Prishtinë 2007,fq 72.

⁴⁹Po aty,fq. 73

⁵⁰E.Sahiti, dëshmia e dëshmitarit si provë në procedurë penale, Prishtinë 1993, fq 192

zhvillimi i personalitetit të personit do të jetë më i suksesshëm, në të kundërt do të paraqiten mangësi dhe probleme gjatë fazave të mëtutjeshme të jetës së njeriut. Familja në jetën e njeriut është e një rëndësie të veçantë e cila nuk mund të zëvendësohet me factor; të tjerë. I gjithë ky ndikim mund të paraqitet pozitivisht ose negativisht në dhënien e dëshmisë së dëshmitarit, meqë familja është edhe frymëzimi i vet atij personi.

Faktor tjetër i rëndësishëm paraqitet edhe rrethi fqinjësor. Pas kalimit të fazës së përkujdesjes absolute të familjes, tek njeriu paraqitet nevoja e shfaqjes së tij në ambientin fqinjësor, kyçjen në grupet fqinjësore në të cilat njeriu e kalon pothuajse pjesën më të madhe të ditës. Për grupet fqinjësore tek të cilat mbizotëron harmonia, ndihma, raportet miqësore ndërmjet grupit, bredhja e kohës në mënyrë të organizuar, këto të fundit paraqesin faktorë të cilët ndikojnë pozitivisht në jetën e njeriut dhe përgatitjen e tij pozitive për fazat e ardhshme të zhvillimit të tij. Në të kundërt, nëse raportet fqinjësore janë të çregulluara, paraqitet shfaqje e kriminalitetit, bredhje e kohës me veprime negative, të cilët paraqesin parakusht që në fazat e ardhshme të jetës tek ata persona të paraqiten probleme dhe mangësi të ndryshme. E gjithë kjo mund të ketë influencë edhe me rastin e formimit dhe të paraqitjes së deklaratës së dëshmitarit, sepse serioziteti i tij si dhe stabiliteti i tij kanë një rëndësi të veçantë në atë se sa në jetë dhe bisedë të përditshme personi i caktuar e çmon të vërtetën. E njëjta gjë ndodh edhe gjatë dhënies së dëshmisë nga ana e dëshmitarit, se sa ai e çmon të vërtetën dhe sa ai e tregon të vërtetën gjatë dhënies së dëshmisë për atë që ai e ka perceptuar. Për këtë arsye, roli dhe puna e gjyqtarit në vërtetimin e këtyre problemeve në këto raste është mjaft i vështirë.⁵¹

Faktor tjetër shumë i rëndësishëm paraqitet edhe rrethi i punës. Me rastin e arritjes së moshës madhore dhe kyçjes së tij në tregun e punës, njeriu e ndërron ambientin e mëparshëm dhe kyçet në një ambient nga i cili ai merr edhe obligime të cilat duhet t'i kryej. Me këtë rast ai ndërron edhe grupacionin shoqëror dhe kyçet në një grupacion tjetër në të cilin duhet ambientuar. Në këto grupacione jo çdoherë mbizotërojnë marrëdhëniet e shëndosha dhe pozitive. Ndikimet negative të cilat paraqiten gjatë marrëdhënies së punës mund të ndikojnë që gjatë dhënies së dëshmisë, dëshmitari të japë dëshmi e cila nuk përputhet me gjendjen reale. Sa i përket ambientit të punës, faktin se dëshmitari punon së bashku me të pandehurin ose të dëmtuarin në ndërrmarje të njëjtë, si dhe sa u përket personave të cilët janë në marrëdhënie pune te i dëmtuari ose i pandehuri, patjetër duhet të kihet parasysh me rastin e dëshmimit.⁵²

2.3.2. Arsimimi

Arsimimi paraqet një nga veçoritë më të rëndësishme në zhvillimin e personalitetit. Në rastin e paraqitjes së personit në cilësinë e dëshmitarit, arsimimi nuk paraqet kusht për t'u paraqitur në cilësinë e dëshmitarit. Në këtë rast, në cilësinë e dëshmitarit mund të paraqiten edhe personat të cilët kanë shkallë të arsimimit, por gjithashtu edhe ata që nuk kanë një shkallë të arsimimit.

Dëshmitari i cili gjatë fazës së zhvillimit të tij i ka kushtuar rëndësi dhe ka një shkallë të arsimimit, gjatë paraqitjes së tij në cilësinë e dëshmitarit do të ketë më të lehtë që të përmbushë detyrën e cila i është ngarkuar në procedurë penale, sepse për atë sadopak është e

⁵¹E.Sahiti, dëshmia e dëshmitarit si provë në procedurë penale, Prishtinë 1993, fq. 193

⁵²Po aty, fq 194

njohur procedura penale, çështja për të cilën thirret në atë procedurë. Arsimimi i lehtëson atij që të kuptojë rëndësinë e procedurës penale dhe rëndësinë e dëshmisë së dëshmitarit, si dhe me arritjen e shkallës së arsimimit ai është në gjendje më të përshtatshme të ambientohet në procedurë penale, t'u përgjigjet pyetjeve të parashtruara në cilësinë e dëshmitarit si dhe të japë një përgjigje më të qartë për gjykatën dhe të pranishmit e tjerë në procedurë penale. Përkundrazi, tek personi i paarsimuar paraqiten probleme rreth çështjes së ambientimit në procedurë penale si dhe dhënies së përgjigjeve të qarta dhe sqarimit të rastit të cilin ai e ka perceptuar.⁵³

Nga përvoja ime si praktikant në Gjykatën Themelore në Strugë, kam hasur raste kur dëshmitari për shkak të shkallës së ulët të arsimimit, ka hasur probleme të vazhdueshme gjatë procedurës penale edhe atë që nga fillimi i procedurës dhe deri në përfundimin e saj për shkak se për herë të parë ishte ballafaquar me një procedurë të tillë, me ç'rast e kishte të vështirë të kuptojë rrjedhën e saj për shkak edhe të gjuhës në të cilën zhvillohej procedura penale (gjuhën maqedonase). Pra, problemi kryesor mbi gjuhën ishte moskuptimi i terminologjisë në gjuhën në të cilën udhëhiqej procedura penale. Për shkak të problemit gjuhësor, mosnjohjes me rrjedhën e procedurës si dhe nivelit të ulët arsimor, dëshmitari e kishte të vështirë të formulojë dëshminë e tij mbi çështjen penale konkrete duke mos kuptuar rrjedhën e procedurës penale. Gjykatësi në çështjen penale ishte i përkatësisë etnike maqedonase, me ç'rast dëshmitari kërkoi që të shfrytëzojë të drejtën të flasë në gjuhën shqipe, kurse përkthyesi të bëjë përkthimin në gjuhën maqedonase. Në këtë fazë u shfaqen probleme të dukshme gjatë dhënies së dëshmisë, për shkak se përkthyesi e kishte të vështirë të kuptojë dëshminë të cilën e jepte dëshmitari ngaqë vinte edhe nga një fshat malor dhe gjuhën e theksin të cilin e përdorte ishte i pakuptueshëm, për këtë arsye edhe përkthyesi e kishte të vështirë përkthimin e dëshmisë së dëshmitarit në gjuhën maqedonase. Kjo gjendje për gjykatën ishte e qartë, sepse kjo pengesë nuk vinte vetëm për arsye se vinte nga një fshat malor, por bëhej fjalë për dëshmitar i cili nuk kishte përfunduar as edhe shkollimin fillor, pra klasën e 8-të.

2.4. Ndikimi i mjeteve të informacionit masiv në formimin e deklaratës së dëshmitarit

Në vitet e fundit po vërehet një avancim dhe përparim posaçërisht në teknologji dhe në mjetet e informimit, të cilët luajnë rolin parimor dhe kryesor në transmetimin e informacioneve ditore deri tek popullsia. Efekti i tyre pozitiv ndikon që popullsia në përgjithësi të jetë në rrjedhë të vazhdueshme me ndodhitë të cilat ndodhin në atë vend, sa u përket sferave të ndryshme si psh, sferës së ekonomisë, drejtësisë, marrëdhënieve politike në vend, ndodhive ditore qoftë të atyre me efekte pozitive, qoftë të atyre me veprime kriminale. Pra, përmes tyre popullsia qëndron në rrjedha të vazhdueshme me ndodhitë të cilat paraqiten në jetën e përditshme.

Jo çdoherë mjetet e informimit kanë efekte pozitive gjatë transmetimit të informacioneve, sepse gjatë transmetimit të tyre mund të shfaqen edhe efekte negative e

⁵³E.Sahiti, dëshmia e dëshmitarit si provë në procedurë penale, Prishtinë 1993, fq 195

sidomos tek dëshmitarët e përcaktuar në procedurë penale konkrete. Tek ata gjatë pranimit të informatave përmes mjeteve të informacionit, shpeshherë paraqiten huti mbi rastin konkret dhe ndikon që gjatë dhënies së dëshmisë në procedurë penale, dëshmitari të përqëndrohet në informacionet e shfaqura në mjetet e informimit të cilat nuk përputhen me njohuritë të cilat dëshmitari i ka perceptuar nga rasti konkret. Informacionet e transmetuara në mjetet e informimit edhe mund të mos jenë të sakta, me ç'rast dëshmia e tij nuk do të përputhet me gjendjen reale. Roli vendimtar në këto raste qëndron në punën e gjykatës dhe veprimeve të cilat ajo do t'i ndërmarrë, ngaqë mund të paraqitet rreziku i akceptimit të dëshmisë së rrejshme të dëshmitarit mbi të cilën do të mbështetet edhe vendimi gjyqësor i cili nuk do të jetë pozitiv dhe i përputhshëm me gjendjen reale.⁵⁴

3. Thirrja e dëshmitarit për të dëshmuar

E gjithë procedura mbi thirrjen dhe marrjen në pyetje të dëshmitarit në procedurë penale është e rregulluar sipas Ligjit të Procedurës Penale të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Sipas Nenit 218 të LPP-së, thirrja e dëshmitarit përmes dërgimit të shkresës për të dëshmuar gjatë procedurës paraprake parashtrohet nga ana e Prokurorit Publik, kurse në seancën kryesore nga ana e gjykatës, e cila shkresë përfshinë emrin dhe mbiemrin e personit, profesionin e tij, kohën dhe vendin e paraqitjes, çështjen penale për të cilën ai është thirrur, si dhe tregimin se ai thirret si dëshmitar. Në thirrje gjithashtu është e theksuar se nëse personi i thirrur në mënyrë të rregullt nuk paraqitet, ose nuk e justifikon mungesën e tij, atëherë në këtë rast ai mund të sillet me urdhër të gjykatës në mënyrë të dhunshme⁵⁵ dhe gjithashtu ndaj tij të shqiptohet gjobë e përcaktuar sipas nenit 88 par.(1) të LPP-së. Nëse dëshmitari vazhdimisht refuzon të dëshmojë edhe përsëri dënimeve të shqiptuara me gjobë, gjykata e cila udhëheq procedurën ndaj tij mund të shqiptojë dënimin me burgim deri në 30 ditë (neni.88 LPP).

Në rastet kur në cilësinë e dëshmitarit duhet të paraqitet personi i cili nuk i ka mbushur 18 vjet, thirrja bëhet përmes prindit ose përfaqësuesit të tij ligjor⁵⁶. E gjithë kjo ndodh për arsye se sipas Ligjit mbi familjen prindërit janë të obliguar të kujdesen për fëmijët e tyre deri në arritjen e moshës madhore e në disa raste të veçanta edhe pas arritjes së asaj moshe. Për këtë shkak thirrja ndaj atyre personave realizohet nëpërmjet prindërve të tyre ose përfaqësuesit ligjor.

Dëshmitarët të cilët nuk mund t'i përgjigjen ftesës për shkak të pleqërisë, sëmundjes ose pengesave të rënda fizike mund të merren në pyetje në shtëpinë e tyre ose diku tjetër ku mund t'i përshtatet personit të lartpërmendur. Në rastet kur paraqiten këto pengesa, personi i cili nuk mund t'i përgjigjet ftesës e ka për detyrim të njoftojë Prokurorin publik që ai nuk mund të paraqitet për të dëshmuar dhe të arsyetoj atë duke paraqitur prova për pamundësinë e tij (zakonisht dokumentacion mjekësor) për t'u paraqitur në cilësinë e dëshmitarit.⁵⁷

⁵⁴E.Sahiti, dëshmia e dëshmitarit si provë në procedurë penale, Prishtinë 1993, fq 197

⁵⁵ Ligji I procedurës penale, gazeta zyrtare e RMV-së, nr.150, prej 18.11.2018, neni 218, paragrafi (1).

⁵⁶Po aty, neni 218 paragrafi (2).

⁵⁷G.Kalajdziev, G.Lazetic, L.Nedelkova, M.Denkovska, M.Trombeva, T.Vitlarov, P. Jankulovska, D.Kadiev
Komentimi i Ligjit të procedurës penale, Shkup 2018, neni 218.

3.1. Metoda e marrjes në pyetje e dëshmitarit

Marrja në pyetje e dëshmitarit paraqet një procedurë të ndërlikuar e cila kërkon kujdes dhe shkathhtësi të veçantë. Në mënyrë që deklarata e dëshmitarit të ketë vlerë provuese dhe të ketë vlerë gjatë vërtetimit të fakteve, marrja në pyetje e dëshmitarit duhet të realizohet duke u bazuar në mënyrën dhe formën e përcaktuar sipas Ligjit të Procedurës Penale të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Me rastin e pranimit të shkresës së adresuar dëshmitarit nga ana e Prokurorit Publik ose gjykatës, dëshmitari është i detyruar të paraqitet në vendin dhe kohën e përcaktuar në shkresë. Me paraqitjen e tij fillon procesi i marrjes në pyetje të dëshmitarit nga ana e Prokurorit Publik, nëse është i thirrur për të dëshmuar në procedurë paraprake ose nga ana e gjykatës, nëse është i thirrur për të dëshmuar në seancën kryesore.

Sipas nenit 219 të LPP-së, dëshmitarët në procedurë paraprake të thirrur nga ana e Prokurorit Publik merren në pyetje veçmas, pra çdo njëri në mënyrë private pa praninë e dëshmitarëve të tjerë, për dallim nga seanca kryesore ku dëshmitarët e marrë në pyetje nga ana e gjykatës mbeten në seancën kryesore. Dëshmitari e jep dëshminë në formë gojore, kurse në rastet kur dëshmitari është i shurdhër, pyetjet e tij bëhen me shkrim dhe ai përgjigjet me gojë, kurse nëse dëshmitari është i heshtur (memec), pyetjet bëhen me gojë dhe ai përgjigjet me shkrim.⁵⁸

Para se gjykata të fillojë me marrjen e dëshmisë, dëshmitari do të paralajmërohet se është i detyruar të flasë të vërtetën, sepse dhënia e dëshmisë së rrejshme paraqet vepër penale dhe dënohet sipas LPP-së. Dëshmitari gjithashtu do të paralajmërohet se nuk është i detyruar që të përgjigjet në pyetjet me të cilat veten ose të afërmit e tij ia ekspozon turpit ose dëmit të konsiderueshëm material ose ndjekjes penale. Ky paralajmërim do të shënohet në procesverbal.⁵⁹

Dëshmitari më pas do të pyetet për emrin dhe mbiemrin e tij, emrin e babait, profesionin, vendbanimin ose vendqëndrimin, vendin e lindjes, moshën e tij, si dhe marrëdhëniet e tij me të pandehurin dhe palën e dëmtuar. Gjithashtu dëshmitari do të paralajmërohet se nëse gjatë zhvillimit të procedurës penale ai e ndryshon vendbanimin ose vendqëndrimin e tij është i detyruar që për atë të paralajmërojë organin i cili e zhvillon procedurën penale.⁶⁰

Sipas nenit 222 të LPP-së, para marrjes në pyetje të dëshmitarit, nga ai mund të kërkohej të bëjë betimin para seancës kryesore vetëm në rastet kur ekziston frika se për shkak të sëmundjes ose arsye të tjera ai ose ajo nuk do të jetë në gjendje të marrë pjesë në seancën kryesore. Arsyeja e dhënies së betimit do të shënohet në procesverbal.⁶¹ Dëshmitari betohet para dhënies së dëshmisë duke përsëritur se: "Betohej në nderin tim se për gjithçka që do të pyetem do të flas vetëm të vërtetën dhe për gjithçka që kam parë ose dëgjuar nuk do të hesht."⁶²

⁵⁸G.Kalajdziev, G.Lazetic, L.Nedelkova, M.Denkovska, M.Trombeva, T.Vitlarov, P.Jankulovska, D.Kadiev
Komentimi i Ligjit të procedurës penale, Shkup 2018, neni 219.

⁵⁹E.Sahiti & I.Zejneli, E drejta e procedurës penale, Shkup 2017, fq 194.

⁶⁰ Ligji I procedurës penale, gazeta zyrtare e RMV-së, nr.150, prej 18.11.2018, neni 219, paragrafi (3).

⁶¹ Po aty, neni 222.

⁶² Po aty, neni 386 paragrafi (2).

Sipas nenit 223 të LPP-së, nuk lejohet që të kërkohet dhënia e betimit nga:

- 1) Personat të cilët në momentin e dhënies së dëshmisë nuk i kanë mbushur 18 vjet;
- 2) Personat të cilët për arsye të gjendjes së tyre shpirtërore nuk mund të kuptojnë kuptimin e dhënies së betimit.⁶³

Sipas paragrafit të parë të këtij neni, këta janë dëshmitarë prej të cilëve mund të mos kërkohet të japin betimin për arsye të moshës ose gjendjes së tyre mendore në kohën e marrjes në pyetje në cilësinë e dëshmitarit. Kjo ndodh për arsye se ato karakterizohen nga pjekuria e tyre mendore e pamjaftueshme dhe për këtë shkak ato mund të mos e kuptojnë rëndësinë e dhënies së betimit.

Sipas paragrafit të dytë të këtij neni, dëshmitarit nuk mund t'i kërkohet të bëjë betimin nëse ai ose ajo nuk është në gjendje të kuptojë rëndësinë e betimit për shkak të gjendjes shpirtërore, gjë që është e kuptueshme, sepse bëhet fjalë për person gjendja shpirtërore e të cilit e bën të vështirë për të kuptuar rëndësinë e betimit.⁶⁴

Gjatë paraqitjes së provave në procedurë provuese, sipas LPP-së janë të parashikuara tre mënyra të ekzaminimit të tyre: pyetjet direkte ose të drejtpërdrejta, pyetje të kryqëzuara dhe pyetjet plotësuese.

3.1.1. Pyetjet direkte ose të drejtpërdrejta

Forma e parë e marrjes në pyetje të dëshmitarëve është marrja në pyetje e drejtpërdrejtë nga pala (Prokurori Publik ose mbrojtësi) i dëshmitarëve që i kanë propozuar ata në procedurën e veçantë penale.⁶⁵

Gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarit në formë të drejtpërdrejtë, atij i:

- bëhen pyetje të shkurtra në mënyrë që të marrin përgjigje gjithëpërfshirëse;
- pyetjet duhet t'i strukturohen në bazë të fakteve të çështjes dhe të përputhen me përgjigjet e dhëna më herët;
- dëshmitarët duhet të jenë të përgatitur për t'u marrë në pyetje, pasi marrja në pyetje në mënyrë direkte paraqet kusht për marrjen në pyetje më pas në formë të kryqëzuar, që domethënë se pyetjet të cilat do t'i parashtrohen gjatë formës së kryqëzuar kanë të bëjnë me atë që personi e ka deklaruar gjatë marrjes në pyetje në mënyrë të drejtpërdrejtë.⁶⁶

Një çështje penale nuk fitohet për shkak të dobësive të kundërshtarit, por për shkak të forcës së argumenteve të paraqitura. Kjo është arsyeja pse forma e marrjes në pyetje në mënyrë të drejtpërdrejtë është faktori vendimtar në rezultatin e çështjes.

Gjatë dhënies së dëshmisë në këtë formë, dëshmitari duhet që:

- të përgjigjet në pyetjet e parashtruara ngadalë, pa u shpejtuar;
- nëse nuk e ka kuptuar pyetjen të kërkojë qartësimin e asaj;

⁶³Ligji I procedurës penale, gazeta zyrtare e RMV-së, nr.150, prej 18.11.2018, neni 223.

⁶⁴G.Kalajdziev, G.Lazetic, L.Nedelkova, M.Denkovska, M.Trombeva, T.Vitlarov, P. Jankulovska, D.Kadiev
Komentimi i Ligjit të procedurës penale, Shkup 2018, neni 223.

⁶⁵ <https://www.scribd.com/doc/300046866/Akademija-ZKP-Modul-3-Priracnik-Glavna-Rasprava>

⁶⁶Katerina Kolarevic, Zbatimi praktik i ligjit për procedurën penale, Marrja në pyetje e dëshmitarëve dhe ekspertëve në procedurat penale, Shkup.

-të mos supozojë(d.m.th. nëse ai nuk e di ose nuk e mban mend, ta thotë kështu);
-çdoherë të thotë të vërtetën.⁶⁷

Kur pala e cila e merr në pyetje dëshmitarin, përfundon me atë procedurë gjatë pyetjeve të drejtpërdrejta ndaj dëshmitarit, asnjë pyetje nuk duhet të mbetet pa përgjigje. Nuk duhet të mbetet asgjë tjetër që pala e kundërt të pyesë. Përsëri, kjo mund të arrihet vetëm nëse pala e cila e merr në pyetje dëshmitarin gjatë pyetjeve të drejtpërdrejta është e përgatitur mirë në çështjen e veçantë dhe ka hartuar një strategji që pranon se secila pyetje për secilin dëshmitar ka të bëjë me teorinë e përgjithshme dhe qasjen ndaj çështjes, deklaratën hyrëse, marrjen në pyetje në mënyrë të kryqëzuar dhe fjalët përmbyllëse. Pala e cila e ka propozuar dëshmitarin në procedurën penale konkrete, në përputhje me teorinë e tij të çështjes dhe strategjinë e identifikuar, duhet të përcaktojë pyetjet direkte dhe më pas të takohet me dëshmitarin në mënyrë që ta përgatisë atë për aktin e dëshmisë.⁶⁸

3.1.2. Pyetjet e kryqëzuara

Marrjen në pyetje në mënyrë të kryqëzuar e bën pala e kundërt, për të kundërshtuar deklaratën e dhënë të dëshmitarit gjatë pyetjeve të drejtpërdrejta. Pyetjet janë të kufizuara dhe kanë të bëjnë me pyetjet të cilat paraprakisht janë parashtruar gjatë marrjes së drejtpërdrejtë në pyetje të dëshmitarit nga pala e cila e ka propozuar.⁶⁹

Qëllimi i parashtrimit të pyetjeve të kryqëzuara është që të krijojë përshtypjen se deklaratat e dëshmitarit e dhënë me rastin e pyetjeve të drejtpërdrejta përmban paqartësi ose fakte të supozuara dhe të palidhura. Gjatë parashtrimit të pyetjeve të kryqëzuara, nga dëshmitari kërkohet që të përgjigjet me përgjigje të shkurtëra me „PO” ose „JO”.⁷⁰ Avokati sigurisht që duhet të shfrytëzojë mundësinë për të forcuar pikat e forta të çështjes së tij dhe të theksojë dobësitë e palës kundërshtare, si dhe besueshmërinë e dëshmisë dhe teorisë së çështjes kundërshtare. Ai duhet të bëjë pyetje udhëzuese, të mos lejojë që dëshmitari të shpjegojë, sepse ai e bëri këtë në marrjen në pyetje të drejtpërdrejtë. Avokati duhet të jetë i kujdesshëm që të mos bëjë kurrë pyetje për të cilat nuk e di përgjigjen, sepse vetë përgjigja mund ta befasojë atë negativisht. Në veçanti, duhet të jetë i kujdesshëm të përdorë dy pyetjet më të fuqishme në fillim dhe në fund të provimit kur të fillojë marrja në pyetje. Së fundmi, është e rëndësishme të theksohet se avokati duhet të bëjë pyetje të shkurtra, jokomplekse, por për t'u konceptuar në formën e një deklarate.⁷¹

Gjatë kësaj faze, dëshmitarit nuk duhet t'i lejohej që të shpjegojë diçka me rastin e parashtrimit të pyetjeve të kryqëzuara, sepse kjo procedurë e marrjes në pyetje ka për qëllim vërtetimin e asaj të cilën e dëshmoi gjatë pyetjeve të drejtpërdrejta dhe jo të japë shpjegime të reja. Para se të vendoset nëse do t'i parashtrohen pyetje të kryqëzuara një dëshmitari, është e nevojshme të njiheni plotësisht me të gjitha faktet e çështjes së veçantë, në mënyrë që të keni

⁶⁷ <https://www.scribd.com/doc/300046866/Akademija-ZKP-Modul-3-Priracnik-Glavna-Rasprava>

⁶⁸ Po aty.

⁶⁹ E.Sahiti & I.Zejneli, E drejta e procedurës penale, Shkup 2017, fq 255.

⁷⁰ <https://www.scribd.com/doc/300046866/Akademija-ZKP-Modul-3-Priracnik-Glavna-Rasprava>

⁷¹ Po aty.

një ide konkrete për atë që mund të arrihet përmes marrjes në pyetje. Marrja e dëshmisë nëpërmjet pyetjeve kryqëzore nuk është e detyrueshme, por ajo përdoret në rastet kur pritet që nga ajo të dalin rezultate të mira dhe të përshtatshme.⁷²

3.1.3. Pyetjet plotësuese

Marrja e dëshmisë nëpërmjet pyetjeve plotësuese vijon pas përfundimit të pyetjeve të kryqëzuara. Pyetjet plotësuese i parashtron përsëri pala e cila e ka propozuar atë dëshmitar, të cilit i parashtrohen pyetje plotësuese me qëllim që të jep një shpjegim më të qartë mbi pyetjet e kryqëzuara të parashtruara nga pala kundërshtare. Parashtrimi i pyetjeve plotësuese paraqet një mundësi për të eliminuar ose zvogëluar pasojat të cilat vijnë nga pyetjet e kryqëzuara të parashtruara nga pala kundërshtare. Kjo arrihet duke parashtruar pyetje shtesë, të lidhura me temat e mëparshme dhe drejtimin e dëshmitarit në pyetjet të cilat janë parashtruar gjatë kohës së parashtrimit të pyetjeve të kryqëzuara, me të vetmin qëllim që dëshmitari të japë sqarime shtesë për elemente të caktuara të cilat janë diskutuar gjatë parashtrimit të pyetjeve të kryqëzuara.⁷³

Marrja në pyetje përmes parashtrimit të pyetjeve plotësuese ofron një mundësi për të eliminuar ose zvogëluar pasojat e marrjes në pyetje nëpërmjet pyetjeve të kryqëzuara, d.m.th. për të sfiduar ose shpjeguar pyetjet që vijnë nga marrja në pyetje përmes pyetjeve të kryqëzuara. Nga dëshmitari mund të kërkohej të shpjegojë se pse deklarata e tij kundërshton deklaratën e tij të mëparshme ose nga ai mund të kërkohej që të korrigjojë gabimet e tij të bëra gjatë marrjes në pyetje të kryqëzuara dhe kështu ta lejojë atë të kompletojë dëshminë e tij.⁷⁴

Pas përfundimit të marrjes në pyetje nga ana e palëve, kryetari dhe anëtarët e trupit gjykues mund t'i bëjnë pyetje dëshmitarit përkatësisht ekspertit (neni 383 paragrafi 5). Pjesëmarrësit e tjerë procedural siç janë i dëmtuari, përfaqësuesit procedural, i bashkëpandehuri ose eksperti, mund t'i drejtojnë pyetje dëshmitarit ose ekspertit në mënyrë direkte vetëm me leje të gjyqtarit.⁷⁵

3.2. Dhënia e dëshmisë së rrejshme

Nevoja për arritjen e qëllimit të procedurës penale-konstatimit të së vërtetës dhe të shqiptimit të sanksionit penal kryerësit përgjegjës të veprës penale, kërkon ndriçimin e vërtetë të fakteve të rëndësishme. Për këtë arsye nga dëshmitari kërkohej që dëshmia e tij të përputhet me realitetin dhe çështjen konkrete penale. Rol kryesor në këtë drejtim luan edhe kujdesi i madh i organeve procedurale me rastin e shfrytëzimit të kësaj prove në anën tjetër. Dëshmia e rrejshme nga ana e dëshmitarit në procedurë penale ka ekzistuar nga e kaluara dhe vazhdon përsëri të ekzistojë. Dhënia e dëshmisë së rrejshme ka qenë e sanksionuar edhe në të kaluarën dhe gjithashtu edhe me legjislacionin penal bashkëkohor ajo vazhdon që të

⁷²Katerina Kolarevic, Zbatimi praktik i ligjit për procedurën penale, Marrja në pyetje e dëshmitarëve dhe ekspertëve në procedurat penale, Shkup.

⁷³<https://www.scribd.com/doc/300046866/Akademija-ZKP-Modul-3-Priracnik-Glavna-Rasprava>

⁷⁴Po aty.

⁷⁵E.Sahiti & I.Zejneli, E drejta e procedurës penale, Shkup 2017, fq 255.

sanksionohet dhe është e paraparë si vepër penale. Dhënia e dëshmisë së rrejshme nga ana e dëshmitarit vështirëson zbulimin e së vërtetës në procedurë penale e me këtë i shkakton edhe dëm funksionimit të drejtë të gjyqësisë.⁷⁶

Dëshmitari në të gjitha procedurat gjyqësore ka rëndësinë e tij të veçantë. Rëndësia e dëshmitarit në procedurë penale është më e rëndësishme se sa në procedurat tjera gjyqësore. Në disa çështje penale në të cilat nuk ka shumë prova të tjera me të cilat mund të provohet ose të vërtetohet fajësia ose mosfajësia e të pandehurit, rëndësia e dëshmisë së dëshmitarit është në radhë të parë. Për këtë arsye edhe dëshmisë së dëshmitarit i kushtohet rëndësi e veçantë edhe nga ana e gjykatës për të pasur edhe ato më të lehtë që të marrin vendimin e drejtë mbi çështjen e caktuar penale. Në bazë të kësaj çdoherë ekziston nevoja shoqërore që dëshmitarët gjithmonë të flasin të vërtetën para gjykatës dhe organeve tjera shtetërore, ku realisht të vërtetën mbi çështjen e caktuar penale mund ta dëshmojnë vetëm ata dëshmitarë të cilët e dinë të vërtetën.

Dëshmitarët në procedurë penale konkrete jo çdoherë e thonë të vërtetën. Dhënia e dëshmisë duke mos u përputhur me realitetin nga ana e dëshmitarit jo përherë jepet me vullnetin e tij. Në shumicën e rasteve dhënia e dëshmisë së rrejshme nga ana e dëshmitarit jepet për arsye të kërcënimeve që i bëhen atij ose të afërmëve të tij nga ana e të pandehurit ose personit tjetër i cili ka interes nga ajo procedurë penale konkrete. Në këto raste, dëshmitari për shkak të rrezikut që i kanoset dhe i drejtohet atij duke mbrojtur veten e tij si dhe të afërmit e tij, në procedurë penale konkrete detyrohet që të japë dëshmi e cila nuk përputhet me gjendjen reale.

Në disa raste dëshmitari vendos që të japë dëshmi të rrejshme me vetëdije dhe me vullnetin e tij duke pranuar favore të ndryshme të cilat mund të jenë të holla ose dhurata me vlera të mëdha, ku në çështjen penale konkrete jep dëshmi e cila nuk përputhet me realitetin, mirëpo favorizon palën e cila ka ofruar favore ndaj tij që t'ia arrijë qëllimit në procedurë penale, pra të dalë i pafajshëm. Duke u bazuar në këto raste, mund të konkludojmë se dëshmia e rrejshme e dhënë nga ana e dëshmitarit e dëmton rëndë procedurën penale konkrete, në rastet kur vendimi gjyqësor mbështetet edhe në dëshminë e dëshmitarit e cila paraqitet si dëshmi e rrejshme e pavërtetuar nga ana e gjykatës.

Sipas nenit 367 paragrafi 1 të Kodit Penal të RMV-së, dëshmitari, eksperti, përkthyesi, apo interpretuesi i cili para gjykatës apo në procedurë administrative, kundërvajtëse apo disiplinore do të jep dëshmi të rrejshme, do të dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre muaj.⁷⁷

Fatkeqësisht edhe në kohën bashkëkohore numërohen raste të dhënies së dëshmisë së rrejshme në procedurë penale për arsye të ndryshme. Gjatë realizimit të intervistave me prokurorët dhe gjykatësit, të gjithë konstatuan se në përvojën e tyre si prokuror ose gjykatës në procedurë penale kanë hasur raste të dhënies së dëshmisë së rrejshme.

Rastin nga përvoja praktika të cilën e përmendi gjykatësi Z. Adi Useini kishte të bënte me një rrahje, ku babai me djalë bashkarisht kanë rrahur një djalë nga një fshat i Strugës. Në procedurë penale, viktimë e kësaj vepre penale e mohon se ata persona e kanë rrahur atë,

⁷⁶E. Sahiti, dëshmia e dëshmitarit si provë në procedurë penale, Prishtinë 1993, fq 120.

⁷⁷Afrim Osmani, Kodi Penal i RMV-së, Shkup 2010, neni 367, paragrafi (1).

sepse ai kishte marrë të holla nga ata për të mos treguar të vërtetën, në mënyrë që të shfajësohen ata dhe të shpallen të pafajshëm.

3.3. Ballafaqimi i dëshmitarëve

Ballafaqimi i dëshmitarëve në procedurë penale paraqet një veprim procedural të cilin e ndërrmarin autoritetet kompetente në rastet kur paraqiten mosmarrëveshje, dallime dhe kontradikta të caktuara në deklaratat e dhëna më parë nga dëshmitarët në procedurë penale. Në rastet kur ka paqartësi, hezitim, kundërshtim në deklaratat e dëshmitarëve në procedurë penale, atëherë realizohet përballja e dy dëshmitarëve në të njëjtën kohë.⁷⁸

Ballafaqimi i dëshmitarëve në procedurë penale ka efekt pozitiv, sepse përmes këtij veprimi, gjykata vërteton besueshmërinë e një deklarate të dhënë më parë si dhe përmes ballafaqimit e zbulon se cili nga dëshmitarët gjatë dhënies së dëshmisë ka dhënë dëshmi të rrejshme ose deklaratë jo të plotë. Gjykata gjatë këtij procesi duhet me kujdes të ndjekë vijimin e procesit, ngaqë gjatë kësaj faze nga ana e dëshmitarëve mund të paraqiten edhe njohuri të reja mbi faktet dhe rrethanat e personit të dënuar. E gjithë rrjedha dhe përmbajtja e deklaratave të dëshmitarëve të ballafaquar regjistrohet në procesverbal.

Ballafaqimit të dëshmitarëve në procedurë penale edhe në aspektin praktik i jepet rëndësi dhe përparsi e veçantë, për shkak se gjykata në mënyrë tjetër e ka të vështirë të arrijë deri tek vërtetimi se cila dëshmi është në kundërshtim me realitetin dhe se cili nga dëshmitarët jep dëshmi kontradiktore.

Në konsultime me gjykatësit dhe prokurorët gjatë realizimit të intervistave me shkrim, ato konsideronin ballafaqimin e dëshmitarëve me rëndësi të veçantë dhe sidomos kur bëhet fjalë për vepra të rënda penale, kur për gjykatën është shumë e vështirë të arrijë deri tek e vërteta dhe me këtë rast përmes ballafaqimit të dëshmitarëve, gjykatësit i bëhet më e qartë se cili dëshmitar ka dhënë dëshmi të rrejshme dhe thënia e tij ka qenë kontradiktore, kurse dëshmia e vërtetë e dëshmitarit tjetër paraqet një faktor të rëndësishëm dhe hap lehtësues për vazhdimin në fazat e mëtejshme dhe marrjen e një vendimi të drejtë duke u bazuar në prova dhe fakte relevante.

4. Mbrojtja e dëshmitarëve të rrezikuar

Duke pasur parasysh dinamikën e lëvizjes së procedurës penale, jo çdoherë procesi i dhënies së dëshmisë së dëshmitarit vijon në mënyrën e duhur, sepse në praktikë paraqiten situatat kur dëshmitari është i rrezikuar nga faktorë të ndryshëm në dhënien e dëshmisë mbi rastin konkret ashtu siç ai e ka perceptuar me shqisën e të pamurit ose siç e ka dëgjuar nga personat e tjerë. Këto situata paraqiten atëherë kur ndaj dëshmitarit ushtrohet presion ose kërcënim direkt me qëllim që të heqë dorë nga dhënia e dëshmisë së drejtë, duke i drejtuar kërcënime për jetën dhe shëndetin e tij e sidomos në disa raste edhe drejtimin e kërcënimeve ndaj familjes së tij. Këto raste ndonjëherë e shtyjnë dëshmitarin që të heqë dorë nga dhënia e dëshmisë së drejtë për t'i larguar kërcënimet të cilat vijnë në drejtim të tij ose familjes së tij.

⁷⁸ Azem Hajdari, Procedura Penale Komentar, Prishtinë 2010, fq. 441.

Mirëpo, në legjislacionin penal të RMV-së janë parashikuar dispozita ligjore të cilat u ofrojnë ndihmë dëshmitarëve të cilët janë përballur me këtë lloj rreziku.

Nëse sipas nenit 226 paragrafi (1) të LPP-së, shfaqen indicjet se me dhënien e dëshmisë ose përgjigjen e disa pyetjeve të caktuara, dëshmitari, bashkëpunëtori i drejtësisë ose viktimë do të ekspozonin veten ose të afërmit e tij në një rrezik serioz për jetën e tyre, shëndetin ose integritetin fizik, dëshmitari i rrezikuar mund ta vonojë dhënien e dëshmisë ose zbulimin e të dhënave nga neni 219 paragrafi (3) i LPP-së derisa të sigurohen kushtet për mbrojtjen e tij.⁷⁹

Ligji nuk specifikon se kush duhet të kërcënojë një rrezik të tillë, por është logjike para së gjithash të vijë nga kryesi dhe bashkëpunëtorët e tij ose të afërmit, pa përjashtuar mundësinë që rreziku të vijë edhe nga një tjetër, një person i cili për disa arsye dëshiron ta ndihmojë kryesin të shmangë përgjegjësinë penale për të. Nëse Prokurori Publik konsideron se frika e rrezikut nga paragrafi (1) i nenit 226 të LPP-së është i bazuar, ai / ajo ndërpret hetimin dhe ndërmerr veprime urgjente në përputhje me dispozitat për mbrojtjen e dëshmitarëve, bashkëpunëtorëve të drejtësisë dhe viktimave të rregulluara me këtë ligj.⁸⁰

Sipas nenit 226 paragrafi (4) të LPP-së, nëse gjatë procedurës dëshmitari i rrezikuar deklaron se ai nuk dëshiron një mënyrë të veçantë të pjesëmarrjes dhe marrjes në pyetje, ai do të merret në pyetje sipas rregullave të përgjithshme për marrjen në pyetje të dëshmitarëve. Deklarata e mëparshme e dhënë sipas rregullave për një mënyrë të veçantë të marrjes në pyetje të një dëshmitari të kërcënuar mund të përdoret gjatë marrjes në pyetje dhe më pas do të ndahet nga dosjet dhe zarfi do t'i dorëzohet gjykatësit të procedurës paraprake për mirëmbajtje dhe ruajtjen e saj.⁸¹

4.1. Mbrojtja e dëshmitarëve të rrezikuar në procedure paraprake

Duke pasur parasysh se dëshmia e dëshmitarit paraqet një nga provat më të rëndësishme në procesin e të provuarit, duhet që t'i kushtohet rëndësi të veçantë për sigurimin e saj sa më të drejtë. Problemi mbi marrjen e dëshmisë së dëshmitarit paraqitet atëherë kur jeta e tij vihet në rrezik nga persona të cilët kanë interes në atë procedure penale. Në rastet kur paraqiten këto rreziqe për dëshmitarin në procedurën paraprake me të cilën udhëheq prokurori, duhet që duke u bazuar në dispozitat ligjore t'i sigurojë mbrojtje dëshmitarit dhe ambient të përshtatshëm që dëshmitari të japë dëshmi të drejtë dhe të saktë dhe procesi penal të vazhdojë me sukses edhe në fazat tjera të procedurës penale.

Sipas nenit 227 të LPP-së, sapo Prokurori Publik të vihet në dijeni për ekzistimin e rrethanave të parapara në nenin 226 të LPP-së, merr masa për mbrojtjen e dëshmitarit të rrezikuar. Prokurori Publik më pas për këto rrethana do të informojë dëshmitarin e rrezikuar. Ai me vendim, përcakton pseudonimin e dëshmitarit të rrezikuar, si dhe mënyrën e veçantë të pjesëmarrjes në procedurë dhe dhënien e dëshmisë. Gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarit të rrezikuar nuk marrin pjesë i pandehuri dhe mbrojtësi i tij, as i dëmtuari dhe përfaqësuesi i tij ligjor. Prokurori Publik i vulos të dhënat për dëshmitarin e rrezikuar në një zarf të veçantë

⁷⁹ Ligji I procedurës penale, gazeta zyrtare e RMV-së, nr. 150, prej 18.11.2010, neni 226, paragrafi (1).

⁸⁰ Po aty, neni 226 paragrafi (3).

⁸¹ Po aty, neni 226 paragrafi (4).

dhe i regjistron ato në dosje, duke përdorur pseudonimin e dëshmitarit të rrezikuar. Në zarf do të shënohet fakti se zarfi është hapur dhe në të do të shënohen emrat e anëtarëve të këshillit që do të njihen me përmbajtjen e tij. Pasi anëtarët e këshillit të njihen me përmbajtjen e tij, zarfi do të vuloset përsëri dhe do t'i kthehet Prokurorit Publik. Personat të cilët në çfarëdo aftësie do të zbulojnë informacionin në lidhje me dëshmitarin e rrezikuar, janë të detyruar ta mbajnë atë si informacion të kualifikuar.⁸²

4.2. Mbrojtja e dëshmitarëve të rrezikuar në seancën kryesore

Rreziku për dëshmitarin paraqitet më së shumti në dhënien e dëshmisë së tij në seancën kryesore, për çështjen konkrete penale. Nevoja e ofrimit të mbrojtjes nga rreziku në këtë fazë është shumë e rëndësishme, sepse nga kjo do të varet nëse dëshmitari do të japë dëshminë nën ndikimin e kërcënimeve të pranuar ose nën ndikimin e ofrimit të mbrojtjes duke u bazuar në dispozitat ligjore. Është e qartë dhe e kuptueshme se nëse lejohet që dëshmitari të japë dëshminë nën ndikimin e kërcënimeve si dhe faktorëve të tjerë negative të cilat ai i ka pranuar, nuk është se do të presim dëshmi të saktë dhe të drejtë.

Sipas nenit 228 të LPP-së, Prokurori Publik në zarf të mbyllur i paraqet një propozim të arsyetuar me shkrim gjyqtarit ose dhomës së vlerësimit të aktakuzës gjatë paraqitjes së aktakuzës për mënyrën e veçantë të shqyrtimit të dëshmitarit të rrezikuar, me çrast në afat prej 48 orëve nga marrja e propozimit, gjykata është e detyruar që me vendim të vendosë mbi propozimin e Prokurorit Publik. Nëse gjykata pranon propozimin e Prokurorit Publik, do të përcaktojë me vendim pseudonimin e dëshmitarit të rrezikuar, nëse nuk është përcaktuar deri më tani, si dhe mënyrën e veçantë të pjesëmarrjes në procedurë dhe dhënies së dëshmisë. Kundër vendimit të gjykatës nuk lejohet asnjë ankesë.⁸³

Duke pasur parasysh dinamikën e zhvillimit të procedurës penale si dhe rëndësinë e dëshmisë së dëshmitarit në procedure penale, në rastet kur paraqiten këto pengesa është shumë e rëndësishme që dëshmitarit konkret t'i vihet në ndihmë duke i ofruar metoda ose mënyra të cilat veten ose familjen e tij do ta largonin nga rreziku.

Seanca kryesore zhvillohet me hapa të kujdesshme me qëllim që në përfundim e gjithë procedura të ketë sukses. I gjithë sukcesi i procedurës penale konkrete mund të varet edhe nga dëshmia e dëshmitarit dhe për këtë arsye edhe legjislacioni vendas i ka të parapara metodat përmes të cilave personit i cili paraqitet si dëshmitar në çështjen penale konkrete t'i ofrohet ndihmë për të larguar nga ai rreziku i cili mund t'i kanoset atij në mënyrë të drejtpërdrejtë, por gjithashtu edhe rreziku i cili mund t'i drejtohet familjes si dhe të afërmeve të tij.

Mbrojtja e dëshmitarit nga rreziqet të cilat mund t'i kanosen, nënkupton atë se ndaj tij duhet të lejohet ndërmarrja e metodave mbrojtëse me të cilat nuk do të zbulohet identiteti i tij dhe ai në atë procedurë penale do të mbetet person anonim.

⁸²Ligji I procedurës penale, gazeta zyrtare e RMV-së, nr.150, prej 18.11.2010, neni 227.

⁸³Po aty, neni 228.

4.2.1. Marrja në pyetje nën pseudonim

Dëshmitari i mbrojtur është një person i cili tashmë ka statusin e dëshmitarit sipas rregullave të përgjithshme procedurale, por për shkak të rrethanave të caktuara (rrezik për jetën, shëndetin, lirinë ose pasurinë e dëshmitarit ose të afërmeve të tij të ngushtë) gjykata i jep atij një status të dëshmitarit të mbrojtur.⁸⁴

Sipas nenit 229 paragrafi (1) të LPP-së, nëse mënyra e veçantë e marrjes në pyetje të dëshmitarit i referohet vetëm fshehjes së të dhënave personale, ekzaminimi do të bëhet me pseudonim, pa specifikuar të dhënat e tjera të përmendura në nenin 219 paragrafi (3) i këtij ligji. Në pjesën tjetër marrja në pyetje do të zhvillohet sipas dispozitave të përgjithshme të përcaktuara sipas legjislacionit për marrjen në pyetje të dëshmitarëve.

Kjo metodë e hetimit përdoret kur mbrojtja e dëshmitarit të rrezikuar kërkon që vetëm identiteti i tij të fshihet. Në atë rast, marrja në pyetje do të bëhet nën një pseudonim dhe asnjë informacion nuk do të jepet mbi dëshmitarin në lidhje me identitetin e tij, vendbanimin ose profesionin. Pas përfundimit të marrjes në pyetje të dëshmitarit të rrezikuar në procedurë paraprake, ai firmos proesverbalin me pseudonimin e caktuar për të. Procesverballi nuk nënshkruhet në seancën kryesore. Personat të cilët në çfarëdo aftësie do të zbulojnë informacionin në lidhje me dëshmitarin e rrezikuar, janë të detyruar ta mbajnë atë si informacion të klasifikuar.⁸⁵

Në rastet kur dëshmitarit i ofrohet mundësia e marrjes në pyetje nën pseudonim atij i ofrohet mundësia e mbrojtjes së identitetit të tij nga rreziku i cili i kanoset, por jo edhe mbrojtje të dëshmisë së tij nëse ai jep dëshmi të rrejshme.

Duke analizuar nenin e lartpërmendur, deri tek caktimi i një pseudonimi vijmë në rastet kur ndaj personit icili paraqitet në cilësinë e dëshmitarit paraqiten rreziqe të ndryshme, me ç'rast ai në procedurën penale konkrete do të paraqitet me një emër dhe mbiemër të rrejshëm ose të ndryshëm nga ai origjinali me qëllim që të mos kuptohet se për cilin dëshmitar në të vërtetë bëhet fjalë. Ky faktor do t'i japë siguri dhe vetbesim dëshmitarit që duke pasur parasysh mbrojtjen e ofruar, të japë dëshmi të drejtë dhe të saktë.

4.2.2. Marrja në pyetje duke përdorur pajisje teknike për transmetimin e imazhit dhe tonit

Sipas nenit 230 paragrafi (1) të LPP-së, nëse mënyra e veçantë e pjesëmarrjes në procedurë dhe marrja në pyetje e dëshmitarit të rrezikuar ka të bëjë me fshehjen e të dhënave të përmendura në nenin 219 paragrafi (3) të këtij ligji dhe fshehjen e paraqitjes së dëshmitarit të rrezikuar, marrja në pyetje do të kryhet me ndihmën e pajisjeve teknike për përcjelljen e fotografisë dhe tonit, me ç'rast imazhi dhe zëri i dëshmitarit të rrezikuar do të shfaqet i ndryshuar.⁸⁶

⁸⁴M.Škulić, E drejta e procedurës penale, Sërbi 2009, fq.231

⁸⁵G.Kalajdziev, G.Lazetic, L.Nedelkova, M.Denkovska, M.Trombeva, T.Vitlarov, P.Jankulovska, D.Kadiev
Komentimi i Ligjit të procedurës penale, Shkup 2018, neni 229.

⁸⁶Po aty, neni 230 paragrafi (1).

Me rastin e marrjes në pyetje të dëshmitarit të rrezikuar, në përputhje me nenin 230 paragrafin 1, ai mund të jetë i vendosur në një dhomë të veçantë të ndarë fizikisht nga dhoma ku ndodhet gjyqtari dhe të gjithë pjesëmarrësit e tjerë në procedurë.⁸⁷

Në rastet kur vërtetohet se personi i cili do të paraqitet në cilësinë e dëshmitarit, me dhënien e dëshmisë së tij do të rrezikojë jetën e tij ose të familjes së tij, do t'i mundësohet që marrja në pyetje në cilësinë e dëshmitarit të realizohet përmes kësaj metode ose mënyre të veçantë, me ç'rast dëshmitari dëshminë e tij e jep në dhomë të veçantë ku me ndihmën e pajisjeve teknik do të ndysohet zëri dhe pamja e dëshmitarit, pra dëshmitari e jep dëshminë personalisht, kurse deri tek pjesëmarrësit në procedurën penale konkrete vjen zëri dhe pamja e cila nuk përputhet me karakteristikat e dëshmitarit. E gjithë kjo procedurë zhvillohet me qëllim që të mos kuptohet nga të pranishmit e posaçërisht nga ata të cilët edhe mund të vënë në rrezik jetën e tij ose të familjes së tij, se për cilin person bëhet fjalë.

4.2.3. Marrja në pyetje e viktimave dhe dëshmitarëve posaçërisht të pambrojtur

Sipas nenit 232 paragrafi (1) të LPP-së, pala e dëmtuar dhe dëshmitari për të cilin organi që zhvillon procedurat do të përcaktojë se duke pasur parasysh moshën, gjendjen shëndetësore, natyrën ose pasojat e veprimit kriminal, ose për shkak të rrethanave të tjera të çështjes, ata janë viktimë veçanërisht të prekshme të trafikimit me të mitur, dhunës ose abuzimit seksual dhe që marrja në pyetje në ambientet e organit që zhvillon procedurat do të ketë efekte të dëmshme në shëndetin e tyre mendor ose fizik, do të merren në pyetje në mënyrën e përcaktuar në nenin e lartpërmendur.

Gjatë tërë ekzaminimit të një viktime të dëmtuar ose dëshmitari, organi që zhvillon procedurën është i detyruar ta trajtojë viktimën ose dëshmitarin me kujdes të veçantë për të shmangur efektet e dëmshme që procedura penale mund të ketë tek personi fizik, sa i përket aspektit mendor, shëndetit të viktimës ose dëshmitarit të cënueshëm. Gjithashtu, për të siguruar një mbrojtje më të rëndësishme ndaj kësaj kategorie të dëshmitarëve, ligjvënësi ka përcaktuar që pyetjet e viktimës ose dëshmitarit të cënueshëm duhet të parashtrihen vetëm përmes organit që zhvillon procedurën penale. Gjatë marrjes në pyetje të viktimës ose dëshmitarit posaçërisht të pambrojtur, mund të përdoret ndihma nga një ekspert siç mund të jetë ndihma e psikologut, pedagogut ose eksperti tjetër. Për këtë çështje vendos organi i cili zhvillon procedurën se a do të përdoret kjo ndihmë. Ekzaminimi i një viktime ose dëshmitari të prekshëm, gjithashtu mund të bëhet në atë mënyrë që viktimë ose dëshmitari i cënueshëm të ndahet fizikisht nga palët dhe mbrojtësit, si dhe nga personat e tjerë që mund të bëjnë pyetje, në një dhomë të veçantë dhe në këtë rast viktimë ose dëshmitari i cënueshëm do të identifikohet përmes organit që zhvillon procedurën, si dhe ndërmjetësohet nga eksperti i pranishëm. Gjykata gjithashtu mund të vendosë të përjashtojë publikun kur merr në pyetje një viktimë ose dëshmitar të cënueshëm, nëse konsideron se është në interes të viktimës ose

⁸⁷ G.Kalajdziev, G.Lazetic, L.Nedelkova, M.Denkovska, M.Trombeva, T.Vitlarov, P. Jankulovska, D.Kadieva
Komentimi i Ligjit të procedurës penale, Shkup 2018, neni 230 paragrafi (2).

dëshmitarit. Një masë e tillë është veçanërisht e rëndësishme kur një fëmijë është viktimë ose dëshmitar i cënueshëm (neni 147 i Ligjit për të drejtat e fëmijës).⁸⁸

Marrja në pyetje e viktimave dhe dëshmitarëve posaçërisht të pambrojtur kërkon një përkushtim të madh, sepse bëhet fjalë për një kategori të personave të cilët kërkojnë përkushtim të veçantë. Pra bëhet fjalë për dëshmitar i cili është prekur nga veprimi kriminal dhe me këtë rast ai trajtohet si viktimë e veprimit kriminal. Edhe ndaj dëshmitarëve posaçërisht të pambrojtur, kërkohet kujdes i veçantë për të shmangur rreziqet të cilët mund të paraqiten duke vënë në rrezik fillimisht jetën e tij, por gjithashtu edhe të të afërmeve dhe familjarëve të tij. Këto kategori personash kërkojnë përkujdesje më të veçantë gjatë marrjes së dëshmisë, sepse duhet pasur parasysh natyrën e tyre, rreziqet të cilat i kanë kaluar e sidomos ndaj viktimave të cilët paraqiten në cilësinë e dëshmitarit, sepse bëhet fjalë për persona të cilët mund të kenë kaluar trauma të intesitetit të lartë, persona ndaj të cilëve është përdorur dhunë psikike dhe fizike.

⁸⁸ G. Kalajdziev, G. Lazetic, L. Nedelkova, M. Denkovska, M. Trombeva, T. Vitlarov, P. Jankulovska, D. Kadiev
Komentimi i Ligjit të procedurës penale, Shkup 2018, neni 232.

Kapitulli III

Shqyrtimi i dëshmisë së dëshmitarit si provë në procedurë penale të Shqipërisë

1. Dëshmia e dëshmitarit si provë në procedurë penale të Shqipërisë

Dëshmia paraqet një provë të rëndësishme që paraqitet pothuajse në të gjitha procedurat penale e cila shërben për vërtetimin e fakteve dhe rrethanave të kryerjes së veprës penale, për zbulimin e motivit të saj dhe vërtetimin e fajësisë së të pandehurit.⁸⁹

Me nocionin “dëshmitar” duhet kuptuar personin e pazëvendësueshëm dhe të ndryshëm nga i dyshuari dhe i pandehuri, i cili me ftesë të organit të procedurës penale dëshmon për faktet të cilat janë objekt i konstatimit në procedurë dhe i cili i ka të njohura përmes perceptimit shqisor. Dëshmitari në procedurë penale pyetet për faktet që përbëjnë objekt prove. Ai nuk mund të dëshmojë për çka flitet në publik dhe as të shprehë vlerësime personale, me përjashtim të rasteve kur ato nuk mund të ndahen nga dëshmia për faktet.

Si dëshmitar paraqitet personi i cili ka zotësi për të dëshmuar, me përjashtim të atyre që, për shkak të tëmetave mendore ose fizike, nuk janë në gjendje të dëshmojnë.⁹⁰

1.1. Personat të cilët mund të merren në pyetje si dëshmitar në bazë të nenit 156 të KPP-së të Shqipërisë

Sipas nenit 156 paragrafi (1), të Kodit të Procedurës Penale të Shqipërisë, si dëshmitarë nuk mund të pyeten:

- personat që për shkak të të metave fizike ose psikike, nuk janë në gjendje të bëjnë dëshmi të rregullt;
- të pandehurit në një vepër penale të përbashkët ose në një procedim të lidhur edhe kur ndaj tyre është dhënë vendimi i mosfillimit të çështjes, i pafajësisë ose i dënimit, me përjashtim të rasteve kur vendimi i pafajësisë ka marrë formë të prerë;
- ata që në të njëjtin procedim kryejnë ose kanë kryer funksionin e gjyqtarit ose të prokurorit;
- i padituri civil.⁹¹

Në bazë të nenit të lartpërmendur, këto persona sipas KPP-së nuk mund të paraqiten në cilësinë e dëshmitarit për shkak të paraqitjes së rrethanave të cilat e bëjnë të paaftë atë për shkak të të metave fizike ose psikike si dhe arsytet e tjera të cilat janë përmendur në nenin e lartpërmendur. Në këto raste, legjislacioni në mënyrë të përpiktë dhe shumë rigoroze përcakton se personat e përcaktuar sipas nenit 156 paragrafi (1) të KPP-së të Shqipërisë nuk mund të paraqiten në cilësinë e dëshmitarit në çështjen penale konkrete, sepse dhënia e dëshmisë nga dëshmitarët e përcaktuar në nenin e lartpërmendur bien ndesh me dispozitat ligjore të Kodit të Procedurës Penale të Shqipërisë.

⁸⁹H. Islami, A. Hoxha, I. Panda, Procedura penale, Tiranë 2010, fq 208.

⁹⁰Kodi i procedurës penale, Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare, Tetor 2011, neni 155 paragrafi (1).

⁹¹Po aty, neni 156 paragrafi (1).

1.2. Personat të cilët nuk detyrohen që të dëshmojnë sipas KPP-së të Shqipërisë

Sipas nenit 158 paragrafi (1), të Kodit të Procedurës Penale të Shqipërisë, nuk janë të detyruar të dëshmojnë:

- gjinia ose krushqia e afërt e të pandehurit, sipas përcaktimeve të nenit 16, me përjashtim të rasteve kur kanë bërë kallëzim ose ankim, ose kur ata apo një i afërm i tyre janë të dëmtuar nga vepra penale;
- bashkëshorti për faktet e mësuara nga i pandehuri gjatë jetës bashkëshortore;
- bashkëshorti i ndarë nga i pandehuri;
- ai që edhe pse nuk është bashkëshort i të pandehurit, bashkëjeton ose ka bashkëjetuar me të;
- ai që është i lidhur me të pandehurin me marrëdhënie birësi.⁹²

Duke analizuar nenin 158 paragrafin (1), të KPP-së vërejmë se detyra e dëshmitarit në këto raste nuk është në mënyrë rigorozë e ndaluar, por ajo adreson në atë se disa persona janë të liruar nga procedura e dëshmitarit ose dhënies së dëshmisë në çështjen penale konkrete, për shkak të raporteve të afërta të cilat i ka pasur me të pandehurin ose ende vazhdon t'i ketë dhe në disa raste dhënia e dëshmisë në dëm të pandehurit mund të adresojë edhe në krijimin e raporteve negative dhe shfaqjen e problemeve edhe më të mëdha. Për këtë arsye edhe ndaj këtyre personave të cilët thirren në cilësinë e dëshmitarit nuk përcaktohen dispozita ligjore të detyrueshme, por shkohet në atë drejtim që të arsyetohet rasti se a janë të përshtatshme rrethanat për t'u paraqitur në cilësinë e dëshmitarit ose jo.

1.3. Ruajtja e sekretit profesional

Në bazë të nenit 159 paragrafi (1), të Kodit të Procedurës Penale të Shqipërisë, që bën fjalë për ruajtjen e sekretit profesional, nuk mund të detyrohen të dëshmojnë për sa dinë për shkak të profesionit të tyre, me përjashtim të rasteve kur kanë detyrimin që t'ua referojnë autoriteteve proceduese:

- përfaqësuesit e besimeve fetare, statutet e të cilëve nuk janë në kundërshtim me rendin juridik shqiptar;
- avokatët, përfaqësuesit ligjorë dhe noterët;
- mjekët, kirurgët, farmacistët, obstetrët dhe kushdo që ushtron një profesion shëndetësor;
- ata që ushtrojnë profesione të tjera, të cilëve ligji u njeh të drejtën të mos dëshmojnë për ato që lidhen me sekretin profesional.⁹³

Në procedurë penale gjatë dhënies së dëshmisë nga ana e dëshmitarit nuk është e lejuar që çdoherë të dëshmojë për gjithçka, sepse në disa raste paraqiten rrethana të cilat dëshmitarin nuk e lejojnë të dëshmojë për disa çështje të cilat sipas legjislacionit njihen si sekrete profesionale. Në rastin kur vinë në shprehje për të dëshmuar mbi çështjet e sekretit profesional, lejimi i dhënies së kësaj të drejte përcaktohet vetëm në rastet e përcaktuara me ligj dhe kur është në interes të procedurës penale. Pra, ajo e cila është e përcaktuar si sekret

⁹²Kodi I procedurës penale, Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare, Tetor 2011, neni 158 paragrafi (1).

⁹³http://www.pp.gov.al/web/kodi_i_procedures_penale_date_30_gusht_2017_1201.

profesional e cila në të shumtën e rasteve nënkupton ruajtjen e sekreteve të cilat janë në interes të profesionit të cilin e ushtrojnë dhe nuk duhet të shndërrohen në çështje të cilat më nuk janë sekrete, ngaqë jep një ndikim negativ në mënyrën e kryerjes së profesionit të tij e cila mund të ndikojë në humbjen e besimit tek personat të cilët kryejnë ato profesione.

1.4.Ruajtja e sekretit shtetëror

Në bazë të nenit 160 të Kodit të Procedurës Penale të Shqipërisë, që bën fjalë për ruajtjen e sekretit shtetëror, nënpunësit shtetëror, nënpunësit publikë dhe të ngarkuarit me një shërbim publik janë të detyruar të mos dëshmojnë për faktet që janë sekrete shtetërore. Për ato fakte të cilat pretendohet se janë sekret shtetëror, organi kompetent duhet që brenda afatit prej 30 ditëve të bëjë konfirmimin se ato fakte përbëjnë sekret shtetëror dhe nëse brenda këtij afati nuk jep konfirmim, atëherë gjykata urdhëron pyetjen e dëshmitarit. Mirëpo, nëse organi kompetent jep konfirmim se ato fakte përbëjnë sekret shtetëror dhe ky fakt nuk përbën provë thelbësore në zgjidhjen e çështjes konkrete për fajësinë ose pafajësinë e të pandehurit, dëshmitari nuk merret në pyetje. Nëse në të kundërt, fakti është një ndër provat thelbësore në zgjidhjen e çështjes pa të cilën nuk mund të përcaktohet fajësia apo pafajësia e të pandehurit, gjykata është e detyruar të vendosë pezullimin e çështjes penale deri në konfirmimin e faktit nga një instancë më e lartë e administratës shtetërore. Pas kësaj, dëshmitari detyrohet të dëshmojë.⁹⁴

Sipas nenit të lartpërmendur, si ruajtje të sekretit shtetëror nënkuptohen të gjitha ato veprime, punë si dhe çështje të cilat personi i ka mësuar ose ka ardhur në dijeni për ato gjatë kryerjes së marrdhënies së punës, konkretisht në sektorin publik. Kur vjen në shprehje që këto persona të thirren në cilësinë e dëshmitarit, legjislacioni e konteston këtë çështje, sepse faktet të cilat janë sekret shtetëror nuk duhet të transmetohen tek personat tjerë, por ato duhet të mbeten sekrete, ngaqë janë në interes të shtetit dhe transmetimi i tyre mund të jepte ndikim negativ.

Në rastet kur dëshmia e dëshmitarit paraqet provën kryesore mbi të cilën përcaktohet fajësia e dëshmitarit, atëherë lejimin e saj duhet ta jepë instanca më e lartë e administratës shtetërore siç është theksuar në nenin 160 të KPP-së të Shqipërisë.

1.5.Përjashtimi i sekretit

Në bazë të nenit 161 të Kodit të Procedurës Penale të Shqipërisë, përjashtimi i sekretit është rregulluar si në vijim:

1. Nuk mund të jenë objekt i sekretit shtetëror të dhënat ose dokumentet që lidhen me veprat penale, të cilat synojnë përmbysjen e rendit kushtetues. Natyra e veprës penale përcaktohet nga organi procedues.
2. Kur nuk pranohet përjashtimi i sekretit njoftohet organi kompetent shtetëror.⁹⁵

⁹⁴H.Islami,A.Hoxha,I.Panda., Procedura Penale ,Tiranë 2010,fq.212

⁹⁵Kodi I procedurës penale, Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare, Tetor 2011,neni 161

Duke u bazuar në nenin 161 të KPP-së të Shqipërisë përcaktohen përjashtime në rastet kur vjen në shprehje interesi i shtetit. Pra, në këto raste nuk vjen parasysh lejimi i dëshmitarëve që të mbajnë të fshehtë ose të mos japin informacione mbi të dhënat ose dokumentet që lidhen me veprën penale, të cilat synojnë ngecjen e organizimit dhe funksionimit të rendit shtetëror në vend ose thënë ndryshe synimin e përmbysjes së rendit kushtetues. Fshehja e çdo informate e cila adreson në përmbysjen e rendit kushtetues është e ndaluar dhe sanksionuar në bazë të dispozitave ligjore .

2. Thirrja e dëshmitarit për të dëshmuar

Duke pasur parasysh rëndësinë e dëshmisë së dëshmitarit në procedurë penale duhet kushtuar një rëndësi të veçantë, sepse në disa raste edhe vendimi gjyqësor mund të bazohet në dëshminë e dëshmitarit.

E gjithë procedura mbi thirrjen dhe marrjen në pyetje të dëshmitarit në procedurë penale është e rregulluar sipas Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë. Thirrja e dëshmitarit për të dëshmuar në procedurë penale bëhet përmes dërgimit të shkresës me të cilën urdhërohet që të paraqitet në vendin, ditën dhe orën e caktuar.

Duke u bazuar në **nenin 157 të Kodit të Procedurës Penale të Shqipërisë**, dëshmitari është i detyruar që të paraqitet në gjykatë, t'u përmbahet urdhërave të saj dhe t'u përgjigjet me vërtetësi pyetjeve që i bëhen. Mirëpo, në rastin kur dëshmitari i thirrur rregullisht nuk paraqitet në gjykatë në ditën dhe orën e caktuar, pa pasur pengesa të paligjshme, atëherë ndaj tij mund të urdhërohet shoqërimi i detyrueshëm ose të vendosë gjobë deri në masën 30.000 lekë.⁹⁶

Sipas Kodit të Procedurës Penale të Shqipërisë, provat në shqyrtim gjyqësor merren sipas një radhe të caktuar, ku në fillim dëgjohen provat që ka kërkuar ai që akuzon (prokurori ose i dëmtuari akuzues) e mandej vazhdohet me provat e paraqitura nga i pandehuri, paditësi dhe i padituri civil. Nga e gjithë kjo me rëndësi janë respektimi i rregullave pikë për pikë të përcaktuara për marrjen në pyetje të dëshmitarit, sepse ato ndikojnë në rritjen e ndjenjës së përgjegjësisë tek dëshmitarët për të dëshmuar të vërtetën.

2.1. Procedura e marrjes në pyetje të dëshmitarit

Pasi dëshmitari i thirrur paraqitet në seancë, nga ana e kryetarit i shpjegohet detyrimi që ka për të dëshmuar dhe për të deklaruar vetëm të vërtetën, si dhe pasojat të cilat do të bien mbi të nëse ai refuzon të dëshmojë ose jep dëshmi të rrejshme. Ky paralajmërim u bëhet vetëm personave të moshës madhore, meqë ato i nënshtrohen përgjegjësisë penale, kurse dëshmitarëve të mitur deri në katërmëdhjetëvjeç nuk u bëhet ky paralajmërim, sepse ato nuk i nënshtrohen përgjegjësisë penale. Pas paralajmërimit, dëshmitarit i bëhet me dije se duhet të japë betimin, në të cilën thuhet: **“Betohe se do të them të vërtetën, t ë gjithë të**

⁹⁶H.Islami,A.Hoxha,I.Panda., Procedura Penale ,Tiranë 2010,fq.209

vërtetën dhe të mos them asgjë që nuk është e vërtetë”. Pas kësaj dëshmitari deklaroi: “betohem” dhe tregon gjeneralitetet e tij.⁹⁷

Sipas nenit 361 të Kodit të Procedurës Penale të Shqipërisë janë parashikuar rregullat për mënyrën e pyetjes së dëshmitarit, si në vijim:

1. Pyetja e dëshmitarëve bëhet fillimisht nga prokurori ose nga mbrojtësi a përfaqësuesi që ka kërkuar pyetjen. Më pas pyetja vazhdon nga palët, sipas radhës.
2. Kush ka kërkuar pyetjen mund të bëjë pyetje edhe pasi mbarojnë palët e tjera.
3. Ndalohen pyetjet që ndikojnë keq në paanësinë e dëshmitarit ose që synojnë në sugjerimin e përgjigjeve.
4. Për të ndihmuar kujtesën, dëshmitari mund të lejohet nga kryetari që të shikojë dokumentet e hartuara prej tij.
5. Shfuqizuar.
6. Gjatë pyetjes së dëshmitarit kryetari mund të bëjë pyetje dhe kur është rasti, ndërhyr për të siguruar radhën e pyetjeve, vërtetësinë e përgjigjeve, saktësinë e pyetjeve dhe të kundërshtimeve, si dhe për të garantuar respektimin e personit.
7. Dëshmitari mund të pyetet në distancë, brenda ose jashtë vendit, me anë të lidhjes audiovizive, duke respektuar rregullat e marrëveshjeve ndërkombëtare dhe dispozitat e këtij Kodi. Personi i autorizuar nga gjykata qëndron në vendin ku ndodhet dëshmitari dhe bën vërtetimin e identitetit të tij, si dhe kujdeset për zhvillimin e rregullt të marrjes në pyetje e për zbatimin e masave të mbrojtjes. Këto veprime ai i pasqyron në procesverbal.
8. Viktimat e veprave penale seksuale, veprave të trafikimit ose veprave të kryera brenda familjes, kur e kërkojnë, mund të pyeten si dëshmitarë nëpërmjet mjeteve audio dhe audiovizive.⁹⁸

Sa u përket rregullave për mënyrën e pyetjes së dëshmitarit në KPP-në e Shqipërisë, si dhe duke analizuar rregullat edhe sipas LPP-së të RMV-së mund të konkludojmë se në përgjithësi procedura dhe mënyra e pyetjes së dëshmitarëve në procedurën penale të dy shteteve është në përputhshmëri.

Sipas nenit 8 të ligjit nr.9110, datë 24.07.2003, për “Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave për Krime të Rënda”, Gjykata për Krime të Rënda dhe Gjykata e Apelit për Krime të Rënda mund të lejojnë që pyetja e dëshmitarit, si dhe ballafaqimet dhe leximet e lejueshme të bëhen duke i zbatuar, bashkërisht ose veçmas, rregullat vijuese:

- a) në praninë e të pandehurit dhe mbrojtësit, por pa kontakt vizual;
- b) pa i komunikuar të pandehurit dhe mbrojtësit identitetin e dëshmitarit;
- c) në raste dhe mënyra të tjera të caktuara sipas legjislacionit për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë.⁹⁹

⁹⁷H.Islami,A.Hoxha,I.Panda., Procedura Penale ,Tiranë 2010, fq.481.

⁹⁸http://www.pp.gov.al/web/kodi_i_procedures_penale_date_30_gusht_2017_1201.

⁹⁹http://www.gjykataelarte.gov.al/web/ligj_per_gjykatën_e_krimeve_te_renda_21.

2.1.1. Pyetja e dëshmitarëve të mbrojtur

Dëshmia e dëshmitarit jo çdoherë kalon në mënyrë të duhur dhe pa shfaqje të ndikimeve të jashtme. Duke pasur parasysh rëndësinë e dëshmisë së dëshmitarit në procedurë penale, se si provë mund të ndikojë edhe në sjelljen e vendimit gjyqësor nga ana e gjykatës duke u bazuar dhe duke e pranuar si provë të vlefshme, paraqiten edhe rastet kur ndaj dëshmitarëve drejtohen edhe kërcënime dhe shantazhe të formave të ndryshme për të mos deklaruar atë të cilën ai e ka perceptuar në rastin konkret ose atë që ai ka dëgjuar nga të tjerët mbi atë çështje. Për këtë arsye edhe në Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë janë parashikuar rregulla të veçanta për pyetjen e dëshmitarëve të mbrojtur. Kështu që, **sipas nenit 361/b të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë**, duhet respektuar këto rregulla për marrjen në pyetje të dëshmitarëve të mbrojtur:

1. Pyetja e bashkëpunëtorëve të drejtësisë, personave të infiltruar ose personave nën mbulim, e dëshmitarëve të mbrojtur dhe e dëshmitarëve me identitet të fshehur, zhvillohet nën masa të veçanta për mbrojtjen e tyre të cilat kryesisht përcaktohen nga gjykata ose me kërkesën e palëve. Kur disponon mjete teknike, gjykata mund të vendosë që marrja në pyetje e tyre të zhvillohet në distancë me anë të lidhjes audiovizive, sipas rregullave të parashikuara në pikën 7 të nenit 361.

2. Kur ndaj personit që do të pyetet është vendosur ndryshimi i identitetit, gjykata urdhëron marrjen e masave të përshtatshme për të bërë të mundur që fytyra dhe zëri i personit të mos jenë të dallueshëm për palët. Në rast se është e domosdoshme njohja e identitetit ose këqyrja e personit, gjykata urdhëron thirrjen ose shoqërimin e detyrueshëm për përmbushjen e këtij veprimi. Në këtë rast gjykata urdhëron marrjen e masave të nevojshme për të mënjeluar pamjen e dallueshme të fytyrës së personit, të cilit i është ndryshuar identiteti.

3. Gjkata nuk lejon që dëshmitarit, sipas paragrafit 1 të këtij neni, t'i bëhen pyetje që mund të zbulojnë identitetin e tij.¹⁰⁰

Për shkak të rëndësisë së dëshmisë së dëshmitarit në procedurë penale edhe në procedurën penale të Shqipërisë paraqiten raste kur ndaj personave të cilët shfaqen rreziqe me rastin e dhënies së dëshmisë, merren masa dhe mënyra me të cilat vihet deri tek mbrojtja e tyre.

Sipas nenit të lartpërmendur, në mënyrë precize përcaktohen mënyrat e marrjes në pyetje të dëshmitarëve të mbrojtur, ku në disa raste bëhet fjalë për fshehje të identitetit të dëshmitarit të mbrojtur, ndryshimin e identitetit, ndryshimi i fytyrës dhe zërit për të mos u kuptuar nga i pandehuri se për cilin dëshmitar bëhet fjalë. Të gjitha këto veprime ndërmerren me të vetmen arsye që dëshmitari të ndihet komod dhe i sigurt gjatë dhënies së dëshmisë dhe shmangies së rreziqeve të cilat mund t'i kanosen për shkak të dhënies së dëshmisë e cila mund të jetë në dëm të të pandehurit.

¹⁰⁰Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë, Botimi i Qendrës së Botimeve Zyrtare, Tiranë 2017, neni 361/b

2.1.2. Dëshmitari me identitet të fshehur

Sipas nenit 165/a,të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, është paraqitur forma e marrjes në pyetje e dëshmitarit me identitet të fshehur, si në vijim:

1. Kur dhënia e dëshmisë mund të vendosë dëshmitarin ose anëtarët e familjes së tij në rrezik serioz për jetën apo shëndetin dhe i pandehuri akuzohet për veprat penale të parashikuara nga nenet 230, 230/a, 230/b, 230/c, 230/ç, 231, 232, 232/a, 232/b, 234, 234/a,234/b, 265/a, 265/b, 265/c, si dhe nuk zbatohet programi i mbrojtjes së dëshmitarëve, gjykata me kërkesën e prokurorit mund të vendosë zbatimin e teknikave të veçanta të marrjes në pyetje, sipas nenit 361/ b të këtij Kodi.

2. Kërkesa e prokurorit i paraqitet kryetarit të trupit gjykues në një zarf të mbyllur, me shënimin: “Konfidenciale: dëshmitar me identitet të fshehur”. Në kërkesë prokurori parashtron arsyet për nevojën e përdorimit të një ose disa prej teknikave të veçanta të marrjes në pyetje.

3. Në zarfin me shënimin e mësipërm, prokurori depoziton edhe zarfin e mbyllur që përmban identitetin e plotë të dëshmitarit me identitet të fshehur. Vetëm kryetari i trupit gjykues njihet me identitetin e vërtetë të dëshmitarit me identitet të fshehur dhe verifikon zotësinë dhe papajtueshmërinë me detyrën e dëshmitarit, sipas parashikimeve të këtij Kodi. Në çdo rast, mbi zarf shënohen në mënyrë të dukshme data, emri, nënshkrimi dhe funksioni i personave që kanë hapur zarfin dhe atyre që janë njohur me të dhënat që përmban zarfi. Pas kryerjes së verifikimeve, zarfi me identitetin e vërtetë të dëshmitarit me identitet të fshehur i kthehet prokurorit.

4. Gjykata shqyrton kërkesën e prokurorit në dhomë këshillimi dhe vendos me vendim të arsyetuar brenda dyzet e tetë orëve nga paraqitja e kërkesës.

5. Prokurori mund të ushtrojë ankim kundër vendimit të gjykatës brenda dyzet e tetë orëve nga njoftimi i vendimit. Gjykata e apelit shqyrton ankimin në dhomë këshillimi dhe vendos mbi ankimin brenda dyzet e tetë orëve nga marrja e akteve. Ky vendim është i paankimueshëm.

6. Kur pranon kërkesën e prokurorit, gjykata vendos pseudonimin e dëshmitarit dhe procedurat e fshehjes së identitetit, njoftimit, paraqitjes dhe pjesëmarrjes në procedim. Pyetja e dëshmitarit kryhet sipas rregullave të parashikuara në nenin 361/b të këtij Kodi.

7. Dëshmitari merr pjesë në të gjitha fazat e gjykimit vetëm me pseudonimin e vendosur nga gjykata, përveç rastit të parashikuar nga paragrafi 8 i këtij neni.

8. Pyetja e dëshmitarit me identitet të fshehur dhe caktimi i pseudonimit të tij gjatë fazës së hetimeve bëhen nga prokurori. Aktet ku ai merr pjesë, nënshkruhen me pseudonimin e caktuar.¹⁰¹

Në nenin e lartpërmendur është përcaktuar mënyra e marrjes në pyetje e dëshmitarëve me identitet të fshehur, e cila vjen në shprehje në rastet kur dhënia e dëshmisë e vë në rrezik shëndetin dhe jetën e dëshmitarit, nëse dëshmitarit i lejohet të identifikohet me identitet të fshehur dhe përcakton pseudonimin me të cilin nuk mund të identifikohet nga i pandehuri si dhe personat tjerë nga të cilët mund t'i vijë rreziku për dëshminë e dhënë.

¹⁰¹Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë, Botimi i Qendrës së Botimeve Zyrtare,Tiranë 2017, neni 165/a

2.1.3. Pyetja e dëshmitarëve të mitur

Sipas Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur të Republikës së Shqipërisë, i mitur konsiderohet çdo person nën moshën 18 vjeç.

Organi procedues në procedurë penale ndërmerr të gjitha masat e duhura që njoftimi i të miturit për t'u paraqitur në cilësinë e dëshmitarit të jetë i suksesshëm, i përshtatshëm dhe i kuptueshëm, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose nëpërmjet përfaqësuesit ligjor/procedural. Në rast konflikti interesi me përfaqësuesin ligjor, ose kur për shkak të moshës shumë të mitur nuk mund të bëhet njoftim i drejtpërdrejtë i të miturit, njoftimi i tij bëhet nëpërmjet përfaqësuesit procedural, mbrojtësit ose psikologut.¹⁰²

Sipas nenit 361/a, të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, pyetja e dëshmitarit të mitur realizohet në këto mënyra:

1. Pyetja e dëshmitarit të mitur nën 14 vjeç bëhet pa praninë e gjyqtarit dhe të palëve në ambientin në të cilin ndodhet i mituri, kur është e mundur nëpërmjet mjeteve audiovizive. Pyetja bëhet nëpërmjet një psikologu, edukatori ose ndonjë eksperti tjetër dhe kur nuk është në kundërshtim me interesat e gjykimit ose të fëmijës, prindërit ose kujdestari mund të jenë të pranishëm gjatë marrjes në pyetje. Palët mund të kërkojnë dhe gjykata mund të vendosë kryesisht që i mituri të merret në pyetje nga gjyqtari në prani të ekspertit. I mituri mund të merret në pyetje sërish vetëm në raste të veçanta dhe në të njëjtën mënyrë.

2. Pyetja e dëshmitarit të mitur prej 14 deri në 18 vjeç kryhet nga kryetari i trupit gjykues. Gjatë marrjes në pyetje të të miturit tregohet kujdes i veçantë për të shmangur pasojat e dëmshme mbi shëndetin mendor të tij, veçanërisht kur është viktimë e veprës penale. Në përputhje me rrethanat, pyetja mund të bëhet në mënyrën e parashikuar në paragrafin 1 të këtij neni.

3. Në pyetjen e dëshmitarit të mitur deri në 14 vjeç, kryetari i trupit gjykues nuk zbaton rregullin për paralajmërimin për detyrimin dhe përgjegjësinë ligjore që ka për të thënë të vërtetën. Ky përjashtim zbatohet edhe për dëshmitarët e tjerë të mitur, kur kryetari i trupit gjykues çmon se ai nuk është në gjendje të kuptojë pasojat e bërjes së betimit. Në këto raste, kryetari i trupit gjykues i ofron të miturit mundësinë që të thotë të vërtetën dhe gjykata procedon me dëgjimin e dëshmisë së të miturit.

4. Kur i mituri është dëgjuar gjatë hetimit dhe deklaratimet e tij janë regjistruar sipas paragrafit 4, të nenit 58/a, të këtij Kodi, ato përdoren si provë në gjykim nëse i pandehuri dhe mbrojtësi japin pëlqimin. Deklarimet e të miturit mund të përdoren si provë edhe nëse mbrojtësi është lejuar të pyesë të miturin nëpërmjet profesionistëve dhe ekspertit shpreh mendim se përsëritja e pyetjes mund të dëmtojë kushtet psikologjike të të miturit.¹⁰³

Në nenin 39, pika 1, të Kodit të Drejtësisë Penale Për të Mitur të Republikës së Shqipërisë janë paraqitur edhe rregulla të veçanta të marrjes në pyetje të miturin viktimë ose dëshmitar, si në vijim:

- Kur dhënia e dëshmisë mund ta vendosë viktimën ose dëshmitarin e mitur në rrezik serioz për jetën apo për shëndetin, gjyqtari në përshtatje me moshën gjatë gjykimit garanton:

¹⁰²Kodi i Drejtësisë Penale Për të Mitur, Tiranë 2017, neni 38.

¹⁰³Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë, Botimi i Qendrës së Botimeve Zyrtare, Tiranë 2017, neni 361/a.

-pyetjen e dëshmitarit/viktimës të mitur duke përdorur pajisje që ndryshojnë pamjen dhe/ose zërin e dëshmitarit/viktimës, marrjen e tij në pyetje pas një ekrani jotransparent ose marrjen në pyetje në distancë;

-pyetjen e dëshmitarit/viktimës të mitur përpara fillimit të seancës gjyqësore me pjesëmarrjen e mbrojtësit të të miturit dhe videoregjistrimit të pyetjes së të miturit;

-ndjekjen e procesit dhe pyetjen e të miturit dëshmitar ose viktimë, kur është e mundur dhe e përshtatshme, nga të njëjtët persona dhe kufizimin sa më shumë të jetë e mundur të herëve të marrjes në pyetje.¹⁰⁴

Përfundimisht, në cilësinë e dëshmitarit mund të paraqiten edhe personat nën moshën 14 vjeçare, pyetja e të cilëve bëhet vetëm me pëlqimin dhe në praninë e përfaqësuesit të tij ligjor, psikologut dhe mbrojtësit të tij. Të miturit nën 14 vjeç i shpjegohet në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme si dhe përmes shembujve, rëndësia për të thënë të vërtetën dhe pasojat që mund të sjellë moshtënia e së vërtetës për personat e tretë. Të miturit i shpjegohet që nuk ka përgjegjësi penale për veprën penale, për refuzimin e dhënies së dëshmisë ose të dhënies së një dëshmie të rreme.¹⁰⁵

Duke analizuar çështjen e marrjes në pyetje të dëshmitarëve të mitur në procedurë penale shohim se marrja në pyetje e këtyre dëshmitarëve dallon nga marrja në pyetje e dëshmitarëve të rritur për shkak të moshës së tyre, shkallës së pjekurisë si dhe faktorëve të tjerë të cilët janë të lidhur me personalitetin dhe moshën e tyre. Kjo çështje pothuajse në mënyrë të njëjtë është përcaktuar edhe sipas legjislacionit penal të RMV-së, ku në rastet kur vjen në shprehje marrja e dëshmisë së dëshmitarit si në legjislacionin penal të Kosovës, poashtu edhe të RMV-së është përcaktuar në mënyrë të përpiktë procedura dhe mënyra e marrjes në pyetje e këtyre dëshmitarëve, gjithherë duke respektuar personalitetin dhe moshën e tij.

Mënyra se si realizohet marrja në pyetje e dëshmitarëve të mitur më saktësisht është përcaktuar në nenin 361/a të KPP-së të Shqipërisë. Gjithashtu, edhe tek dëshmitarët e mitur janë përcaktuar dispozita ligjore me të cilat i ofrohet mbrojtje dëshmitarit të mitur të cilit i kanoset rreziku serioz për jetën dhe shëndetin e tij. Pra, në nenin 39, pika 1, të Kodi të Drejtësisë Penale Për të Mitur të Republikës së Shqipërisë janë përcaktuar mënyrat se si dëshmitarit të rrezikuar i ofrohet ndihma në rastet kur i kanoset rreziku.

2.1.4. Përgjegjësia për dëshmi të rreme ose refuzimi për të dëshmuar

Përderisa flasim për një procedurë të vështirë dhe komplekse, atëherë duhet të dimë se jo çdoherë zbardhja e çështjes konkrete penale do të jetë e lehtë për gjykatën. Gjatë procedurës penale hasen vështirësi të shumta të cilat ndikojnë në ngadalësimin e procedurës dhe vështirësimin e punës së trupit gjykues. Si faktor që ndikon negativisht në rrjedhën e procedurës penale paraqitet edhe dhënia e dëshmisë së rreme ose refuzimi i dëshmitarit për të dëshmuar në procedurë penale.

¹⁰⁴Kodi i Drejtësisë Penale Për të Mitur, Tiranë 2017, neni 39 pika 1.

¹⁰⁵Po aty, neni 42.

Përgjegjësia për dëshmi të rreme ose refuzimi për të dëshmuar është rregulluar **sipas nenit 165 paragrafit 1 dhe paragrafit 2**, edhe atë:

1. Kur gjatë pyetjes dëshmitari bën thënie kontradiktore, jo të plota ose që janë në kundërshtim me provat e marra, gjykata ia vë në dukje duke e paralajmëruar për përgjegjësinë penale për dëshmi të rreme.

2. Të njëjtin paralajmërim gjykata i bën edhe dëshmitarit që refuzon të dëshmojë. Kur dëshmitari ngul këmbë në mospranimin për të dëshmuar, gjykata i kërkon prokurorit që të procedojë sipas ligjit.¹⁰⁶

Përgjegjësia për dëshmi të rreme ose refuzimi për të dëshmuar janë çështje të cilat janë të përcaktuara pothuajse në të gjitha legjislacionet penale të të gjitha shteteve. Dëshmia e rreme e dëshmitarit paraqet një nga fenomenet më të dëmshme në shoqërinë bashkëkohore e cila pothuajse në të gjitha legjislacionet penale është e sanksionuar nëpërmjet dispozitave ligjore. Duke u bazuar në këtë hulumtim shkencor, dëshmia e rreme është e sanksionuar edhe sipas KPP-së të Shqipërisë. E njëjta gjë ndodh edhe me refuzimin për të dëshmuar që gjithashtu është sanksionuar sipas dispozitave ligjore, sepse dëshmitari i thirrur në procedurë penale është i detyruar që të dëshmojë në lidhje me çështjen penale konkrete.

2.2. Marrja e dëshmisë së nënpunësve diplomatikë

Duke pasur parasysh rëndësinë e dëshmisë së dëshmitarit në procedurë penale, mund të konkludojmë se secili person i thirrur për të dëshmuar është i obliguar që të paraqitet për të dëshmuar. Ndodh që për disa persona procedura të jetë më e ndërlikuar e sidomos për personat që kanë funksione të rëndësishme shtetërore brenda vendit, por edhe të atyre të cilët janë të ngarkuar me mision diplomatik.

Marrja e dëshmisë së nënpunësve diplomatikë, në mënyrë të hollësishme është rregulluar sipas nenit 163 të KPP-së, si në vijim:

1. Kur duhet të pyetet një nëpunës diplomatik ose një i ngarkuar me mision diplomatik jashtë shtetit, për kohën që ndodhen jashtë territorit të shtetit shqiptar, kërkesa për marrjen në pyetje i transmetohet nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë, organit diplomatik ose konsullor shqiptar, përveç rasteve kur çmohet e domosdoshme paraqitja e tyre.

2. Për marrjen e deponimeve nga nëpunësit diplomatikë të një shteti të huaj të akredituar pranë shtetit shqiptar, respektohen konventat dhe zakonet ndërkombëtare.

Duke u bazuar në nenin e lartpërmendur kuptojmë se kur vjen në shprehje marrja e dëshmisë së personave të cilët janë të angazhuar me misione diplomatike, vërejmë përjashtime, ngaqë duhet kaluar në disa procedura derisa të arrihet në plotësimin e kushteve.

¹⁰⁶Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë, Botimi i Qendrës së Botimeve Zyrtare, Tiranë 2017, neni 165 paragrafi (1) dhe paragrafi (2).

2.3.Ballafaqimi i dëshmitarëve

Duke pasur parasysh rëndësinë e procedurës penale dhe nevojën për të arritur deri tek e vërteta dhe marrjen e vendimit gjyqësor të drejtë dhe objektiv, jo çdoherë statet e procedurës penale kalojnë me lehtësi, sepse në disa raste hasen edhe vështirësi. Një ndër vështirësitë të cilat mund të hasen gjatë procesit të të provuarit janë edhe deklaratat kontradiktore të dëshmitarëve.

Për këto kundërthënie, zakonisht vihen në dijeni organet proceduese të cilat konstatojnë thënie të kundërta për fakte dhe rrethana të caktuara. Për këtë arsye, në procedurë penale lind nevoja e ballafaqimit në mes këtyre personave. Ballafaqimi lejohet në mes personave të cilët janë pyetur më parë ndaras nga njëri tjetri.¹⁰⁷

Gjatë procesit të ballafaqimit, personave u kujtohen thëniet e bëra më parë për të cilat është konstatuar mospërputhja dhe më pas pyeten nëse janë dakord me to, o kërkojnë t'i konfirmojnë përsëri, apo duan t'i ndryshojnë. Gjatë kryerjes së ballafaqimit, me qëllim që të kundërshtohen tërësisht ose pjesërisht thëniet e të pandehurit, dëshmitari ose i dëmtuari, palët mund të kërkojnë të lexohen përsëri thëniet e deklaruara më parë para Policisë Gjyqësore apo prokurorit. Të gjitha këto kundërshtime apo miratime të bëra nga palët shënohen në procesverbalin e mbajtur dhe përfshihen në fashikullin gjyqësor.¹⁰⁸

Shqyrtimi i dëshmisë së dëshmitarit si provë në procedurë penale të Kosovës

1.Dëshmia e dëshmitarit si provë në Procedurë Penale të Kosovës

Dëshmia është provë e rëndësishme e cila ndeshet pothuajse në të gjitha çështjet penale për të cilat zhvillohet procedurë penale. Dëshmia është deklarim i personit fizik lidhur me perceptimet shqisore të tij për faktet e rëndësishme nga e kaluara, të dhëna në formë procedurale para organit kompetent. Pra, gjatë dëshmisë dëshmitari nuk duhet t'i paraqesë konkludimet e veta e as të shprehë mendimin e vet, por vetëm duhet të dëshmojë atë që me shqisat e veta e ka vërejtur. Sipas Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, si dëshmitar thirret personi për të cilin besohet se mund të japë njoftime për veprën penale, për kryerësin dhe për rrethanat e rëndësishme për procedurën paraprake.¹⁰⁹

Për të ardhur deri tek e vërteta dhe deri tek realiteti në procedurë penale, ndër provat më të rëndësishme numërohet edhe dëshmia e dëshmitarit e cila në disa çështje penale mund të llogaritet edhe si mbret i provave duke mos pasur prova të tjera të mjaftueshme në të cilat mund të mbështete vendimi gjyqësor. Kështu që, Kodi i Porcedurës Penale i parasheh disa ndarje të disa llojeve të dëshmitarëve në Procedurë Penale, edhe atë: dëshmitarët e privilegjuar, dëshmitarët okularë, dëshmitarët sipas dëgjimit dhe dëshmitarët bashkëpunues.

¹⁰⁷ H.Islami,A.Hoxha,I.Panda., Procedura Penale ,Tiranë 2010, fq. 220

¹⁰⁸ Po aty, fq. 221

¹⁰⁹ Azem Hajdari, Procedura Penale Komentar, Prishtinë 2010 , fq. 416.

1.1. Dëshmitarët e privilegjuar

Duke marrë parasysh parimin se dëshmimi është obligim për çdo qytetar i cili thirret në procedurë penale për të dëshmuar, ekzistojnë edhe disa përjashtime ku në disa raste një kategori e caktuar e disa personave nuk mund të dëshmojnë në procedurën penale konkrete, kurse kategoria tjetër e personave të cilët janë të liruar nga detyra e dhënies së dëshmisë.

Sipas nenit 126 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, si dëshmitar nuk mund të merret në pyetje:

1. personi i cili me deklarin e vet do të shkelte detyrën e ruajtjes së fshehtësisë zyrtare ose ushtarake, derisa organi kompetent nuk e liron nga ky detyrim;
2. mbrojtësi, për atë që i pandehuri ia ka besuar atij në cilësi të mbrojtësit të vet, përveç kur kërkon vetë i pandehuri;
3. i bashkëpandehuri, derisa zbatohet procedurë e përbashkët.¹¹⁰

Në bazë të përcaktimit të lartpërmendur, përmenden personat të cilët nuk mund të paraqiten në cilësinë e dëshmitarit në procedurën penale konkrete për shkak të pengesave ligjore të cilat ekzistojnë. Këto pengesa adresojnë në ruajtjen e interesave publike por edhe interesave individuale të personave të pandehur.¹¹¹

Në bazë të nenit të lartpërmendur mund të konstatojmë se dëshmitari nuk mund të dëshmojë për çështje të cilat janë në interes të shtetit dhe interesit zyrtar dhe gjithashtu se në çështjen penale konkrete nuk mund të dëshmojë edhe mbrojtësi i të pandehurit për atë çka ai e ka mësuar nga i pandehuri mbi rastin konkret, sepse pikësëpari ai mbron punën dhe profesionin të cilin ai e kryen në vazhdimsi, mirëpo edhe në këto raste paraqiten përjashtime në rastet kur këtë e kërkon vetë i pandehuri. Në cilësinë e dëshmitarit nuk mund të merret edhe i bashkëpandehuri, përderisa zbatohet procedurë e përbashkët, sepse bien në kundërshtim me dispozitat ligjore të KPP-së të Kosovës.

Në këto raste, legjislacioni në mënyrë të përpiktë dhe shumë rigoroze përcakton se personat e përcaktuar sipas nenit 126 të KPP-së të Kosovës nuk mund të paraqiten në cilësinë e dëshmitarit në çështjen penale konkrete, ngaqë dhënia e dëshmisë nga dëshmitarët e përcaktuar në nenin e lartpërmendur bien ndesh me dispozitat ligjore të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

Sipas nenit 127 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, nga detyra e dëshmimit janë të liruar:

1. bashkëshorti ose bashkëshorti jashtëmartesor i të pandehurit, përveç kur procedura zbatohet për vepër penale për të cilën mund të shqiptohet dënimi me të paktën pesë (5) vjet burgim dhe ai është i dëmtuar me atë vepër penale;
2. personi i gjinisë së gjakut në vijë të drejtë me të pandehurin, bashkëshorti ose bashkëshorti jashtëmartesor: paraardhësit, pasardhësit, motrat, vëllezërit, xhaxhallarët, dajallarët, tezet, hallat, fëmijët e motrave dhe vëllezërve ose të afërmit: vjehrra, vjehrrri, dhëndri, nusja, motra e burrit/gruas, vëllai i burrit/gruas, kumbari, kumbarja, njerka, njerku; përveç kur procedura zbatohet për vepër penale për të cilën mund të shqiptohet dënimi me të

¹¹⁰Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës /Nr. 37, Prishtinë 2013, neni 126.

¹¹¹Azem Hajdari, Procedura Penale Komentar, Prishtinë 2010, fq. 417

paktën dhjetë (10) vjet burgim, apo nëse është dëshmitar i veprës penale kundër fëmijës i cili bashkëjeton apo është i afërm me të apo me të pandehurin;

3. prindi adoptues ose fëmija i adoptuar i të pandehurit, përveç kur procedura zbatohet për vepër penale për të cilën mund të shqiptohet dënimi me të paktën dhjetë (10) vjet burgim, ose ai është dëshmitar i veprës penale kundër fëmijës që bashkëjeton ose është i afërt me të apo me të pandehurin;

4. personi fetar për atë çka i pandehuri apo një person tjetër i është rrëfyer;

5. mbrojtësi, mbrojtësi i viktimave, mjeku, punëtori social, psikologu ose ndonjë person tjetër, për faktet që i kanë mësuar gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre, kur detyrohen ta ruajnë si fshehtësi atë që e kanë mësuar me rastin e ushtrimit të profesionit;

6. gazetari apo botuesi, i cili punon në media apo një ose më shumë nga bashkëpunëtorët e tij në pajtim me ligjin e zbatueshëm.¹¹²

Duke analizuar nenin 127 të KPP-së të Kosovës vërejmë se detyra e dëshmitarit në këto raste adreson në atë se disa persona janë të liruar nga procedura e dëshmitarit ose dhënies së dëshmisë, për shkak të raporteve të afërta të cilat ekzistojnë ndërmjet dëshmitarit dhe të pandehurit si dhe të afërmeve të tij, ose raporte të cilat kanë ekzistuar në të kaluarën, mirëpo për shkaqe të ndryshme ato raporte janë shkëputur ose përkeqësuar. Në këto raste dhënia e dëshmisë në dëm të të pandehurit mund të adresojë edhe në krijimin e probleme të vazhdueshme. Për këtë arsye edhe ndaj këtyre personave të cilët thirren në cilësinë e dëshmitarit nuk përcaktohen dispozita ligjore të detyrueshme, por shkohet në atë drejtim që të arsyetohet rasti se a janë të përshtatshme rrethanat për t'u paraqitur në cilësinë e dëshmitarit ose jo.

Sipas nenit 128 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, dëshmia e dëshmitarit është e papranueshme nëse:

1. personi nuk mund të pyetet si dëshmitar;

2. personi është i liruar nga dëshmimi, por nuk është vënë në dijeni për këtë ose shprehimisht nuk ka hequr dorë nga kjo e drejtë, apo kur udhëzimi dhe heqja dorë nuk është shënuar në procesverbal;

3. personi është fëmijë i cili nuk kupton të drejtën e tij për të refuzuar dëshmimin; ose

4. dëshmia e dëshmitarit është marrë me forcë, me kanosje ose me ndonjë mënyrë tjetër të ndaluar.¹¹³

Dëshmia e dëshmitarit jo çdoherë është e pranueshme, sepse në disa raste paraqiten disa rrethana të cilat dëshminë e dëshmitarit në procedurë penale e bëjnë si të papranueshme, me çrast ajo vlerësohet si provë e papranueshme. Pra, në të gjitha rastet e përmendura në nenin 128 të KPP-së të Kosovës, dëshmia e dëshmitarit do të llogaritet si e papranueshme dhe nuk do të ketë fuqi provuese.

¹¹²Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës /Nr. 37, Prishtinë 2013, neni 127.

¹¹³Po aty, neni 128.

1.2. Dëshmitarët okularë

Për të pasur cilësinë e dëshmitarit okular duhet që gjatë veprimit kriminal personi i caktuar të ketë qenë prezent në momentin kur ka ndodhur ai veprim, me ç'rast ka vërejtur të gjithë ndodhinë, pra e ka perceptuar ngjarjen në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Në lidhje me dëshmitarët okularë, në Kodin e Procedurës Penale të Kosovës nuk ka ndonjë dispozitë të veçantë e cila e rregullon këtë çështje. Dëshmitarët okularë i krijojnë vetë rasti, sepse në momentin në të cilin ndodh vepra penale ato ndodhen aty dhe me shqisën e të pamurit ato e perceptojnë të gjithë ngjarjen. Në procedurë penale, dëshmitarit okular i kushtohet rëndësi e veçantë, ngaqë është burimi direkt i cili mund të japë deklaramë se si ka ndodhur veprimi kriminal. Pra dëshmia e dëshmitarit okular konsiderohet si burim i drejtpërdrejtë.¹¹⁴

Me rastin e paraqitjes së dëshmitarit në gjykatë mbi rastin konkret për të cilin edhe ai është thirrur, dëshmitari është i obliguar që gjatë dhënies së dëshmisë të dëshmojë të gjithë atë që ai e ka perceptuar në momentin kur ka ndodhur vepra penale për të cilën është ftuar edhe të dëshmojë. Pra, dëshmitari okular është i obliguar që në procedurë penale të dëshmojë vetëm të vërtetën për çështjen për të cilën është thirrur për të dëshmuar duke e përshkruar rastin në mënyrë objektive dhe të vërtetë se si ka ndodhur në realitet.

1.3. Dëshmitarët sipas dëgjimit

Dëshmitar sipas dëgjimit konsiderohet personi i cili gjatë procesit të dëshmimit jep informacione deri te të cilat ka ardhur, jo me perceptim të drejtpërdrejtë por me perceptim indirekt. Pra, dëshmitari sipas dëgjimit nuk e ka perceptuar vetë rrjedhën e veprës penale, por ai flet për tregimin e personave të tretë.¹¹⁵

Në bazë të kësaj, në procedurë penale përparësi çdoherë i jepet dëshmitarit okular, për arsye se ai ka pasur qasje direkte në çështjen penale konkrete, kurse dëshmitari sipas dëgjimit thirret në rastet kur dëshmitari okular për shumë arsye (kur ai ka vdekur, është sëmurë shpirtërisht etj.) nuk është i kapshëm dhe nuk krijohet mundësia që ai të paraqitet në cilësinë e dëshmitarit në procedurë penale.

Gjatë marrjes së dëshmisë nga dëshmitari sipas dëgjimit, gjykata duhet pasur një përkushtim shumë të madh, për arsye se dëshmitari sipas dëgjimit në disa raste edhe mund të mos e dëshmojë verzionin origjinal nga ajo që ia ka treguar dëshmitari i drejtpërdrejtë, por të bëjë ekzagjerimin e dëshmisë dhe të deklarojë diçka që nuk përputhet me të vërtetën e cila do të ishte në dëm të procedurës penale konkrete.

Nga dëshmitari sipas dëgjimit nuk kërkohet që në dëshminë e tij të paraqesë edhe mendimet dhe idetë e tij, por kërkohet që të dëshmojë atë të cilën e ka dëgjuar nga dëshmitari okular duke qenë sa më objektiv.

Duke u bazuar në aspektin psikologjik, rezultati i gabimeve me rastin e dëshmimit vetëm në bazë të shqisës së dëgjimit, është një herë e gjysmë më i madh se sa te deklarimi i dëshmitarit që mbështetet në shqisën e shikimit. Në anën tjetër, disa autor me të drejtë

¹¹⁴Azem Hajdari, Procedura Penale Komentar, Prishtinë 2010, fq. 421.

¹¹⁵Po aty, fq. 422

nënvizojnë faktin se njerëzit dëgjojnë sipas kuptimit, madje sipas atij kuptimi që vetë ua japin fjalëve të dhëna. Kjo gjithsesi e vështirëson riprodhimin e drejtpërdrejtë dhe konsekuent të asaj që e ka thënë dëshmitari origjinal.¹¹⁶

Gjatë praktikës në Gjykatën Themelore në Strugë kisha mundësinë që për një çështje penale të dëgjoj dëshminë e dëshmitarit sipas dëgjimit. Në atë procedurë penale i pandehuri akuzohej për vjedhje të rëndë në një shtëpi në një fshat të Strugës. Dëshmitari sipas dëgjimit gjatë dhënies së dëshmisë në mënyrë të qartë e përshkruajti të gjithë ndodhinë ashtu siç ia kishte treguar dëshmitari okular, i cili për arsye shëndetësore ndodhej jashtë shtetit për operim dhe për këtë arsye paraqitja e tij në procedurë penale ishte e vështirë, sepse bëhej fjalë edhe për një person paksa të thyer edhe në moshë. Dëshmitari sipas dëgjimit, pothuajse në të gjithë dëshminë e tij referohej në thënien të cilën e përsëriste pothuajse në çdo fjali, pra **“ai më ka thënë”**, me të cilën i referohej dëshmitarit okular. Dëshminë të cilën e dha dëshmitari sipas dëgjimit ishte dëshmi e vërtetë, sepse ajo përputhej me provat dhe faktet tjera të cilat i posedonte gjykata.

1.4. Dëshmitarët bashkëpunues

Duke pasur parasysh se kriminaliteti në vend po zhvillohet me hapa të përshpejtuara e sidomos krimet e rënda, krimet e organizuara si dhe korrupsioni, shteti ekskluzivisht po ndërmer m masa në parandalimin e këtyre fenomeneve të cilat e dëmtojnë rëndë shoqërinë. Rreth kësaj çështjeje janë paraparë edhe dispozita penale materiale dhe procedurale për dëshmitarët bashkëpunues.

Sipas nenit 235 të KPP-së, shprehja “dëshmitar bashkëpunues” do të thotë i dyshuari ose i pandehuri për të cilin ende nuk është lexuar aktakuza në shqyrtimin gjyqësor dhe i cili pritet të dëshmojë në gjykatë kur:

- ka gjasa të parandalojë vepra të tjera penale nga personi tjetër;
- ka gjasa të shpie drejt zbardhjes të së vërtetës në procedurën penale;
- është bërë vullnetarisht dhe me marrëveshje të plotë për të dëshmuar të vërtetën në gjykatë;
- është vlerësuar nga gjykata si e vërtetë dhe e plotë; ose
- mund të shpie drejt ndjekjes së suksesshme të kryerësve të tjerë të veprës penale.¹¹⁷

Duke u bazuar në definicionin e mësipërm që ka të bëjë me dëshmitarin bashkëpunues, kuptojmë se cilësinë e dëshmitarit bashkëpunues mund ta kenë vetëm personi i dyshimtë ose i pandehuri dhe askush tjetër. Shpallja e personit dëshmitar bashkëpunues ka ndikim të madh në procedurë penale dhe sidomos në zbardhjen e çështjes penale konkrete, për shkak se paraqiten si persona të cilët e dinë të vërtetën mbi atë çështje dhe mund të japin gjithçka në vërtetimin e gjendjes. Gjithashtu ato mund të japin informacione të sakta edhe për parandalimin e kryerjes së veprave penale të tjera nga kryerësit e tjerë. Për këtë arsye KPP i Kosovës i jep rëndësi çështjes së dëshmitarëve bashkëpunues.

¹¹⁶ Azem Hajdari, Procedura Penale Komentar, Prishtinë 2010, fq. 422.

¹¹⁷ Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës /Nr. 37, Prishtinë 2013, neni 235.

1.4.1. Kërkesa për shpalljen e personit dëshmitar bashkëpunues

Për të arritur që personi të fitojë pjesëmarrjen në procedurë penale në cilësinë e dëshmitarit bashkëpunues, duhet që së pari organi i cili është autorizuar për këtë çështje të dërgojë kërkesë në gjykatë. E gjithë kjo procedurë është e rregulluar sipas KPP-së.

Sipas nenit 236 të KPP-së, kërkesa për shpalljen e personit dëshmitar bashkëpunues është rregulluar si në vijim:

1. Prokurori i shtetit mund të bëjë kërkesë me shkrim pranë gjykatës për të urdhëruar që personi të shpallet dëshmitar bashkëpunues. Kërkesa përfshin deklaratën e veçantë të pretendimeve faktike nga prokurori i shtetit.
2. Prokurori i shtetit mund të bëjë kërkesë të arsyetuar për urdhër që pretendimet faktike në deklaram të mbahen të fshehta nga palët tjera dhe mbrojtësit e tyre.
3. Gjykata në çdo kohë pas pranimi të kërkesës së prokurorit të shtetit për fshehtësi, mund të urdhërojë fshehtësinë lidhur me pretendimet faktike të përfshira në deklaratë.
4. Çdo shkelje e urdhrit për fshehtësi e bazuar në paragrafin 2 të këtij neni ndiqet nga prokurori i shtetit sipas nenit 202 të Kodit Penal dhe neni 202, paragrafi 2 i Kodit Penal nuk zbatohet.¹¹⁸

Duke u bazuar në paragrafin 1 të nenit 236 të KPP-së, me kërkesën e tillë adresohet dhënia e urdhrit gjyqësor përmes të cilit personi i caktuar do të shpallet dëshmitar bashkëpunues. Në kërkesë duhet të theksohen pretendimet faktike mbi bazën e të cilave Prokurori Publik kërkon shpalljen e një personi dëshmitar bashkëpunues.

Me paragrafin e 2 të nenit 236 të KPP-së, Prokurori Publik mund të marrë iniciativën që përmes urdhrit gjyqësor të konstatohet detyra e mbajtjes së fshehtë të pretendimeve faktike të parashtruara. Kjo fshehtësi ka të bëjë me ruajtjen e përmbajtjes së tyre nga palët por edhe nga mbrojtësi.

Në paragrafin 3 të nenit 236 të KPP-së, bëhet fjalë për shtrirje të fshehtësisë sa i përket pretendimeve faktike të përfshira në deklaram, jo vetëm në relacion me palët, por edhe me personat e tjerë.

Konform paragrafit 4 të nenit 236 të KPP-së, ndjekjes penale i nënshtrohet avokati, mbrojtësi, mjeku dhe çdo person tjetër i cili pa autorizim zbulon informacionin e besueshëm, për të cilin është vënë në dijeni gjatë ushtrimit të profesionit të vet.¹¹⁹

1.4.2. Procedura për shpalljen e personit dëshmitar bashkëpunues

Procedura për shpalljen e personit dëshmitar bashkëpunues është e rregulluar sipas KPP-së.

Sipas nenit 237 të KPP-së, procedura është e përcaktuar si në vijim:

1. Pas marrjes së kërkesës, gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues dëgjon kërkesën në seancë të mbyllur. Prokurori i Shtetit dhe mbrojtësi i dëshmitarit bashkëpunues mund të jenë të pranishëm në seancën dëgjimore për të vlerësuar besueshmërinë e dëshmitarit bashkëpunues dhe për të siguruar plotësimin e

¹¹⁸Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës /Nr. 37, Prishtinë 2013, neni 236.

¹¹⁹Azem Hajdari, Procedura Penale Komentar, Prishtinë 2010, fq. 425.

kushteve nga neni 235 i këtij Kodi. Deklarimet e bëra te gjyqtari gjatë marrjes në pyetje nuk mund të përdoren në procedurë penale kundër dëshmitarit bashkëpunues ose kundër ndonjë personi tjetër, si prova që mbështesin zbulimin e fajësisë.

2. Dispozitat e zbatueshme për marrjen në pyetje të dëshmitarëve zbatohen përshtatshmërisht gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarit bashkëpunues dhe marrja në pyetje shënohet në procesverbal në pajtim me dispozitat e këtij Kodi.

3. Në mbyllje të seancës dëgjimore, gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues mund të urdhërojë shpalljen e personit dëshmitar bashkëpunues, kur ai çmon se janë plotësuar kriteret për dëshmitar bashkëpunues nga neni 235 i këtij Kodi.

4. Urdhri përcakton:

4.1. veprat penale, me përshkrimin e veprimeve dhe të kualifikimit të tyre për të cilat urdhërohet ndalimi i fillimit ose i vazhdimit të procedurës penale apo shqiptimi i dënimit;

4.2. ndalimin e fillimit ose të vazhdimit të procedurës penale kundër dëshmitarit bashkëpunues dhe shqiptimit të dënimit ndaj dëshmitarit bashkëpunues për veprë penale të përcaktuar në urdhër;

4.3. natyrën dhe përmbajtjen e bashkëpunimit të dhënë nga dëshmitari bashkëpunues; dhe

4.4. kushtet për revokimin e urdhrit.

5. Gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues nuk lëshojnë urdhër të tillë, kur dëshmitari bashkëpunues dyshohet nga prokurori i shtetit ose akuzohet me aktakuzë si organizator apo udhëheqës i grupit prej dy (2) apo më shumë personave të cilët kanë kryer veprë penale.

6. Urdhri nuk e ndalon fillimin apo vazhdimin e procedurës penale kundër dëshmitarit bashkëpunues për vepra penale të kryera pas lëshimit të urdhrit ose për vepra penale që dënohen me të paktën dhjetë (10) vjet burgim.¹²⁰

1.4.3. Revokimi i shpalljes si dëshmitar bashkëpunues

Sipas nenit 238 të KPP-së, është përcaktuar mënyra e revokimit të shpalljes si dëshmitar bashkëpunues:

1. Me kërkesë të Prokurorit të Shtetit, urdhri i paraparë në nenin 237 të këtij Kodi mund të revokohet nga kolegji shqyrtues kur dëshmia e dëshmitarit bashkëpunues vërtetohet si e rreme në ndonjë pjesë të rëndësishme të saj, ose kur dëshmitari bashkëpunues nuk tregon të vërtetën e plotë.

2. Dëshmitari bashkëpunues paralajmërohet për pasojat e dhënies së dëshmisë së rreme në ndonjë pjesë të rëndësishme të saj, ose kur qëllimisht nuk e tregon të vërtetën e plotë para se të merret në pyetje nga gjyqtari i procedurës paraprake sipas nenit 237, paragrafi 1. i këtij Kodi dhe para se të dëshmojë nën mbrojtjen e urdhrit. Çdo dëshmim i tillë duhet të jetë ose në formë të shkruar në gjuhën e dëshmitarit bashkëpunues dhe e nënshkruar nga ai për të

¹²⁰Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës /Nr. 37, Prishtinë 2013, neni 237.

vërtetuar saktësinë e saj, ose e incizuar në audio apo videotrakë e cila për gjykatën është autentike.¹²¹

Sipas paragrafit (1) të nenit 238 të KPP-së, revokimi i urdhrat me të cilin një person është si dëshmitar bashkëpunues është çështje e cila mund të iniciohet nga ana e Prokurorit Publik. Ndërkaq, autoritetin për të vendosur mbi kërkesën e tillë të Prokurorit Publik e ka kolegji prej 3 gjyqtarësh. Sipas paragrafit 2 të nenit 238 të KPP-së, dëshmitari bashkëpunues para se të japë dëshminë, paralajmërohet se në rast se jep dëshmi të rrejshme në ndonjë pjesë të rëndësishme të çështjes, ose qëllimisht nuk e paraqet të vërtetën e plotë të saj do t'i humbë të gjitha privilegjet të cilat i ka fituar me rastin e shpalljes së tij si dëshmitar bashkëpunues.¹²²

2. Marrja e dëshmisë së dëshmitarit në procedurë paraprake

Procedura paraprake paraqet stadin e parë të procedurës penale e cila përbëhet nga faza e hetimit dhe faza e akuzimit. Në procedurë paraprake vlerësohen faktet dhe provat e mbledhura, nëse në bazë të tyre çështja penale mund të nxirret në shqyrtim gjyqësor. Pra, qëllimi i procedurës paraprake është selektimi i materialit ose i provave të cilat kanë fuqi provuese të cilat do të përcaktohen në ngritjen e aktakuzës. Sa i përket organit i cili duhet të udhëheqë me procedurën paraprake, shtete të ndryshme e rregullojnë në forma të ndryshme. Vendet anglosaksone, fazën e hetimit e konsiderojnë si veprimtari jashtëgjyqësor e cila është përcaktuar në kompetencë të policisë, kurse përsa u përket shteteve evropiane, faza e hetimit përcaktohet në kompetencë të Prokurorit të Shtetit.¹²³

E njëjta gjë ndodh edhe me Legjislacionin Penal të Republikës së Kosovës, ku me ndryshimet e fundit dhe me hyrjen në fuqi të Kodit të ri të Procedurës Penale në 1 janar të vitit 2013, faza e hetimit përcaktohet ekskluzivisht si kompetencë e Prokurorit të Shtetit.

Një nga fushat që ka pësuar ndryshime thelbësore në procedurën penale janë hetimet në procedurën paraprake. Gjatë fazës së hetimit, **sipas nenit 123 të KPP-së**, mund të merren prova nga dëshmitarët dhe ekspertët në njërën nga këto tri mënyra:

1. Marrja në pyetje në procedurë paraprake-zbatohet nga Prokurori i Shtetit. Procesverbali i kësaj marrjeje në pyetje vendoset në shkresat e lëndës. Provat e siguruar gjatë marrjes në pyetje në procedurë paraprake mund të përdoren si bazë për të forcuar urdhrat hetues në procedurë paraprake, vendimet për paraburgim dhe aktakuzën. Provat e siguruar gjatë marrjes në pyetje në procedurë paraprake nuk mund të përdoren si provë e drejtpërdrejtë gjatë shqyrtimit kryesor, por mund të përdoret gjatë marrjes së tërthortë në pyetje për rënien në dyshim të dëshmitarëve, nëse dëshmitari ka dëshmuar ndryshe nga dëshmia e dhënë gjatë marrjes në pyetje në procedurë paraprake.

2. Deklarata në procedurë paraprake-zbatohet nga Prokurori i Shtetit në pajtim me nenet 132-133 të këtij Kodi. Deklarata në procedurë paraprake audio incizohet, audio dhe video incizohet ose transkribohet fjalë për fjalë. Provat e siguruar gjatë deklaratës në procedurë paraprake mund të përdoren si bazë për të forcuar urdhrat hetues në procedurë paraprake,

¹²¹Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës /Nr. 37, Prishtinë 2013, neni 238.

¹²²Azem Hajdari, Procedura Penale Komentar, Prishtinë 2010, fq. 429.

¹²³E. Sahiti, R. Murati, E Drejta e Procedurës Penale, Prishtinë 2016, fq. 319.

urdhrrat për paraburgim dhe aktakuzën. Deklarata në procedurë paraprake pranohet gjatë shqyrtimit kryesor për marrjen e tërthortë në pyetje të dëshmitarit të njëjtë dhe mund të përdoret si provë e drejtpërdrejtë gjatë shqyrtimit kryesor nëse dëshmitari nuk është në dispozicion për shkak të vdekjes, sëmundjes, privilegjeve apo mungesës së pranisë së tij në Kosovë, por nuk mund të përdoret si provë e vetme apo vendimtare fajësuese për dënimin e të pandehurit.

3. Mundësia hetuese e veçantë- zbatohet pranë kolegjit prej tre gjyqtarësh që kryesohet nga gjyqtari i procedurës paraprake në pajtim me nenin 149 të këtij Kodi. Provat e siguruara nga mundësia hetuese e veçantë audio incizohen, audio dhe video incizohen ose transkriptohen fjalë për fjalë. Provat e siguruara gjatë mundësisë hetuese të veçantë mund të përdoren si bazë për të forcuar urdhrat hetues në procedurë paraprake, urdhrat për paraburgim dhe aktakuzën. Provat e siguruara nga mundësia hetuese e veçantë janë plotësisht të pranueshme gjatë shqyrtimit kryesor, nëse së paku njëri nga gjyqtarët e kolegjit gjykues që ka dëgjuar dëshmitë është gjyqtar në trupin gjykues në shqyrtim kryesor dhe nëse dëshmitari nuk është në dispozicion për shkak të vdekjes, sëmundjes, privilegjeve apo mungesës së pranisë së tij në Kosovë. Nëse trupi gjykues në shqyrtim kryesor nuk përfshinë së paku një prej gjyqtarëve që ka shërbyer në Kolegjin për Mundësinë e Veçantë të Hetimit, provat trajtohen si prova të marra nga deklarata në procedurë paraprake nga paragrafi 3 i këtij neni.¹²⁴

Sipas nenit paragrafit (1) të nenit 125 të KPP-së, në fillim të marrjes në pyetje në procedurë paraprake, seancës për deklaratë në procedurë paraprake ose mundësisë hetuese të veçantë, Prokurori i Shtetit i lexon dëshmitarit këtë paralajmërimin:

"Ky është një hetim penal. Ju jeni i detyruar të dëshmoni. Ju jeni i detyruar të tregoni të vërtetën. Nëse ju nuk tregoni të vërtetën, mund të ndiqeni sipas nenit 390 ose 391 të Kodit Penal. Nëse besoni se ju mund të fajësoni veten si rezultat i përgjigjeve në pyetje, ju mund të refuzoni të përgjigjeni. Nëse besoni se keni nevojë për ndihmën e avokatit si rezultat i përgjigjes në një pyetje, ju mund të angazhoni dhe të këshilloheni me një avokat. Ky hetim penal kërkon të gjejë të vërtetën dhe kujtesën sa më të saktë të fakteve që ju mund të ofroni. Nëse ju nuk e kuptoni pyetjen që u është bërë, ju duhet të kërkonit që pyetja t'ju bëhet ndryshe. Nëse besoni se ka një dokument ose prova të tjera që mund t'ju ndihmojnë për t'u përgjigjur në pyetje sa më saktë apo t'ju kujtohen faktet më qartë, ju jeni të detyruar të na tregoni. Nëse keni nevojë për ndihmë, përkthim apo pushim të shkurtër dhe të arsyeshëm nga kjo seancë, ju duhet të kërkonit atë. A i kuptoni këto të drejta?"¹²⁵

¹²⁴Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës /Nr. 37, Prishtinë 2013, neni 123.

¹²⁵Po aty, neni 125 paragrafi (1).

2.1.Kushtet e përgjithshme për marrjen në pyetje në procedurë paraprake, marrjen e deklaratës në procedurë paraprake ose mundësinë hetuese të veçantë sipas nenit 130 të KPP-së

Për t'u paraqitur personi në cilësinë e dëshmitarit në procedurë paraprake, së pari duhet të plotësojë disa kushte të përgjithshme të përcaktuara sipas Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës. Kushtet e përgjithshme për marrjen në pyetje në procedurë paraprake, marrjen e deklaratës në procedurë paraprake ose mundësinë hetuese të veçantë janë të përcaktuara në nenin 130 të KPP-së si në vijim:

1. Dëshmitari pyetet ndaras dhe pa praninë e dëshmitarëve të tjerë. Dëshmitari detyrohet t'i japë përgjigjet gojarisht.
2. Pas kësaj dëshmitari pyetet për emrin dhe mbiemrin, emrin e babait dhe të nënës, numrin e letërnjoftimit, profesionin, vendbanimin, vendlindjen, moshën dhe marrëdhënien e tij me të pandehurin dhe me të dëmtuarin. Dëshmitarit i bëhet me dije detyrimi i tij për të lajmëruar gjykatën për çdo ndryshim të vendbanimit ose vendqëndrimit.
3. Dispozita e paragrafit 2 të këtij neni nuk zbatohet kur është në kundërshtim me masat për mbrojtjen e të dëmtuarve dhe dëshmitarëve siç parashihet me këtë Kod.
4. Zyrtarët e policisë janë të detyruar të japin të dhënat nga paragrafi 3 i këtij neni, por informohen për të drejtën e tyre që në vend të adresës së banimit të japin adresën e stacionit të tyre policor.
5. Me rastin e marrjes në pyetje të personit i cili nuk ka mbushur moshën tetëmbëdhjetë (18) vjet, sidomos kur ai është dëmtuar me veprën penale, veprohet me kujdes që pyetja të mos ndikojë dëmshëm në gjendjen e tij mendore. Kur është e nevojshme, ai pyetet me ndihmën e psikologut për fëmijë ose pedagogut për fëmijë apo ekspertit tjetër profesional.¹²⁶

Në nenin e lartpërmendur në mënyrë taksative janë përcaktuar rregullat e përgjithshme si dhe mënyra dhe rrjedhoja e marrjes në pyetje e dëshmitarëve në procedurë paraprake, marrjen e deklaratës në procedurë paraprake ose mundësinë hetuese të veçantë.

2.1.1. Marrja në pyetje në procedurë paraprake sipas nenit 131 të KPP-së

Marrja në pyetje në procedurë paraprake nga ana e Prokurorit të Shtetit është e rregulluar sipas nenit 131 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës si në vijim:

1. Gjatë fazës së hetimit, Prokurori i Shtetit mund të thërret dëshmitarët, viktimat, dëshmitarët bashkëpunues, dëshmitarët e mbrojtur dhe ekspertët që të japin informata në marrjen në pyetje në procedurën paraprake që është relevante për procedurën penale.
2. Prokurori i Shtetit mund të lejojë mbrojtësin, viktimën apo mbrojtësin e viktimave që të marrë pjesë në marrjen në pyetje në procedurë paraprake.
3. Gjatë marrjes në pyetje, Prokurori i Shtetit mund të pyesë personin i cili merret në pyetje lidhur me provat materiale. Provat materiale duhet të identifikohen qartë në procesverbalin, transkriptin ose raportin mbi marrjen në pyetje.
4. Marrja në pyetje në procedurë paraprake mund të incizohet audio, të incizohet audio dhe video, të transkribohet fjalë për fjalë ose të përmbledhet në një raport. Incizimi,

¹²⁶Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës /Nr. 37, Prishtinë 2013, neni 130.

transkripti apo raporti janë në pajtim me Kapitullin XI dhe i bashkëngjiten shkresave të lëndës.

5. Personi i cili merret në pyetje nga ky nen mund të dëshmojë më vonë gjatë marrjes së deklaratës në procedurë paraprake ose në mundësinë hetuese të veçantë.¹²⁷

Sipas nenit 131 të KPP-së të Kosovës, marrja në pyetje në procedurë paraprake realizohet nga ana e Prokurorit të Shtetit i cili ka të drejtë ekskluzive në përcaktimin dhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve në procedurë paraprake. Detyra e tij në këtë fazë, pra në procedurë paraprake, është marrja në pyetje e personave nga të cilët mund të marrë informata mbi çështjen penale konkrete.

2.1.2. Marrja e deklaratës në procedurë paraprake sipas nenit 132 të KPP

Marrja e deklaratës në procedurë paraprake nga ana e Prokurorit të Shtetit është e rregulluar sipas nenit 132 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës si në vijim:

1. Gjatë fazës së hetimit, Prokurori i Shtetit thërret dëshmitarët, viktimat, ekspertët dhe të pandehurin apo të pandehurit për të dhënë deklaratë në procedurë paraprake lidhur me procedurën penale.

2. Gjatë fazës së hetimit, Prokurori i Shtetit merr në pyetje dëshmitarët e mbrojtur dhe dëshmitarët bashkëpunues duke siguruar sigurinë e përshtatshme për ta.

3. Dëshmitari thirret duke ia dërguar thirrjen me shkrim në të cilën shënohet emri, mbiemri dhe profesioni i dëshmitarit, koha dhe vendi ku duhet të paraqitet, lënda penale për të cilën thirret, shënimi se thirret si dëshmitar dhe paralajmërimi për pasojat e mungesës pa arsye.

4. Thirrja si dëshmitar e personit që nuk ka mbushur moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjet bëhet nëpërmjet prindërve të tij apo përfaqësuesit ligjor, përveç kur kjo nuk është e mundur për shkak të nevojës për veprim të ngutshëm ose për shkak të rrethanave të tjera.

5. Dëshmitari i cili për shkak të pleqërisë, sëmundjes ose të metave të rënda trupore nuk mund t'i përgjigjet thirrjes, mund të pyetet jashtë gjykatës.

6. Prokurori i Shtetit e njofton me shkrim pesë (5) ditë më herët të pandehurin, mbrojtësin, të dëmtuarin dhe mbrojtësin e viktimave lidhur me datën, kohën dhe vendin ku do të merret deklarata në procedurë paraprake. Kopje e njoftimit i bashkëngjitet shkresave të lëndës.

7. Mospjesëmarrja e pajustificuar e të pandehurit, mbrojtësit, të dëmtuarit apo mbrojtësit të viktimave në seancën për marrjen e deklaratës në procedurë paraprake, pasi të ketë pranuar njoftimin nga paragrafi 6, ia mohon atij të pandehuri, mbrojtësi, të dëmtuari apo mbrojtësi të viktimës që të kundërshtojë pranueshmërinë e dëshmisë në një fazë të mëvonshme të procedurës penale. Këto pasoja ceken në njoftimin nga paragrafi 6 i këtij neni.¹²⁸

Marrja e deklaratës në procedurë paraprake paraqet një nga parakushtet që ndikojnë në fazat e më tutjeshme të procedurës penale duke pasur parasysh faktin se deklarata e dëshmitarit në procedurë paraprake dhe më pas në seancën kryesore mund të paraqitet si

¹²⁷Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës /Nr. 37, Prishtinë 2013, neni 131.

¹²⁸Po aty, neni 132.

provë e rëndësishme në të cilën mund të mbështetet edhe vendimi gjyqësor. Marrja e deklaratës në procedurë paraprake realizohet nga ana e Prokurorit të Shtetit, me çrast ai i thirr që të paraqiten në cilësinë e dëshmitarit gjatë procedurës paraprake, personat nga të cilat do të sigurojë informata si dhe prova për të pasur sukses edhe në fazat e ardhshme të procedurës penale. E gjithë kjo procedurë e marrjes së deklaratës nga ana e dëshmitarit është përcaktuar sipas nenit 132 të KPP-së të Kosovës.

3. Thirrja e dëshmitarit për të dëshmuar në procedurë penale kryesore

Sipas nenit 124 të KPP-së, si dëshmitar thirret personi për të cilin besohet se mund të japë informata për veprën penale, për kryerësin dhe për rrethanat e rëndësishme për procedurën penale. Çdo person i thirrur si dëshmitar detyrohet t'i përgjigjet thirrjes e kur me këtë Kod nuk është caktuar ndryshe, detyrohet edhe të dëshmojë.¹²⁹

Në seancën kryesore, dëshmitari thirret nga ana e gjykatës, e cila shkresë përfshin emrin dhe mbiemrin e personit, profesionin e tij, kohën dhe vendin e paraqitjes, çështjen penale për të cilën ai është thirrur, si dhe tregimin se ai thirret si dëshmitar.

Obligimi i dëshmitarit të thirrur në mënyrë të rregullt për të dëshmuar është e patjetërsueshme, sepse në rast se dëshmitari nuk paraqitet në ditën dhe orën në të cilën është thirrur, do të sillet në mënyrë të dhunshme.

Mosparaqitja e dëshmitarit është rregulluar sipas nenit 135 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës edhe atë si në vijim:

1. Kur dëshmitari i cili është thirrur me rregull nuk paraqitet, e mosparaqitjen nuk e arsyeton, ose pa leje dhe shkak të arsyeshëm largohet nga vendi ku duhet të pyetet, atëherë mund të detyrohet të paraqitet dhe mund të dënohet me gjobë deri dyqind e pesëdhjetë (250) euro sa herë që nuk paraqitet.
2. Nëse dëshmitari paraqitet kur është thirrur, por pasi të jetë bërë me dije për pasojat refuzon të dëshmojë pa arsyetim ligjor, mund të dënohet me gjobë deri në dyqind e pesëdhjetë (250) euro. Kur edhe pas kësaj refuzon të dëshmojë, atëherë mund të burgoset. Burgimi zgjat derisa dëshmitari nuk pranon të dëshmojë apo derisa dëshmimi i tij bëhet i panevojshëm, ose derisa procedura të përfundojë por jo më shumë se një (1) muaj.
3. Për ankesë kundër aktvendimit me të cilin shqiptohet dënimi me gjobë ose me burgim vendos kolegji shqyrtues. Ankesa nuk e pezullon ekzekutimin e aktvendimit. Dënimi nga paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni shqiptohet nga gjyqtari.
4. Pjesëtarët e forcave ushtarake dhe pjesëtarët e policisë nuk mund të burgosen, por për refuzimin e dëshmimit të tyre njoftohet komanda e tyre përkatëse.

3.1. Procedura e marrjes në pyetje të dëshmitarit

Marrja në pyetje e dëshmitarit ose marrja e dëshmisë nga ana e dëshmitarit paraqet një proces shumë të ndërlikuar, proces i cili duhet të udhëhiqet në mënyrë të përpiktë duke u

¹²⁹Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës /Nr. 37, Prishtinë 2013, neni 124.

bazuar në dispozitat ligjore të KPP-së në lidhje me procedurën e marrjes së dëshmisë së dëshmitarit.

Me rastin e pranimit të thirrjes për t'u paraqitur në gjykatë në cilësinë e dëshmitarit, dëshmitari është i obliguar që të paraqitet në vendin dhe orën e caktuar në shkresë. Në rastin kur përmbushen të gjitha kushtet për fillimin e shqyrtimit gjyqësor, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues e hap seancën dhe në të shpall lëndën e gjykitimit dhe përbërjen e trupit gjykues. Rrjedhimisht si parakusht ose supozim për mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor paraqitet prania e subjekteve themelorë të procedurës penale dhe parimisht e mbrojtësit, sepse në të kundërt mund të vijë deri tek shtyrja e shqyrtimit gjyqësor. Përsa i përket dëshmitarit, nëse ai mungon pa arsye, gjykata mund të urdhërojë që të sillet menjëherë me forcë, ose që shqyrtimi gjyqësor të fillojë edhe pa praninë e dëshmitarit ose dëshmitarëve.¹³⁰

Rendi i paraqitjes së provave në shqyrtim gjyqësor është përcaktuar sipas nenit 327 të KPP-së sipas radhës së mëposhtme:

1. fjala hyrëse;
2. provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit;
3. provat e paraqitura nga i dëmtuari, nëse ka të dëmtuar;
4. provat e paraqitura nga mbrojtësi; dhe
5. fjala përfundimtare.¹³¹

Sipas nenit 331 paragrafi (1) të KPP-së, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues cakton radhën e marrjes në pyetje të dëshmitarëve, duke filluar me dëshmitarët e propozuar nga Prokurori i Shtetit, dëshmitarët e propozuar nga i dëmtuari apo mbrojtësi i viktimave dhe në fund me dëshmitarët e propozuar nga i pandehuri apo mbrojtësi i tij. Po qe se është e mundshme, dëshmitarët thirren duke respektuar radhën e propozuar nga Prokurori i Shtetit, i dëmtuari, mbrojtësi i viktimave, i pandehuri dhe mbrojtësi.¹³²

Sipas rregullit, dëshmia e të dëmtuarit si dëshmitar merret para dëshmive të dëshmitarëve të tjerë. Roli i gjykatës në procedurën penale të Republikës së Kosovës edhe më tutje ka rol aktiv, ku përveç provave të propozuara nga palët edhe ajo mund të shqyrtojë provën që ajo e konsideron të nevojshme për verifikimin e drejtë dhe të plotë të çështjes penale.

Gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues fillimisht e bën verifikimin e të dhënave personale të dëshmitarit duke e pyetur për emrin dhe mbiemrin, emrin e babait dhe të nënës, numrin e letërnjoftimit, profesionin, vendqëndrimin, vendlindjen, moshën dhe marrëdhënien e tij me të pandehurin dhe me të dëmtuarin. Pas kësaj, gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues duhet të shikojë nëse bëhet fjalë për dëshmitarë të privilegjuar, të cilët sipas ligjit **duhet (neni 126)** të përjashtohen ose të cilët **mund (neni 127)** të përjashtohen nga dëshmimi. Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues i tërheq vërejtjen dëshmitarit se duhet të flasë të vërtetën dhe se nuk guxon të heshtë asgjë. Para marrjes në pyetje të dëshmitarit, gjyqtari i vetëm gjykues, kryetari i trupit gjykues ose gjyqtari i procedurës paraprake nga dëshmitari mund të kërkojë dhënien e betimit. Fëmija dhe

¹³⁰E.Sahiti, R.Murati., E Drejta e Procedurës Penale, Prishtinë 2016, fq. 371.

¹³¹Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës /Nr. 37, Prishtinë 2013, neni 327.

¹³²Po aty, neni 331 paragrafi (1).

personi për të cilin është vërtetuar të ketë kryer vepër penale, ose me arsye dyshohet se ka kryer vepër penale, apo ka marrë pjesë në kryerjen e veprës penale për të cilën merret në pyetje, nuk i nënshtrohet betimit.¹³³

Teksti i betimit të dëshmitarit është: **“I ndërgjegjshëm për rëndësinë e dëshmisë sime dhe përgjegjësinë time ligjore, solemnisht betohem se do të them të vërtetën, gjithë të vërtetën dhe vetëm të vërtetën dhe se nuk do të fsheh asgjë për të cilën kam dijeni.”**¹³⁴ Me qëllim që të vërtetohet identiteti i dëshmitarit dhe i lidhjeve e marrëdhënieve të dëshmitarit me pjesëmarrësit përkatës proceduralë, posaçërisht me të pandehurin, atij së pari i bëhen pyetje të përgjithshme (quoad personalia generalia), kurse pas pyetjeve të përgjithshme, kalohet në marrjen në pyetje për çështjen kyesore, me ç’rast dëshmitari thirret që të paraqesë atë që di për faktin përkatës.¹³⁵

3.1.1. Marrja e drejtpërdrejtë në pyetje e dëshmitarëve

Forma e parë dhe themelore e marrjes në pyetje të dëshmitarëve është marrja në pyetje e drejtpërdrejtë nga pala (Prokurori Publik ose mbrojtësi) i dëshmitarëve që i kanë propozuar në procedurë penale.

Sipas nenit 333 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, marrja e drejtpërdrejtë në pyetje e dëshmitarëve është e rregulluar si në vijim:

1. Dëshmitari merret në pyetje së pari nga pala e cila e ka propozuar.
2. Pala e cila merr në pyetje dëshmitarin mund t’i parashtrojë pyetje në pajtim me rregullat për procedimin e provave.
3. Pala mund t’i paraqesë dëshmitarit provën materiale në pajtim me nenin 336 të këtij Kodi.
4. Nëse dëshmitari apo eksperti nuk mund të rikujtojë faktet të cilat i ka paraqitur në dëshmimet e mëparshme, pala e cila ka propozuar dëshmitarin mund t’i paraqesë provën e pranueshme për t’ia rifreskuar kujtesën.¹³⁶

Gjatë marrjes në pyetje në mënyrë të drejtpërdrejtë duke u bazuar në nenin e lartpërmendur, këtë formë çdoherë e realizon pala e cila e ka propozuar atë dëshmitar që të paraqitet në cilësinë e dëshmitarit. Pra, marrjen në mënyrë të drejtpërdrejtë gjithmonë e realizon Prokurori i Shtetit ose mbrojtësi i cili e ka propozuar atë dëshmitar.

Sipas nenit 336 të KPP-së, mbi provat materiale që mbështesin dëshminë e dëshmitarit, rregullohet si në vijim:

1. Pala mund t’i paraqesë dëshmitarit provën materiale dhe t’i parashtrojë pyetje dëshmitarit lidhur me atë provë materiale gjatë marrjes në pyetje, marrjes së tërthortë në pyetje ose rimarrjes në pyetje.

¹³³E.Sahiti, R.Murati.,E Drejta e Procedurës Penale ,Prishtinë 2016,fq.271.

¹³⁴Azem Hajdari, Procedura Penale Komentar, Prishtinë 2010 , fq. 617.

¹³⁵E.Sahiti, R.Murati.,E Drejta e Procedurës Penale ,Prishtinë 2016,fq.271.

¹³⁶ Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës /Nr. 37,Prishtinë 2013, neni 333.

2. Provë materiale mund të jetë dokumenti, tabela, përmbledhja, videokaseta, audiokaseta apo prova tjetër materiale.

3. Çdo provë materiale që përmbledh ose tregon provë të pranueshme që është e shumtë, e madhe apo që është asgjësuar, së pari i paraqitet dëshmitarit i cili mund të identifikojë këtë provë si të pranueshme, të shpjegojë si është krijuar prova dhe të vërtetojë se prova është e vërtetë, e bazuar dhe paraqet saktësisht provën e pranueshme origjinale.

4. Cilado provë nga paragrafët 2 apo 3 të këtij neni është e pranueshme nëse është e vërtetë, e bazuar dhe paraqet saktësisht provën e pranueshme origjinale. Prova materiale shënohet në procesverbal, nëse nuk është shënuar më parë.¹³⁷

Sipas dispozitës ligjore të lartëshënuar, me rëndësi gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarit është edhe parashtrimi i provave materiale të pranueshme për të cilat dëshmitari në mënyrë më të hollësishme do të japë informacione. Në rastin kur gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarit, paraqiten prova materiale, si dokumente, tabela, videokaseta si dhe prova tjera materiale, dëshmitari është i detyruar të flasë në bazë të informacioneve të cilat i posedon mbi vërtetësinë ose pavërtetësinë e këtyre provave materiale. Në disa raste paraqitja e këtyre provave materiale mund të ketë ndikim pozitiv, ngaqë mund ta shtyjë dëshmitarin që të jap ndonjë informacion të cilin nuk do ta kishte dhënë, nëse nuk do të ishin paraqitur ato prova materiale.

3.1.2. Marrja e tërthortë në pyetje e dëshmitarëve

Marrjen e tërthortë në pyetje të dëshmitarëve e bën pala e kundërt, pas përfundimit të marrjes në pyetje në mënyrë të drejtpërdrejtë nga pala e cila e ka propozuar dëshmitarin në atë procedurë penale. E gjithë kjo mënyrë e marrjes në pyetje bëhet me qëllim të kundërshtimit të deklaratës së dhënë të dëshmitarit gjatë pyetjeve të drejtpërdrejta. Pyetjet të cilat parashtrohen gjatë marrjes së tërthortë në pyetje të dëshmitarëve janë plotësisht të kufizuara dhe duhet të përputhen me pyetjet e parashtruara gjatë marrjes në pyetje në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Sipas nenit 334 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, marrja e tërthortë në pyetje e dëshmitarëve është e rregulluar si në vijim:

1. Pala e cila bën marrjen e tërthortë në pyetje të dëshmitarit mund:

1.1. t'i parashtrojë pyetje dëshmitarit në pajtim me rregullat për procedimin e provave;

1.2. të pyesë dëshmitarin të konfirmojë ose të mohojë një fakt. Nëse dëshmitari jep përgjigje që është në kundërshtim me provën e pranueshme, pala e cila bën marrjen e tërthortë në pyetje pastaj mund t'ia paraqet ose t'ia lexojë dëshmitarit provën që është në kundërshtim. Pala e cila zbaton marrjen e tërthortë në pyetje ose gjykata mund të kërkojë nga dëshmitari që të shpjegojë mospërputhjet.

1.3. t'i parashtrojë dëshmitarit pyetje të cilat shqyrtojnë besueshmërinë e dëshmisë së dëshmitarit, apo paragjykimet që dëshmitari mund të ketë.

2. Provat materiale të përdorura gjatë marrjes së tërthortë në pyetje duhet të identifikohen qartë për gjykatën dhe përdorimi i provës së tillë shënohet në procesverbal.¹³⁸

¹³⁷Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës /Nr. 37, Prishtinë 2013, neni 336.

3.1.3. Rimarrja në pyetje

Sipas nenit 335 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, pas marrjes së tërthortë në pyetje të dëshmitarit, pala e cila ka propozuar dëshmitarin ka mundësinë që t'i parashtrojë pyetje të cilat sqarojnë dëshminë e paqartë, shpjegojnë mospërputhjet në dëshmi, dyshimet lidhur me besueshmërinë e dëshmisë së dëshmitarit apo çfarëdo paragjykimi që dëshmitari mund të ketë.¹³⁹

Rimarrja në pyetje realizohet nga pala e cila e ka propozuar atë dëshmitar në procedurë penale, të cilit i parashtrohen pyetje plotësuese me qëllim që të jape një shpjegim më të qartë mbi pyetjet e parashtruara gjatë marrjes në pyetje në mënyrë të tërthortë. Rimarrja në pyetje paraqet një fazë shumë të rëndësishme, sepse paraqet një mundësi për të eliminuar ose zvogëluar pasojat të cilat vijnë nga pyetjet e tërthorta të parashtruara nga pala kundërshtare.

Kjo mënyrë e marrjes në pyetje të dëshmitarit realizohet duke i parashtruar pyetje shtesë, të lidhura me temat e mëparshme dhe drejtimin e dëshmitarit të pyetjet të cilat janë parashtruar gjatë kohës së parashtrimit të pyetjeve të tërthorta, me të vetmin qëllim që dëshmitari të japë sqarime shtesë për elemente të caktuara të cilat janë diskutuar gjatë parashtrimit të pyetjeve të tërthorta të cilat mund të kenë mbetur të paqarta.

3.2. Përdorimi i dëshmisë së mëparshme të dëshmitarit

Sipas nenit 337 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, përdorimi i dëshmisë së mëparshme të dëshmitarit në shqyrtim gjyqësor është rregulluar si në vijim:

1.Pala mund të propozojë marrjen e provës në shqyrtim gjyqësor nga dëshmia e mëparshme e dëshmitarit, nëse dëshmia e tillë është marrë gjatë mundësisë hetuese të veçantë nga neni 149 të këtij Kodi.

2.Pala mund të propozojë marrjen e provës në shqyrtim gjyqësor nga dëshmia e mëparshme e dëshmitarit, nëse dëshmia e tillë është marrë gjatë seancës për marrjen e deklaratës në procedurë paraprake nga neni 132 i këtij Kodi, dëshmitari nuk është në dispozicion për të dëshmuar dhe është paraqitur mbështetje e pohimit në pajtim me nenin 263 të këtij Kodi.

3.Prokurori i Shtetit mund të propozojë marrjen e provës në shqyrtim gjyqësor nga audiokasetat apo videokasetat e të akuzuarit, të marra në pajtim me nenin 88 ose nenin 92 të këtij Kodi.

4.Nëse është bërë videokaseta ose audiokaseta e dëshmisë ose deklaratës nga paragrafi 1 deri 3 të këtij neni, ajo riprodhohet në tërësi gjatë shqyrtimit gjyqësor, përveç nëse gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues vendosin që dëgjimi i tërësishëm i videokasetës apo audiokasetës përmban tepër shumë informata të parëndësishme. Në rast të

¹³⁸Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës /Nr. 37,Prishtinë 2013, neni 334.

¹³⁹Po aty,neni 335.

tillë, gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues mund të urdhërojë që pjesë të veçanta dhe të rëndësishme të videokasetës apo audiokasetës të riprodhohen në shqyrtim gjyqësor.

5.Ky nen nuk ndalon përdorimin e deklaratave të mëparshme të dëshmitarit gjatë marrjes së tërthortë në pyetje të atij dëshmitari.¹⁴⁰

Duke u bazuar në dispozitën ligjore të lartpërmendura, mundësohet pranimi i përdorimit të dëshmisë së mëparshme të dëshmitarit të dhënë gjatë procedurës paraprake ose gjatë mundësisë hetuese të veçantë. Deri në përdorimin e kësaj dëshmie mund të vijmë atëherë kur personi i cili e ka dhënë dëshminë mbi rastin konkret në fazat e mëhershme është e rëndësishme të veçantë, kurse për shkaqe të arsyeshme nuk mund të paraqitet në shqyrtim gjyqësor për të dhënë përsëri dëshminë në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Duke parë rëndësinë e dëshmisë së tij në drejtim të zbardhjes së çështjes penale dhe mundësinë e marrjes së vendimit të drejtë gjyqësor, lejohet që dëshmia e mëparshme të transmetohet në shqyrtim gjyqësor përmes audiokasetës ose videokasetës.

3.3. Leximi i deklaratave të tjera të dhëna më parë

Sipas nenit 338 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, leximi i deklaratave të tjera të dhëna më parë është rregulluar si në vijim:

1. Përveç rasteve të parapara me këtë Kod, procesverbalet mbi deklarimet e dëshmitarëve, të bashkakuzuarve ose pjesëmarrësve të dënuar për vepër penale, si dhe procesverbalet dhe shkresat tjera mbi konstatimin dhe mendimin e ekspertit, sipas vendimit të trupit gjykues mund të lexohen vetëm në këto raste:

1.1. kur personat e marrë në pyetje kanë vdekur, kanë çrregullime ose paaftësi mendore, nuk mund të gjenden ose ardhja e tyre në gjykatë është e pamundur apo dukshëm e vështirësuar për shkak të pleqërisë, sëmundjes ose shkaqeve të tjera të rëndësishme;

1.2. kur dëshmitarët ose ekspertët, pa arsye ligjore, nuk dëshirojnë të dëshmojnë në shqyrtim gjyqësor; ose

1.3. kur palët pajtohen që në vend të marrjes së drejtpërdrejtë në pyetje të dëshmitarit apo ekspertit i cili nuk është i pranishëm, pavarësisht se ka qenë i thirrur, të lexohet procesverbali mbi dëshminë e tij të mëparshme.

2. Procesverbalet mbi marrjen e mëparshme në pyetje të personave të cilët janë liruar nga detyra e dëshmimit nuk lexohen, nëse këta persona nuk janë thirrur në shqyrtim gjyqësor ose nëse kanë deklaruar se nuk dëshirojnë të dëshmojnë në shqyrtimin gjyqësor. Kur personat e tillë, pasi të kenë dëshmuar më parë, e përdorin të drejtën e tyre për të mos dëshmuar në shqyrtim gjyqësor, ose nëse nuk kanë ardhur në shqyrtim kur janë thirrur, procesverbali mbi dëshminë e mëparshme është provë e papranueshme.

Arsyet e leximit të procesverbalit shënohen në procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor e në këtë mënyrë tegohet nëse dëshmitari ose eksperti është betuar.¹⁴¹

¹⁴⁰Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës /Nr. 37,Prishtinë 2013, neni 337.

¹⁴¹Po aty, neni 338.

3.4. Ballafaqimi i dëshmitarëve

Në procedurë penale në bazë të legjislacionit penal të Kosovës, mund të thirren një apo më shumë persona në cilësinë e dëshmitarit. Kështu që në rastet kur në procedurë penale merret dëshmia e dy ose më shumë personave në cilësinë e dëshmitarit, kuptohet se jo çdoherë dëshmitë e tyre janë të përputhshme njëra me tjetrën. Në këto raste paraqiten edhe pengesa dhe paqartësi edhe në punën e gjykatës.

Në këtë rast, sipas legjislacionit penal të Kosovës lejohet mundësia e ballafaqimit të dëshmitarëve, me ç'rast dëshmitarët mund të ballafaqohen kur dëshmitë e tyre esencialisht nuk përputhen. Të ballafaquarit pyeten veç e veç për secilën rrethanë për të cilën dëshmitë e tyre reciprokisht nuk pajtohen dhe përgjigja e tyre shënohet në procesverbal. Duhet pasur parasysh se në të njëjtën kohë mund të ballafaqohen vetëm dy dëshmitarë.¹⁴²

Si kusht kryesor me të cilin do të lejohet përdorimi i mundësisë se ballafaqimit të dëshmitarëve është që dëshmitë e dëshmitarëve të dhëna pa prezencën e njëri tjetrit të jenë esencialisht të papapëruethshme. Me rastin e përmbushjes së kushteve për mundësinë e ballafaqimit të dëshmitarëve, fillimisht të ballafaquarit pyeten veç e veç për të gjitha rrethanat për të cilat dëshmitë e tyre nuk përputhen dhe e gjithë kjo shënohet në procesverbal. Nëse edhe pas kësaj faze ka dallime esenciale midis deklarimeve të dëshmitarëve të ballafaquar, atëherë kalohet në fazën e fundit të procesit të ballafaqimit. Pra, pas kësaj organizohet ballafaqimi i dëshmitarëve ballë për ballë, me ç'rast gjatë ballafaqimit më së shumti mund të ballafaqohen dy dëshmitarë.¹⁴³

4. Mbrojtja e dëshmitarëve

Procedura penale paraqet një nga procedurat me dinamikë të madhe, por njëkohësisht edhe një procedurë shumë të ndërlikuar e veçanërisht në rastet kur vëndohet në rrezik jeta e personave të cilët janë pjesëmarrës në procedurën penale konkrete, ngaqë gjykata është e obliguar të ndër marrë veprime me të cilat do t'u mundësojë pjesëmarrësve qasje më të përshtatshme në procedurë.

Mbrojtja e dëshmitarëve në procedurë penale vjen në shprehje në rastet kur ekziston rrezik serioz për të dëmtuarin, dëshmitarin bashkëpunues, dëshmitarin apo anëtarët e familjeve të tyre. Me këtë rast paraqitet nevoja që ndaj tyre të ndërmerren masa mbrojtëse për të mos ardhur situata deri në paraqitjen e ndonjë veprimi negativ ndaj tyre, veprim i cili do t'i dëmtonte ato.

Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, si forma të mbrojtjes së dëshmitarëve në procedurë penale paraqiten masat mbrojtëse si dhe urdhri për anominitet.

¹⁴²Azem Hajdari, Procedura Penale Komentar, Prishtinë 2010, fq. 441.

¹⁴³Po aty, fq 442.

4.1. Kërkesa për masë mbrojtëse ose anonimitet

Prokurori i Shtetit, i pandehuri, mbrojtësi, i dëmtuari, dëshmitari bashkëpunues apo dëshmitari, në cilëndo fazë të procedurës mund t'i paraqesin gjyqtarit kompetent kërkesë me shkrim për masën mbrojtëse ose urdhrin për anonimitet kur ka rrezik serioz për të dëmtuarin, dëshmitarin bashkëpunues, dëshmitarin apo anëtarët e familjeve të tyre. Kërkesa përmban deklaratën e pretendimeve faktike. Gjyqtari kompetent evidenton kërkesën dhe deklaratën në një zarf të mbyllur dhe përmbajtjeve të tyre gjatë rrjedhës së procedurës kanë mundësi t'u qasen vetëm gjyqtari kompetent dhe Prokurori i Shtetit. Pas marrjes së kërkesës, gjyqtari kompetent mund të urdhërojë masa të përshtatshme mbrojtëse për të dëmtuarin, dëshmitarin bashkëpunues ose dëshmitarin, e nëse ai e sheh të nevojshme para se të marrë vendim për kërkesën, thërret seancë dëgjimore të mbyllur për të dëgjuar informata shtesë nga Prokurori i Shtetit, i pandehuri, mbrojtësi, të dëmtuarit, dëshmitarët bashkëpunues ose dëshmitarët.¹⁴⁴ Gjyqtari mund të urdhërojë masën mbrojtëse për të dëmtuarin, dëshmitarin bashkëpunues ose dëshmitarin kur ai konstaton se:

1. ekziston rrezik serioz për të dëmtuarin, dëshmitarin bashkëpunues, dëshmitarin ose për anëtarin e familjes së tij; dhe
2. masa mbrojtëse është e domosdoshme për të parandaluar rrezikun serioz për të dëmtuarin, dëshmitarin bashkëpunues, dëshmitarin ose anëtarin e familjes së tij.¹⁴⁵

4.1.1. Urdhri për masa mbrojtëse

Sipas Kodit të Procedurës Penale janë parashikuar një numër i konsiderueshëm i masave mbrojtëse të cilat mund t'i caktohen të dëmtuarit ose dëshmitarit të vënë në mbrojtje. Varësisht prej rastit mund të zbatohen më shumë se një masë mbrojtëse. Qëllimi i zbatimit të masave mbrojtëse është që t'u jepet mundësia e dëshmimit edhe personave të rrezikuar, me qëllim që të arrihet deri te zbardhja e çështjes penale. Urdhri për masë mbrojtëse bëhet me shkrim dhe nuk përfshin informata të cilat mund të çojnë në zbulimin e identitetit të të dëmtuarit, dëshmitarit bashkëpunues, dëshmitarit ose të anëtarit të familjes së tij, ose të cilat mund ta zbulojnë ekzistimin ose seriozisht të rrezikojë sigurinë e veprimeve hetimore të policisë dhe fshehtësinë e tyre.

Sipas nenit 222, paragrafit (1) të Kodit të Procedurës Penale, gjyqtari kompetent mund të japë urdhrë për masa të tilla mbrojtëse kur e sheh të nevojshme, duke përfshirë por pa u kufizuar në:

1. lënien bosh ose shlyerjen e emrave, adresave, vendit të punës, profesionit ose ndonjë të dhëne apo informate tjetër që mund të përdoret për të identifikuar të dëmtuarin, dëshmitarin bashkëpunues ose dëshmitarin;
2. moszbulimin e ndonjë shkrese që identifikon të dëmtuarin, dëshmitarin bashkëpunues ose dëshmitarin;

¹⁴⁴ Azem Hajdari, Procedura Penale Komentar, Prishtinë 2010, fq. 443.

¹⁴⁵ Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës /Nr. 37, Prishtinë 2013, neni 221 paragrafi (4).

3. përpjekjen për të fshehur veçoritë ose përshkrimin fizik të të dëmtuarit, dëshmitarit bashkëpunues apo dëshmitarit që jep dëshminë, duke përfshirë dhënien e dëshmisë prapa një mburoje jo të tejdukshme apo përmes pajisjeve për ndryshimin e fotografisë ose të zërit, ose marrjen në pyetje të njëkohshme nga një vend tjetër që komunikon me gjykatoren me anën e qarkut të mbyllur televiziv, ose videoregjistrimin para seancës dëgjimore në praninë e mbrojtësit;
4. caktimin e pseudonimit;
5. seancën e mbyllur për publikun;
6. urdhrat ndaj mbrojtësit për të mos zbuluar identitetin e të dëmtuarit, dëshmitarit bashkëpunues apo dëshmitarit, ose për të mos zbuluar ndonjë material apo informacion që mund të shpie në zbulimin e identitetit;
7. largimin e përkohshëm të të pandehurit nga gjykatorja, nëse dëshmitari bashkëpunues ose dëshmitari refuzon të dëshmojë në prani të të pandehurit, apo nëse rrethanat ia bëjnë të ditur gjykatës se dëshmitari nuk do ta flasë të vërtetën në prani të të pandehurit; ose
8. cilito kombinim i metodave të përmendura më lart për të parandaluar zbulimin e identitetit të të dëmtuarit, dëshmitarit bashkëpunues ose dëshmitarit.¹⁴⁶

4.1.2. Urdhri për anonimitet nga publiku

Në rastet kur masat mbrojtëse janë të pamjaftueshme për të garantuar mbrojtjen e dëshmitarit të propozuar nga mbrojtja, në rrethana të jashtëzakonshme gjyqtari mund të urdhërojë anonimitet me ç'rast dëshmitari mbetet anonim për publikun, të dëmtuarin, paditësin subsidiar ose paditësin privat dhe përfaqësuesit e tyre ligjorë ose përfaqësuesit e autorizuar. Një mundësi e tillë shfrytëzohet nga pala mbrojtëse kur ajo vlerëson se masat e propozuara të mbrojtjes janë të pamjaftueshme për mbrojtjen e dëshmitarit. Qëllimi i gjithë kësaj procedure qëndron në atë që dëshmitari i tillë të mos mund të identifikohet nga rrethi i personave nga të cilët edhe mund t'i kanoset ndonjë rrezik. Para marrjes së urdhrit për anonimitet, gjyqtari kompetent mban seancë dëgjimore me dyer të mbyllura, në të cilën merren në pyetje dëshmitari përkatës dhe personat tjerë të nevojshëm, siç janë personeli policor dhe personeli ushtarak që kujdesen për sigurinë. Përveç këtyre personave, të pranishëm mund të jenë vetëm Prokurori i Shtetit, personeli i domosdoshëm i gjykatës e i prokurorisë dhe mbrojtësi.¹⁴⁷

Sipas nenit 223 paragrafi (3), gjyqtari kompetent mund të nxjerrë urdhër për anonimitet vetëm kur ai çmon se:

1. ekziston rrezik serioz për dëshmitarin ose anëtarin e familjes së tij dhe anonimiteti i plotë i dëshmitarit është i nevojshëm për të parandaluar rrezikun e tillë serioz;
2. dëshmia e dëshmitarit është e rëndësishme për çështjen, saqë e bën të padrejtë realizimin e mbrojtjes pa të;
3. besueshmëria e dëshmitarit është hetuar dhe zbuluar plotësisht për gjyqtarin në seancë të mbyllur; dhe

¹⁴⁶Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës /Nr. 37, Prishtinë 2013, neni 222 paragrafi (1).

¹⁴⁷Azem Hajdari, Procedura Penale Komentar, Prishtinë 2010, fq. 448.

4. nevoja për anonimitetin e dëshmitarit është më e rëndësishme për vënien e drejtësisë, sesa interesi i publikut apo të dëmtuarit për ta ditur identitetin e dëshmitarit në zbatimin e procedurës.¹⁴⁸

4.1.3. Urdhri për anonimitet prej të pandehurit

Në rastin kur masat mbrojtëse të parapara në neni 222, paragrafi (1) i Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës janë të pamjaftueshme për të garantuar mbrojtjen e të dëmtuarit, dëshmitarit bashkëpunues ose të dëshmitarit i cili nuk është propozuar nga mbrojtja, gjyqtari kompetent në rrethana të jashtëzakonshme mund të marrë urdhër për anonimitet me të cilin i dëmtuari, dëshmitari bashkëpunues ose dëshmitari mbetet anonim për të pandehurin dhe mbrojtësin.

Sipas nenit 224, paragrafi (2) i KPP-së, Prokurori i Shtetit kërkon urdhër për anonimitet prej të pandehurit vetëm me propozim me shkrim të mbyllur ku paraqiten fakte të cilat tregojnë se:

- 1.ekziston rrezik serioz për të dëmtuarin, dëshmitarin bashkëpunues ose dëshmitarin për të cilin kërkohet urdhri për anonimitet; dhe
2. anonimiteti do të parandalonte rrezikun serioz për të dëmtuarin, dëshmitarin bashkëpunues ose dëshmitarin.¹⁴⁹

Para se gjykatësi të marrë urdhër për anonimitet, ai zbaton seancë dëgjimi me dyer të mbyllura, në të cilën merren në pyetje i dëmtuari ose dëshmitari në fjalë dhe personat tjerë të nevojshëm, siç është personeli policor ose ushtarak që kujdesen për rendin. Përveç këtyre personave, të pranishëm mund të jenë vetëm Prokurori Publik, personeli kryesor i gjykatës e i prokurorisë dhe mbrojtësi.¹⁵⁰

Gjykatësi kompetent dhënie anonimitet prej të pandehurit e jep vetëm pas shqyrtimit të të gjitha çështjeve të cilat kanë të bëjnë me dhënie e urdhrit për anonimitet prej të pandehurit si dhe plotësimit të kushteve të cilat janë të përcaktuara me Kodin e Procedurës Penale për dhënie e këtij urdhri.

Sipas nenit 224 paragrafi (5), gjyqtari kompetent mund të nxjerrë urdhër të tillë për anonimitet vetëm kur ai çmon se:

- 1.ekziston rrezik serioz për të dëmtuarin, dëshmitarin bashkëpunues ose dëshmitarin apo anëtarin e familjes së tij dhe anonimiteti i plotë i të dëmtuarit, dëshmitarit bashkëpunues ose dëshmitarit është i nevojshëm për të parandaluar rrezikun e tillë serioz;
- 2.dëshmia e të dëmtuarit, e dëshmitarit bashkëpunues ose e dëshmitarit është e rëndësishme për çështjen, saqë e bën të padrejtë realizimin e ndjekjes pa të;
- 3.besueshmëria e të dëmtuarit, dëshmitarit bashkëpunues ose dëshmitarit është hetuar dhe zbuluar plotësisht për gjyqtarin kompetent në seancë të mbyllur; dhe

¹⁴⁸Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës /Nr. 37,Prishtinë 2013, neni 222 paragrafi (3).

¹⁴⁹Po aty, neni 224 paragrafi (2).

¹⁵⁰Azem Hajdari, Procedura Penale Komentar, Prishtinë 2010 , fq. 448.

4.nevoja për anonimitetin e të dëmtuarit, dëshmitarit bashkëpunues ose dëshmitarit është më e rëndësishme për vënien e drejtësisë, sesa interesi i të pandehurit për ta ditur identitetin e të dëmtuarit, dëshmitarit bashkëpunues apo dëshmitarit në zbatimin e mbrojtjes.¹⁵¹

Urdhri për anonimitet duhet të bëhet me shkrim dhe nuk përmban ndonjë informacion që mund të çojë në zbulimin e identitetit të të dëmtuarit, dëshmitarit ose anëtarit të familjes së tij, ekzistimin ose ekspozimin ndaj një rreziku serioz për të siguruar vazhdimin e hetimeve të fshehta të policisë. Të gjitha të dhënat nga procesverbali i seancës së mbyllur hiqen nga procesverbali, vulosen dhe ruhen si fshehtësi zyrtare menjëherë pas identifikimit dhe para marrjes në pyetje të të dëmtuarit ose dëshmitarit.¹⁵²

¹⁵¹Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës /Nr. 37,Prishtinë 2013, neni 224 paragrafi (5).

¹⁵²Azem Hajdari, Procedura Penale Komentar, Prishtinë 2010 , fq. 451.

Kapitulli IV

1.Raste nga praktika të dëshmime të dëshmitarëve

1.Në seancën kryesore para Gjykatës Themelore në Tetovë,kundër të pandehurit B.K nga fsh.Drasllavic-Strugë dhe F.F nga Labunishta-Strugë, të akuzuar për veprën penale – MASHTRIMI - nga neni 247 i Kodit Penal.

Në bazë të procesverbalit të datës 25.03.2019, në seancë dëshmuese merret si provë dëshmia e dëshmitarit B.E. nga fshati Sllatinë.

-Gjatë marrjes në pyetje në mënyrë të drejtpërdrejtë nga Prokurori Publik dëshmoi:

Të pandehurit B.K. dhe F.F. prej më parë nuk i kam njohur. Nuk edi se si B.E. e kishte numrin tim të telefonit dhe pa mos u parë kemi biseduar disa herë në telefon për arsye se ishte i interesuar që të blejë pllaka. Vëllau im ka firmë,gjithashtu kemi edhe dyqan në të cilin kemi pllaka të cilat edhe i shesim sëbashku me pajisjet sanitare. Në datën e saktë nuk kujtohem, por ishte dimër, kur në shitoren tonë në fshat erdhën këto të dy (të pandehurit).

B.K. mu prezantua dhe me atë sëbashku biseduam rreth blerjes së pllakave dhe mënyrës së realizimit të pagesës. F.F. tani e di sesi quhet i cili atë ditë ishte me B.E. i cili nuk ndërhynte në bisedë, por qëndronte në një anë.

B.E. më tha se është i interesuar për të blerë 1350 m2 prej pllakave të ndryshme për çmim prej 5 Euro në katror. Më tha se është mirë që ti porosisin menjëherë pllakat dhe se do ta pagonte shumën për të cilën kishin biseduar.

Pas 3 ditësh pasi ishim dakorduar me B.K., angazhova një kamion për transport të pllakave dhe i paketuam ato në kamion. Unë personalisht me veturën time e ndjeka kamionin deri në Strugë. Njëkohësisht bisedova në telefon edhe me B.K. dhe u morëm vesh se ku do ti dërgonim pllakat për ti shkarkuar. Pllakat duhej ti shkarkonim në një pllac, pllac i cili nuk edinja se i kujt është,mirëpo kur arritëm tek pllaci atëherë më tha se pllaci është i F.F.

F.F. kur i pa pllakat tha se nuk dua që ti blej këto pllaka, mirëpo dha si sygjërim që nëse dëshiron mund të qëndrojnë pllakat këtu në pllac derisa të dalë ndonjë blerës. Në këtë moment B.K. përsëri më bindi se ka ndonjë blerës të interesuar prej Prilepi i cili sigurt do ti blej pllakat.

F.F. doli korrekt, edhe vet ai dyshonte në këtë dhe nëse do ta kisha dëgjuar atë nuk do të kishte ndodhur një gjë e tillë.

F.F. kishte kamionin e tij,u dakorduam për çmimin dhe pasi i ngarkuam pllakat në kamionin e tij ato u larguan për në Prilep. Unë nuk e ndjeka kamionin mendova se në të vërtetë B.E. do ti shesë pllakat në Prilep.

Sa që kuptova unë,pllakat me të vërtetë ishin dërguar për në Prilep, por për cilin dhe ku nuk e di. Prej atëherë shpesh herë kam ardhur në Strugë për tu takuar me B.E. për të biseduar lidhur me pagesën. Nga ana e tij çdo herë e mora përgjigjen se do të kryhet pagesa, mirëpo deri sot asgjë nuk më është paguar nga ajo që e kanë marrë. Edhe transportin me të

cilin i dërguam pllakat deri në Strugë e kam paguar unë personalisht dhe gjysmën e çmimit prej Struge deri në Prilep.

Siç u theksua më parë se kemi nënshkruar fakturë dhe fletë dërgimi në emër të firmës së vëllaut tim, të cilat edhe deri sot nuk më janë paguar asgjë.

Dua të them se të gjithë pllakat ishin të përzier, pllaka për në dysHEME dhe pllaka për në mur. Siç theksova shumë herë kam qenë te B.K. në Strugë, pothuajse gati 10 herë dhe çdo herë B.K. më premonte. Kur e pash se nga kjo nuk ka asgjë shkova edhe në Prilep dhe e gjeta pllacin në të cilin ishin shkarkuar pllakat dhe personin tek i cili ishin pllakat. Ai më tha se me mua nuk ke asgjë pasi që pllakat nuk i kam blerë nga ty, kurse në bashkëbisedim me B.K. më ofruan kompenzim me një veturë me çmim shumë të lartë, me çrast nëse vetura kushtonte 5.000 euro ato ma llogaritnin 15.000 euro.

Unë F.F. i mbeta borxh sepse nuk ja pagova çmimin e transportit me kamion prej Struge deri në Prilep, pasi që siç thash kamioni ishte i atij. Disa herë kam dalur me F.F. kur kam shkuar në Strugë pasi që mu duk si njeri i ndershëm. Në një bashkëbisedim me tregoi se edhe ai personalisht ka një borxh të papastuar me B.K. i cili ia ka marrë ndonjë mashinë F.F. të cilit ende nuk ia ka paguar.

Çmimi i transportit nga Struga deri në Prilep, në pllacin ku janë dërguar pllakat me kamionin e F.F. kishte arritur 12.300 denarë. Këtë çmim duhej që ta paguaja unë mirëpo ende nuk e kam paguar. Fkaturën me këtë çmim e kamanuluar ,pasi që pranoj si borxhin tim për transportin e realizuar.

Unë për të gjithë kohën kam pasur punë me B.K., kurse personin F.F. dhe E. nga fsh. Debresh i Prilepit nuk i kam njohur dhe me ato nuk kam pasur asnjë punë, dhe për këtë arsye edhe fakturën ia kam dhënë B.K. dhe shumë e pllakave ai duhet të ma paguaj. Deri sot para për pllakat nuk më kanë dhënë as B.K. e as E. nga Prilepi. E. prej Prilepi më ofroi një veturë të tipit Citroen e cila kishte një çmim prej 2000 euro si kompenzim të çmimit të pllakave. Nëse e llogarisim këtë veturë të cilën e kam marrë diku rreth 3 muaj më parë, atëherë duhet që të më paguajnë edhe një shum prej 3.000 deri 4.000 euro, para të cilat i kërkoj nga B.E.

Konsideroj se jam mashtruar, tallej me mua B.E., çka kam unë që të humb kohë që të shkoj në Strugë dhe në Prilep për pllakat e mia. Firma udhëhiqet në emër të vëllaut tim M.E., mirëpo ajo është vetëm në mënyrë fiktive në emër të vëllaut tim, firma është e imja sepse unë kam finansuar në atë firmë dhe në vazhdim po e finansoj, me çrast edhe pllakat për të cilat bëhet fjalë janë të mijat.

-Gjatë marrjes në pyetje në mënyrë të tërthortë nga mbrojtja dëshmoi:

Unë siç theksova shkoja me veturë pas kamionit kur për herë të parë pllakat i transportuam për në Strugë dhe se kur i shkarkuam pllakat nuk e dija se ku po shkarkoheshin pllakat e transportuara dhe më pas e mora vesht se bëhej fjalë për pllacin e F.F. Aty tek pllaci pash se kishte kamiona, bagerra. Kur F.F. theksoi se do ti dërgonte pllakat në Prilep me kamionin e tij, ai këtë e bëri pa ndonjë interes personal. Dëshironte që të ndihmonte kur e kuptoi se nuk doja të digjoja më dhe pllakat dëshiroja ti merrnja përsëri dhe ti kthenja në shitore. Me sa kam njohuri unë, F.F. nuk ka marrë pjesë nga pllakat,por të gjithë pllakat janë transportuar në pllacin e E. në Prilep.

-Gjatë marrjes në pyetje në mënyrë të tërthortë nga mbrojtësi i të pandehurit B.K., dëshmoi:

Faktura e anuluar, a ishte në emër të B.K.?

Unë nuk e kuptoj se çka do të thotë anulim,për këtë edhe një herë them se i dërgova dokument B.K. për pllakat, kurse shumën prej 12.300 denarë për transportin që duhet tia paguaj F.F. e llogaris si dokument të anuluar.

Unë po ta shpjegoj edhe një herë se përpilova një fletë dërgimi me 1350 m2 pllaka dhe atë fletë dërgimi si dokument personalisht ia dorëzova B.K. kur isha te ai në Strugë. B.K. personalisht e nënshkroi fletën e dërgimit, kurse fakturë nuk i kam dhënë sepse ai nuk posedon firmë.

Mbrojtësi i të pandehurit B.K. deklaroi:

Dua që të paraqes përpara gjykatës fletën e dërgimit që ta shoh edhe dëshmitari dhe të na tregojë se për çka bëhet fjalë në këtë fletë dërgimi.

Pas përcjelles së fletë dërgimit të propozuar, dëshmitari deklaroi:

Kjo fletë dërgimi nuk ka asnjë lidhje me fletën e dërgimit që unë ia kam dhënë B.K. që personalisht ta nënshkruaj. Në këtë fletë dërgimi që ju e sollët nuk është nënshkrimi im, kështu që kush e ka nënshkruar unë nuk edi. E vërtetë është se ekziston firma F.D. dhe se kam përpiluar fakturë për këtë firmë në lidhje me pllakat. Herën e parë kur erdhën tek mua B.K. dhe F.F., asesi nuk theksuan për ndonjë firmë dhe se aspak nuk kemi biseduar se ku duhet të jenë dërguar pllakat pasi që këtë e lamë që ta bisedojmë më vonë. Pas 2-3 ditëve përsëri erdhën B.K. dhe F.F. dhe shkuam për të darkuar ku gjithashtu biseduam për këtë çështje, mirëpo përsëri nuk u përmend emri i firmës në të cilnë duhej që të

bëhej faktura. Më pas kur ikën ato, B.K. nëpërmjet telefonit më dërgoi detajet mbi firmën në të cilën duhej që të dërgohej faktura për pllakat. Bëhej fjalë për firmën F.D.

B.K. kur më dërgoi të dhënat e firmës nuk më tregoi se kush ishte udhëheqësi i asaj kompanie. Unë fakturën për pllakat e përpilova në bazë të të dhënave të asaj firme, mirëpo nuk jam i sigurt nëse fakturën e përpilova para se ti transportoja pllakat për në Strugë ose pas transportimit. Në Strugë u informova se firma është në emër të F.F., mirëpo për shkak se ai refuzoi që ti pranoj pllakat, unë këtë fakturë e anulova- stornira.

Kjo fakturë me sa më kujtohet nuk është nënshkruar nga askush dhe menjëherë në strugë e kemi anuluar pasi që kuptova se personi ishte i ndershtëm dhe se nuk kishte lidhje me këtë punë. Unë mundem që gjykatës ti paraqes fletë dërgimi shtesë e cila është origjinale dhe i takon B.E. dhe po të njejtën ai e ka nënshkruar. Për fakturën e cila qëndron në emër të kompanisë F.D. nuk jam i sigurt se ku ndodhet, duhet që ti kontrolloj dokumentat dhe nëse e gjej do jua sjell edhe atë. Kur i shkarkuam pllakat në pllacin e F.F., kishte disa punëtorë dhe ishin të pranishëm edhe vozitësit e kamionit të cilët i transportuan pllakat.

Kur u kuptua se faktura nuk mund të përpilohej në emër të kompanisë F.D., pasi që F.F. nuk kishte asnjë lidhje me këtë punë, duhej që të bëhej një dokument për pllakat.

B.K. nuk pranonte që të bëhej një dokument i tillë. Megjithatë në një rast ai ishte ndaluar nga policia në Prilep. Atëherë e shfrytëzova rastin dhe në polici në Prilep ia dhash fletën e dërgimit që ta nënshkruaj dhe aty në moment B.K. e nënshkroi atë. Pllakat u shkarkuan dhe tani nuk më kujtohet se çfarë dite ka qenë, mirëpo siç thashë pllata i shkarkuam në pllacin e F.F. dhe pas disa ditësh pasi erdhe në Strugë u dakorduam që pllakat të transportohen për në Prilep.

Kur e lajmërova rastin në polici, i lajmërova të dy edhe B.K. edhe F.F., edhe pse F.F. sipas meje nuk kishte asnjë faj, e lajmërova atë në polici që përmes tij të arrija tek B.K., pasi që B.K. fshiheshte dhe nuk dëshironte të komunikonte me mua në asnjë moment dhe për këtë arsye edhe e morra atë veprim në polici.

2. Në seancën kryesore para Gjykatës Themelore në Tetovë, kundër të pandehurit B.K nga fsh. Draslavic-Strugë dhe F.F nga Labunisht-Strugë, të akuzuar për veprën penale – MASHTRIMI - nga neni 247 i Kodit Penal.

Në bazë të procesverbalit të datës 14.10.2019, në seancë dëshmuase merret si provë dëshmia e dëshmitarit G.N. nga fshati Sllatinë.

-Gjatë marrjes në pyetje në mënyrë të drejtpërdrejtë nga Prokurori Publik dëshmoi:

Punoj privat si mjeshtër i pllakave. Njihem mirë me të dëmtuarin B.E. dhe edë që ai bashkë me vëllain e tij në Sllatinë kanë shitore në të cilin shesin pllaka. Tash nuk mund të kujtohem në datën e saktë, mirëpo për të gjithë punën që jam thirrur për të dëshmuar, pllakat të cilat ishin lëndë e transportit për në Strugë, unë personalisht i kam publikuar në internet, i

reklamova si pllaka me kualitet të lartë.Në telefon mu lajmërua dhe komunikova me B.K. të cilin unë nuk e kam parë dhe as nuk ia kam ditur emrin. Ai më pas, nëpërmjet mesazheve mu paraqit si i interesuar dhe kërkonte informata më të detajuara ku të vijë që ti shoh pllakat. Unë i shkruajta se me cilin të komunikojë,pra me B.E. ,kurse çka ka ndodhur më pas nuk kam asnjë informatë nëse B.K. ka ardhur në shitore dhe a ka ardhur vetë ose me dikë tjetër dhe çka kanë biseduar.

Përsëris edhe njëherë,në shitoren e pllakave ku ato janë takuar dhe kanë biseduar nuk kam qenë i pranishëm.

Tani përsëri nuk më kujtohet data kur më thirri B.E. të shkojë në pllacin e pllakave që ti ndihmoj që ti paketojmë pllakat për transport.

Ora ishte rreth 16.00 kur unë arrita në pllacin dhe kamioni i firmës në fsh.Leshok kishte arritur, me çrast i ndihmova B.E. për ti ngarkuar në kamion dhe më pas bashkë me B.E. me veturën time u nisëm para kamionit për në Strugë.

U nisëm para kamionit dhe për këtë arsye arritëm edhe para se të arrinte kamioni në Ohër në vendin në të cilin e kishin lënë për tu takuar B.E. me B.K. Arritëm në vendin e caktuar dhe unë për herë të parë e pash se si dukej personi B.K. pasi që kisha komunikuar vetëm përmes mesazheve. Sëbashku e pritëm kamionin që të arrijë dhe u nisëm për në një fshat të Strugës në të cilin ndodhej pllaci ku atje na priste F.F.

Më parë B.E. më kishte folur për F.F. se kishte ardhur në fsh.Sllatinë dhe ishin dakorduar që po i njejtë kishte vendosur që ti blej këto pllaka.Pllakat i shkarkuam në pllacin e tij.Kur shkova që ti kërkoj parat e pllakave,F.F më tha se para nuk kanë mirëpo si kompenzim do ju japim një kombe dhe BMW. Shkuam dhe i pam veturat mirëpo ato B.E. nuk i pëlqyen dhe nuk i pranoi. Më pas F.F. i dha ofer tjetër që kompenzimin e pllakave ta bëjë me një punë tjetër ,pra përsëri me një kompenzim me çrast çmimin e pllakave ta kompenzojmë me transport të paguar të pllakave të cilat kompania e B.E. do ti transporton nga Italia.

B.E. u dakordua me këtë kompenzim,pimë kafe me F.F. më pas e nënshkruajti fletën e dërgimit dhe fakturën, veprim të cilin e pash edhe me sytë e mi. Të gjithë kohën me ne ishte edhe B.K. Më pas ne u kthyem për në shtëpi, pllakat mbetën në pllacin e F.F. dhe çka ka ndodhur më pas nuk jam i informuar.

Fakturën të cilën e nënshkruajti F.F. e mori B.E.

-Gjatë marrjes në pyetje në mënyrë të drejtpërdrejtë nga i autorizuari i të dëmtuarit dëshmoi:

Siç thash edhe më lart, fakturën dhe fletën e dërgimit,personalisht e nënshkruajti vet F.F.Kur pijmë kafe, F.F. më tregoi se kanë ndonjë marrëveshje me B.K. dhe se B.K. duhet që tia sjell dhe se këtë ai e pranon.

A bëheshte fjalë për këto pllaka ose jo nuk edi,mirëpo këto pllaka të cilat ishin sjellur F.F. i pranoi.

B.K. na dërgoi në pllacin e F.F. pasiqë ai e dinte ku ndodhej pllaci dhe për këtë arsye B.E. na priti në Ohër dhe më pas na dërgoi te pllaci në të cilin na priste F.F. dhe na tha që ti shkarkojmë pllakat.

-Gjatë marrjes në pyetje në mënyrë të tërthortë nga i autorizuari i F.F dëshmoi:

Përsëris edhe njëherë se nuk jam i punësuar tek B.E. por jam duke punuar privatisht. F.F. me mua nuk ka arritur marrëveshje dhe as nuk ka biseduar se sa pllaka duhet që ti dërgohen, cili model dhe me çfarë çmimi dhe po për të njëjtën nuk ka biseduar as B.K.

Përsëri më nuk kam ardhur në pllacin e F.F., ajo ishte hera e parë dhe e fundit. Nuk e kam idenë se çka ka ndodhur me ato pllaka dhe a janë ende në pllacin e F.F.

Unë ju thash se F.F. e nënshkroi, mirëpo për më shumë nuk kam informacione dhe nuk mundem tju siguroj se për çka bëheshte fjalë, përblerje, transport ose për pranim të pllakava.

Duke analizuar dëshmitë e personave të cilët në rastin konkret paraqiten në cilësinë e dëshmitarit në procedurë penale në të cilën ndaj të pandehurit udhëhiqet procedurë penale për veprën penale të Mashtrimit e përcaktuar në nenin 247 të Kodit Penal të RM-së.

Dëshmitë të cilat i japin personat e lartpërmendur në cilësinë e dëshmitarit janë dëshmi të qarta të cilat gjykata i merr parasysh me rastin e marrjes së vendimit gjyqësor. Të dy dëshmitarët, si B.E. ashtu edhe G.N. na japin informacione të rëndësishme se si ka ardhur deri tek mashtrimi ndaj personit i cili në besim ia ka shitur pllakat të pandehurit, me mendimin se do të marrë kompenzimin për ato pllaka pa kurrfarë vonese dhe problemi, mirëpo fatkeqësisht ndodh e kundërta dhe kjo çështje vendoset që të marrë epilog në procedurë gjyqësore. Epilogu i kësaj çështjeje ende nuk ka marrë në vendim përfundimtar, por vazhdon në fazat e më tutjeshme deri tek marrja e një vendimi gjyqësor të drejtë.

INTERVISTA ME SHKRIM

1. Intervistë me shkrim me Gjykatësin Adi Useini nga Gjykata Themelore në Strugë lidhur me dëshminë e dëshmitarit në procedurë penale

1. Për ju si gjykatës, sa është e rëndësishme dëshmia dëshmitarit në procedurë penale?

Dëshmia e dëshmitarit në procedurë penale është shumë e rëndësishme. Ato i ndajmë në dëshmi me shkrim dhe dëshmi të dhëna në mënyrë gojore. Rëndësi më të veçantë i kushtojmë dëshmisë me gojë, me ç'rast thirrja e dëshmitarit për të deklaruar dërgohet me shkrim, kurse dëshmitari e jep dëshminë në formë gojore para trupit gjykues.

Para se të fillohet me dhënien e dëshmisë, gjykata do ta paralajmërojë dëshmitarin se dëshmia e rrejshme paraqet vepër penale.

Dëshmitari betohet para dhënies së dëshmisë me ç'rast betohet duke përsëritur këto fjalë: ‘Betohem në nderin tim se për gjithçka që do të pyetem, do ta them të vërtetën dhe gjithçka që kam dëgjuar dhe kam parë nuk do të hesht’.

2. Për cilat vepra penale, dëshmia e dëshmitarit kërkon rëndësi më të veçantë?

Dëshmia e dëshmitarit është mirë të paraqitet si provë në të gjithë procedurat penale pasi që paraqet një provë shumë të vlefshme për çdo vepër penale. Rëndësia e dëshmisë së dëshmitarit vërehet më së shumti te Deliktet e gjakut, te Vrasjet e sidomos te Vrasjet e Rënda etj.

Nga praktika ime si Gjykatës, do të veçojë një Vrasje e cila ndodhi në një fshat të Strugës në të cilën mbet i vrarë një person i gjinisë mashkullore i moshës së re, me ç'rast nuk kishte dëshmitar në veprën penale konkrete dhe ishte shumë e vështirë për Gjykatën për të arritur deri tek e vërteta.

3. Sa ndikon dëshmia e dëshmitarit në vendimin gjyqësor të gjykatës?

Çdo dëshmi e plotë dhe e vërtetë ndikon në zgjidhjen e kontesteve penale. Dëshmia e vërtetë dhe e saktë është burim i të drejtës penale.

4. A ka pasur raste kur në mungesë të provave të tjera në një procedurë penale konkrete, vendimi gjyqësor është mbështetur në bazë të dëshmisë së dëshmitarit?

Në praktikë paraqiten raste të shpeshta në të cilat dëshmisë së dëshmitarit i jepet një rëndësi e veçantë edhe gjatë marrjes së vendimit gjyqësor, pasi që ajo shihet si një nga provat me një fuqi të madhe në procedurë penale e sidomos në rastet kur nuk ekzistojnë prova të tjera.

Nga praktika ime si gjykatës rastin më të freskët e kam një rrahje në mes kunatave në një fshat të Strugës ku si shkak i zënkës ka qenë ofendimi i njëjës prej kunatave, drejtuar motrës së kunatës tjetër me fjalë të rënda dhe ofenduese e cila ka qenë e pranishme gjatë rrahjes së dy kunatave. Duke pasur parasysh

këtë rrethanë, vendimi gjyqësor u mbështet në dëshminë me gojë të motrës e cila ishte edhe shkaku i rrahjes së dy kunatave cila për momentin e rrahjes së kunatave kishte ndodhur aty.

5. Nga praktika juaj si gjykatës, a paraqiten raste të dëshmitarëve të cilët drejtohen në dhënien e dëshmisë së rrejshme?

Në praktikë, ka raste të shumta të cilat detektohen, ku pala tjetër ato i denoncon në Prokurori dhe nëse konstatohet e njëjta, atëherë fillohet procedurë penale ndaj atij dëshmitari për dëshmi të rrejshme i cili do të dënohet duke u bazuar në kornizat ligjore.

6. Cilat janë disa nga arsyet të cilat e shtyjnë dëshmitarin që të japë dëshmi të rrejshme?

Arsyet të cilat e shtyjnë dëshmitarin në dhënien e dëshmisë së rrejshme janë të shumta. Disa nga ato arsye mund të numërojmë gjendjen materiale të dëshmitarit, afërsin familjare, interesin personal për përfundimin pozitiv të rastit, kërcënimet mbi familjen, dinjitetin dhe personalitetin e dëshmitarit etj.

Edhe mbi këtë fenomen do të përmend një rast, ku babai me djalin bashkarisht kanë rrahur një djal nga një fshat i Strugës. Në procedurë penale, viktimë e kësaj veprë penale e mohon se ato persona e kanë rrahur atë pasi që ai kishte marrë të holla nga ato për të mos treguar të vërtetën, në mënyrë që të shfajësohen ato dhe të shpallen të pafajshëm.

7. A keni pasur raste kur për një vendim gjyqësor është marrë parasysh edhe dëshmia e rrejshme e dëshmitarit si provë në procedurë penale?

Në praktikë, e them fatkeqësisht ka raste të tilla. Për të arritur deri tek parandalimi i këtyre rasteve duhet që me kujdes të vërtetohen dhe të denoncohen me rastin e paraqitjes së dëshmive të rrejshme pasi që është shumë problem për ta verifikuar.

8. Sa është e vështirë për gjykatën, ose konkretisht për ju si gjykatës, të zbuloni se dëshmitari është duke dhënë dëshmi të rrejshme?

Reagimet e personit të cilit jep dëshmi të rrejshme në shumicën e rasteve janë të dallueshme. Për të kuptuar këtë fenomen mund të numërojmë disa metoda me të cilat zbulojmë se dëshmitari jep dëshmi të rrejshme, edhe atë:

- Nuk është serioz gjatë dhënies së dëshmisë
- Ndjehet i trembur
- Gjatë dhënies së dëshmisë vërejmë se ai dridhet
- Gjatë dhënies së dëshmisë paraqitet si person nervoz

Në këto raste, edhe avokati i palës tjetër reagon për këto fenomene me çrast ngjallen edhe dyshimet të cilat duhet që të vërtetohen.

9. A keni të shtoni diçka tjetër në lidhje me këtë çështje?

Për mua si gjykatës, për dëshmitë të cilat dëshmitari i jep gojarisht janë fakte që unë bazohem në sjelljen e vendimit gjyqësor. Këtë e bazoj në dëshmi serioze gjatë marrjes në pyetje.

Dëshmia serioze mua më lehtëson të drejtën për të marrë vendim gjyqësor dhe bazohem në atë se vendimi gjyqësor i sjellur do ti kalon të gjitha instancat gjyqësore në rast të atakimit të vendimit.

2.Intervistë me shkrim e realizuar me prokurorin Xhemal Lloga nga Prokuroria Publike në Strugë lidhur me dëshminë e dëshmitarit si provë në procedurë penale

1. Sa është e rëndësishme për ju si prokuror, dëshmia e dëshmitarit si provë në procedurë penale?

Duke u bazuar në procedurën penale, unë si prokuror publik dëshminë e dëshmitarit si provë në procedurë penale e shoh me një rëndësi të veçantë. Të gjithë provat në procedurë penale kanë rëndësi të veçantë pasi që në bazë të tyre prokurori publik e bazon edhe aktakuzën,pra në bazë të provave materiale të

cilat i paraqet prokurori publik me rastin e ngritjes së aktakuzës të cilën më pas e vlerëson gjykata.

Sa i përket dëshmitarit e sidomos dëshmitarit okular duhet pasur kujdes më të veçantë pasi që përmes të tij mund të marrim informacione më të hollësishme në lidhje me veprën penale për arsye se në mënyrë direkte e ka perceptuar ngjarjen.

2. Për cilat vepra penale, dëshmia e dëshmitarit kërkon një rëndësi më të veçantë nga ana juaj?

Nuk mund të përcaktohet në mënyrë të prerë se për cilat vepra penale dëshmia e dëshmitarit kërkon rëndësi më të veçantë, pasi që ajo është e rëndësishme në të gjithë veprat penale pasi që përmes dëshmisë së dëshmitarit e kemi më të lehtë të njohtoemi edhe me veprën penale se si ka ndodhur ajo në realitet dhe për të pasur procedurë sa më efikase.

Mirëpo, mund të themi se rëndësia më e madhe e dëshmisë së dëshmitarit vërehet në veprat penale më të rënda të përcaktuara sipas Kodit Penal të RMV-së në të cilat për të arritur deri te e vërteta është më e vështirë. Si vepra penale të tilla mund ti numërojmë vrasjet e sidomos vrasjet e rënda, vjedhjet e veçanërisht vjedhjet e rënda, mashtrimi, keqpërdorimi i detyrës zyrtare, marrja dhe dhënia e ryshfetit etj.

3. Sa është e rëndësishme dëshmia e dëshmitarit në procedurë paraprake, konkretisht në fazën e hetimit?

Rëndësia e dëshmisë së dëshmitarit vërehet në të gjithë fazat e procedurës penale. Në fazën e hetimit, dëshmia e dëshmitarit është e rëndësishme pasi që prokurori publik bie në kontakt direkt me dëshmitarin në lidhje me veprën penale për periudhë të shkurtër që nga kryerja e veprës penale deri në paraqitjen e tij në fazën e hetimit, gjë që ndikon në atë që dëshmitari atë që e ka perceptuar gjatë kryerjes së veprës penale e ka më të freskët.

Në këtë fazë, dëshmitari është më i lirë në përshkrimin e veprës penale ose të asaj që e ka perceptuar në mënyrë direkte ose dëgjuar nga personat e tjerë. Në këtë fazë edhe kontakti me dëshmitarin është më i lirë dhe dëshmia e marrë në në këtë fazë paraqet një lehtësim për gjykatën në fazat e mëtejshme të procedurës penale.

4. Nga praktika e juaj si prokuror , a paraqiten raste të shpeshta të dëshmitarëve të cilët drejtohen në dhënien e dëshmisë së rrejshme?

Duke pasur parasysh faktin se dëshmitari ka një barrë të madhe në procedurë penale, janë të shumë numërta rastet kur gjatë dhënies së dëshmisë ato drejtohen në dhënien e dëshmisë së rrejshme.

Gjatë përvojës time si Prokuror, në Prokurorinë Themelore në Strugë, ka pasur raste të shumta të dhënies së dëshmisë së rrejshme ndaj të cilëve janë shqiptuar dënime të përcaktuara sipas legjislacionit penal, me ç'rast nuk kanë munguar rastet e shqiptimit të dënimit me burgim.

5. Cila është metoda se si ju arrini të kuptoni që dëshmitari po jep dëshmi të rrejshme?

Më së shpeshti ajo kuptohet kur dëshmitari jep dëshminë në mënyrë verbale mbi çështjen penale konkrete, kurse për të njëjtën çështje si Prokuror Publik posedoj prova materiale të cilat vërtetojnë se dëshmia e dëshmitarit është në kundërshtim me faktet materiale.

Pra i gjithë kundërshtimi paraqitet në rastet kur për atë çështje penale, si Prokuror Publik kam dijeni dhe prova materiale me të cilat mund të vërtetoje se dëshmitari është duke dhënë dëshmi të rrejshme.

6. Cilët janë disa nga arsyet të cilat e shtyjnë dëshmitarin që të japë dëshmi të rrejshme?

Arsyet janë të shumta të cilat nvaren edhe nga rasti dhe vepra penale. Arsyet më të shpeshta të cilat paraqiten janë:

1. Frika
2. Kërcënimet për jetën e dëshmitarit
3. Kërcënimet drejtuar familjes së dëshmitarit
4. Rrethi familjar ose Miqësia e ngushtë
5. Marrja e të hollave me dëshirë ose me kërcënim për të dëshmuar të kundërtën etj.

7. A keni të shtoni diçka tjetër në lidhje me këtë çështje?

Të gjithë provat në procedurë penale kanë rëndësi të veçantë. Në bazë të gjithë përshkrimit mbi dëshminë e dëshmitarit në procedurë penale mund të konkludojmë se si Prokuror Publik i kushtoj rëndësi të veçantë dëshmisë së dëshmitarit pasi paraqet një provë që gjatë ngritjes së aktakuzës dhe vlerësimit nga ana e gjykatës, gjykata mund ti kushtojë rëndësi të veçantë provës së paraqitur në aktakuzë, pikërisht dëshmisë së dëshmitarit.

3. Intervistë me shkrim me gjykatës nga Departamenti për Krime të Rënda të Gjykatës Themelore në Pejë lidhur me dëshminë e dëshmitarit në procedurë penale

1. Për ju si gjykatës, sa është e rëndësishme dëshmia e dëshmitarit në procedurë penale?

Po, është e rëndësishme ngase dëshmija e dëshmitarit është njëra nga provat me të cilat mund të vërtetohet ndonjë fakt ose rrethanë.

2. Për cilat vepra penale, dëshmia e dëshmitarit kërkon një rëndësi më të veçantë?

Për të gjithë veprat penale, dëshmija e dëshmitarit kredibil, është e rëndësishme.

3. Sa ndikon dëshmia e dëshmitarit në vendimin gjyqësor të gjykatës?

Nëse dëshmitari është kredibil dhe dëshmija e tij është relevante për çështjen, atëherë dëshmija e tij është e rëndësishme për marrjen e vendimit gjyqësor.

4. A ka pasur raste kur në mungesë të provave të tjera në një procedurë penale konkrete, vendimi gjyqësor është mbështetur në bazë të dëshmisë së dëshmitarit?

Ka raste por të ralla, ngase i akuzuari nuk mund të shpallet fajtor me vetëm një provë ngase këtë ia mundëson ligji.

5. Nga praktika e juaj si gjykatës ,a paraqiten raste të shpeshta të dëshmitarëve të cilët drejtohen në dhënie të dëshmisë së rrejshme?

Ka raste, por jo të shpeshta.

6. Cilët janë disa nga arsyet të cilat e shtyjnë dëshmitarin që të japë dëshmi të rrejshme?

Arsyet janë të ndryshme, qoftë në favor të të akuzuarit ose të dëmtuarit, qoftë në disfavor të tyre.

7. A keni pasur raste kur për një vendim gjyqësor është marrë parasysh edhe dëshmia e rrejshme e dëshmitarit si provë në procedurë penale?

Jo, unë nuk kam pasur rast që ta procesoj si provë dëshminë e rrejshme në një çështje penale, poqese e kam konstatuar se është e rrejshme.

8. Sa është e vështirë për gjykatën, ose konkretisht për ju si gjykatës, të zbuloni se dëshmitari është duke dhënë dëshmi të rrejshme?

Duke u bazuar edhe në provat e tjera në lëndë, gjykata konstaton relevancën e dëshmisë së dëshmitarit.

9. A keni të shtoni diçka tjetër në lidhje me këtë çështje?

Jo nuk kam.

4.Intervistë me shkrim me gjykatësin Ervin Sulaj nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë lidhur me dëshminë e dëshmitarit në procedurë penale

1. Për ju si gjykatës, sa është e rëndësishme dëshmia e dëshmitarit në procedurë penale?

Dëshmia si një nga llojet e provave, nuk mbart në vetvete një vlerë të paracaktuar apo të mbivlerësuar, por në çdo rast vlerësohet dhe në përputhje me

provat e tjera kur ato ekzistojnë. Në rastin kur dëshmia është lloji i vetëm i provës apo dhe provë e vetme, kjo merr rëndësi të veçantë për gjykatën në lidhje me vërtetimin e faktit penal, objekt akuze.

2. Për cilat vepra penale, dëshmia e dëshmitarit kërkon një rëndësi më të veçantë?

Për veprat penale që kanë të bëjnë me krimet seksuale dhe krimet në familje, dëshmia e dëshmitarit paraqet një rëndësi të veçantë në provimin e faktit penal, duke u nisur nga vetë natyra e këtyre veprave dhe vështirësia e provueshmërisë së tyre.

3. Sa ndikon dëshmia e dëshmitarit në vendimin gjyqësor të gjykatës?

Dëshmia e dëshmitarit, siç u theksua më lart, si një nga llojet e provave, paraqet të njëjtën rëndësi për vendimarrjen e gjykatës, duke pasur një ndikim të barabartë me provat e tjera të administruara në gjykim dhe duke u vlerësuar në përputhje këto të fundit. Për krimet seksuale dhe krimet në familje, ajo paraqet një rëndësi më të veçantë në vendimarrjen e gjykatës.

4. A ka pasur raste kur në mungesë të provave të tjera në një procedurë penale konkrete, vendimi gjyqësor është mbështetur në bazë të dëshmisë së dëshmitarit?

Në përvojën time si gjyqtar, kam pasur raste kur në një çështje penale konkrete, vendimin gjyqësor është bazuar në provën me dëshmitar.

5. Nga praktika e juaj si gjykatës, a paraqiten raste të shpeshta të dëshmitarëve të cilët drejtohen në dhënien të dëshmisë së rrejshme?

Në përvojën time si gjyqtar, nuk kam hasur raste të tilla.

6. Cilët janë disa nga arsyet të cilat e shtyjnë dëshmitarin që të japë dëshmi të rrejshme?

Arsyet të cilat mund të shyjnë një dëshmitar që të japë një dëshmi të rreme janë të ndryshme, si frika, kanosja, dhuna, interesi pasuror ose interesa tjera.

7. A keni pasur raste kur për një vendim gjyqësor është marrë parasysh edhe dëshmia e rrejshme e dëshmitarit si provë në procedurë penale?

Në përvojën time si gjyqtar, nuk kam pasur rast të tillë.

8. Sa është e vështirë për gjykatën, ose konkretisht për ju si gjykatës, të zbuloni se dëshmitari është duke dhënë dëshmi të rrejshme?

Zbulimi i rastit kur kemi të bëjmë me dëshmi të rreme, nuk paraqet ndonjë vështirësi të veçantë për gjyqtarin, kjo si pasojë e përvojës së krijuar në marrjen e dëshmisë, lidhjes së dëshmisë me provat e tjera të marra në shqyrtim dhe mënyrës së ndërtimit të pyetjeve drejtuar dëshmitarit, të cilat të bëra në mënyrën e duhur, arrijnë të nxjerrin në pah rrsatin kur dëshmitari bën dëshmi të rreme.

9. A keni të shtoni diçka tjetër në lidhje me këtë çështje?

Prova me dëshmitar përbën një nga llojet kryesore të provave në gjykimin e çështjeve penale, sidomos për veprat penale që kanë të bëjnë me krimet seksuale dhe krimet në familje apo edhe krime të tjera, të cilat për vetë natyrën që kanë, paraqesin vështirësi në provueshmërinë e tyre dhe për këtë arsye gjykata duhet t'i kushtojë një vëmendje të veçantë marrjes së kësaj prove dhe përdorimin e saj për të bazuar vendimarrjen gjyqësore

PËRFUNDIM

Dëshmia e dëshmitarit si provë me peshë shumë të rëndësishme paraqet njërën nga provat e cila kërkon hulumtime dhe studime të hollësishme. Dëshmia e dëshmitarit në procedurë penale kërkon një analizë shumë të gjerë për të arritur një përfundim pozitiv për pozitën e favorshme të cilën e ka dëshmitari në procedurë penale. Edhe përkundrejt faktit që e njëjta trajtohet si një fenomen mjaftë i analizuar, por edhe në ditët e sotme vërejmë që ende dhe ndoshta kurrë nuk do të jetë i mjaftueshëm studimi dhe analizimi i dëshmisë së dëshmitarit në procedurë penale dhe sidomos studimi dhe analizimi i saj edhe në aspekt krahasues.

Në këtë punim dëshmia e dëshmitarit nuk është studiuar dhe analizuar vetëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut, por kjo çështje është analizuar dhe studiuar edhe në Republikën e Shqipërisë dhe në Republikën e Kosovës. Zgjerimi i studimit dhe analizimit të dëshmisë së dëshmitarit në procedurë penale edhe në vendet tjera si në Shqipëri dhe Kosovë, këtë punim shkencor e bën që të veçohet nga punimet e punuara më parë.

Pasqyrë më të qartë mbi çështjen e dëshmisë së dëshmitarit si provë në procedurë penale arritëm të përfitojmë përmes vështrimit historik nga studimi dhe analizimi i kësaj çështjeje duke u bazuar në shekujt e kaluar, me ç'rast arritëm të konkludojmë se në shekujt e kaluar dëshmitarin nuk është se e kanë parë me një sy pozitiv dhe nuk është se i kanë dhënë shumë përparësi për të arritur tek e vërteta, ku ndaj tyre nuk kanë munguar edhe rastet kur fatkeqësisht është përdorur edhe dhunë fizike dhe psikike.

Me kalimin e shekujve, në bazë të analizave dhe studimeve, vërtetojmë se dëshmitari ka filluar të shihet me një sy krejt ndryshe nga ai i shekujve të kaluar. Tani më dëshmitarin në procedurë penale, konkretisht në procedurën provuese, e shohin si një provë shumë të rëndësishme nga i cili mund të varet edhe fati i vazhdimit të procesit penal. Në procedurë penale respektohet plotësisht dinjiteti dhe personaliteti i dëshmitarit dhe as që vjen në pyetje përdorimi i dhunës fizike dhe psikike për të arritur deri tek dhënia e dëshmisë nga ana e dëshmitarit.

Përgjatë studimit dhe analizimit të materialeve të cilat mbulojnë çështjen e dëshmisë së dëshmitarit në procedurë penale, edhe atë si pika më të rëndësishme siç janë: nocioni i dëshmitarit, nocioni i dëshmisë së dëshmitarit, kushteve të cilat duhet të plotësohen për tu paraqitur në cilësinë e dëshmitarit, llojeve të dëshmitarëve, cilësive të dëshmitarëve, thirrjes dhe metodës së marrjes në pyetje të dëshmitarëve, mbrojtjes së dëshmitarëve të rrezikuar, si dhe pikave të tjera të përfshira në këtë punim shkencor, arritëm të konkludojmë se dëshmia e dëshmitarit në procedurë penale në Republikën e Maqedonisë së Veriut paraqet ekskluzivisht provë me vlerë shumë të fuqishme e cila duhet me kujdesin më të madh të analizohet nga ana e trupit gjykues, ngaqë në përfundim të procesit penal dëshmia e dëshmitarit mund të përcaktojë fatin e vendimit gjyqësor dhe ai vendim gjyqësor të mbështetet plotësisht në atë provë.

Këto çështje janë studiuar dhe analizuar edhe në vendet fqinje të vendit tonë, siç janë Shqipëria dhe Kosova, ku nga analizat dhe studimet të cilat i kam realizuar në literaturat e këtyre vendeve mbi çështjet më të rëndësishme, siç janë: nocioni i dëshmitarit, nocioni i dëshmisë së dëshmitarit, kushteve të cilat duhet të plotësohen për tu paraqitur në cilësinë e dëshmitarit, llojeve të dëshmitarëve, cilësive të dëshmitarëve, thirrjes dhe metodës së marrjes

në pyetje të dëshmitarëve, mbrojtjes së dëshmitarëve të rrezikuar, si dhe pikave të tjera të përfshira në këtë punim shkencor, arritëm të konkludojmë se edhe në këto vende nuk anashkalohet dëshmia e dëshmitarit si provë në procedurë penale, por çdoherë shihet dhe kërkohet mundësia e paraqitjes së dëshmitarit në procedurë penale për të dëshmuar dhe për të dhënë pasqyrë më të qartë rreth çështjes penale konkrete, sepse kjo provë paraqet edhe një lehtësim për gjykatën në marrjen e vendimit të drejtë dhe objektiv pa mos u dëmtuar asnjëra palë në procedurë penale.

Nga këto analizime dhe studime, si dhe duke pasur parasysh edhe aspektin krahasues e cila është edhe çështje e këtij punimi shkencor, duke analizuar dëshminë e dëshmitarit në procedurat penale të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës arritëm të konkludojmë se përcaktimi i dëshmisë së dëshmitarit në procedurat penale të këtyre vendeve është plotësisht i njëjtë duke u bazuar në të gjitha çështjet e lartpërmednura dhe të numëruara taksativisht në punimin shkencor, duke ardhur në përfundim se në të tri legjislacionet penale rëndësia e dëshmisë së dëshmitarit është në radhë të parë gjatë procesit të të provuarit.

E gjithë kjo ndodh edhe për arsye se ndodhemi në një vijë fqinjësore me këto vende në të cilat mund të themi se jemi në vijë të barabartë përsa i përket aspekteve të ndryshme si asaj ekonomik, aspektit të drejtësisë, aspektit të funksionimit të shtetit si dhe shumë aspekteve të tjera, me ç'rast edhe legjislacionet si në sferën civile ashu edhe në atë penale janë të harmonizuara në mes këtyre tri vendeve dhe për këtë arsye mund të themi se bëhet fjalë për legjislacion penal të ngjashëm në mes këtyre tri vendeve.

Rëndësia e dëshmisë së dëshmitarit në procedurë penale është analizuar edhe në këndvështrim tjetër e jo vetëm duke analizuar dhe studiuar literaturën e këtyre vendeve, mirëpo ajo është analizuar edhe në aspektin praktik, duke shprehur mendimet dhe përvojat e tyre edhe personat të cilët drejtpërsëdrejti merren me mbarëvajtjen e këtij procesi, pra personat të cilët analizojnë dëshminë e dëshmitarit në procedurë penale, siç janë gjykatësit dhe prokurorët.

Përmes tyre arritëm të marrim informata më të sakta rreth kësaj çështjeje, sepse ato në mënyrë të drejtpërdrejtë bien në kontakt direkt me dëshmitarët dhe janë persona zyrtarë të cilët duhet të bëjnë analizimin e dëshmimeve të dëshmitarëve.

Për të pasur një punim sa më cilësor dhe pasqyrë më të qartë sa i përket aspektit praktik të kësaj çështjeje, në pjesën e IV të këtij punimi shkencor kam përgatitur disa dëshmi të dëshmitarëve nga praktika si dhe intervista me shkrim me prokurorë dhe gjykatës nga të cilët në mënyrë shumë të qartë kam arritur të përfitoj informacione të rëndësishme përsa i përket temës të cilën unë e kam shtjelluar.

Nga intervistat të cilat i kam realizuar me prokurorë dhe gjykatës kam arritur në përfundim se dëshmia e dëshmitarit në procedurë penale është e pashmangshme. Pra, kësaj çështjeje i kam ardhur në përfundim jo vetëm përmes analizimit dhe studimit të materialeve dhe literaturës, por edhe përmes intervistave të realizuara. Secili prej të intervistuarve dëshmitarit i kushtonte rëndësi të veçantë, sepse është e vetmja provë e cila drejtpërsëdrejti bie në kontakt me ndodhinë dhe përmes perceptimit të tij e vëren të gjithë ndodhinë, më pas në formë gojore që është më e përshtatshme për prokurorët dhe gjykatësit, dëshmitari e deklaroi përpara trupit gjykues.

Këtë çështje në mënyrë të qartë gjatë intervistës me shkrim e ka ilustruar edhe gjykatësi nga Gjykata Themelore në Strugë, i nderuari z.Adi Useini i cili në formë shumë praktike dhe përmes shembujve të paraqitur në intervistë e vërteton rëndësinë e dëshmisë së dëshmitarit rreth një rasti konkret kur nuk ka pasur fakte dhe prova të tjera, dëshmia e dëshmitares ka qenë provë përfundimtare përmes së cilës ka marrë epilog procedura penale. Duke pasur parasysh se procedura penale paraqet një procedurë shumë të vështirë për të ardhur deri tek e vërteta dhe sjellja e një vendimi gjyqësor të drejtë dhe objektiv, nga ky punim shkencor mund të nxjerrim edhe kritika drejtuar dëshmitarëve të cilët për arsye të ndryshme drejtohen në dhënien e dëshmive të rrejshme, fenomen i cili ndikon në zvarritjen e procedurës penale dhe mosarritjen e qëllimit të duhur të procedurës penale.

Ne si qytetarë të këtij vendi e kemi për obligim dhe detyrë të dëshmojmë të vërtetën, të vetëdijësohemi dhe të jemi ata të cilët do të kontribuojmë për arritjen e drejtësisë në vend, të luftojmë çdo veprim të kundërligjshëm i cili dëmton njerëzit e pafajshëm, çdo veprim që dëmton arritjen e së vërtetës në procedurë penale, çdo veprim i cili dëmton funksionimin e shtetit dhe funksionimin e drejtësisë.

Drejtësia jemi ne...Të dëshmojmë të vërtetën, që të mos dëmtojmë askënd.

LITERATURA

- E.Sahiti&I.Zejneli, E drejta e procedurës penale e R.Maqedonisë, Shkup, 2018
- E.Sahiti&I.Zejneli, E drejta e procedurës penale e R.Maqedonisë, Shkup, 2017
- E.Sahiti&I.Zejneli, E drejta e procedurës penale e R.Maqedonisë, Shkup, 2007
- V.Kambovski&I.Zejneli, E drejta penale (pjesa e pergjithshme) Tetovë, 2018
- E.Sahiti, E Drejta e Procedurës Penale, Prishtinë, 2005
- E.Sahiti, Argumentimi në Procedurën Penale, Prishtinë, 2006
- E.Sahiti, Argumentimi në Procedurën Penale, Prishtinë, 1999
- E.Sahiti, Dëshmia e dëshmitarit si prove në Procedurë Penale,Prishtinë,1993
- E.Sahiti, Psikologjia gjyqësore, Prishtinë 2007
- A.Hajdari, Procedura Penale Komentar, Prishtinë,2010
- I.Salihi, E drejta penale- Pjesa e posaçme, Prishtinë, 2009
- I.Zejneli, E drejta penale- Pjesa e posaçme, Tetovë, 2007
- V.Latifi, Kriminalistika, Prishtinë 2014
- R.Halili, Penologjia, Prishtine, 2014
- R. Halili, Kriminologji me penologji, Prishtinë, 1995
- A. Luarasi, Kodi I Procedurës Penale, Tiranë, 2005
- H.Islami,A.Hoxha,I.Panda, Proecedura Penale ,Tiranë 2010
- I.Elezi,S.Kaçupi,M.R.Haxhia, Komentari i K.Penal të Republikës së Shqipërisë,Tiranë 2004
- H.Islami,A.Hoxha,I.Panda , Procedura penale, Tiranë 2010
- E.Sahiti,R.Murati, E Drejta e Procedurës Penale, Prishtinë 2016
- J.Shasivari, E drejta kushtetuese, Shkup, 2015.
- H.Ismaili,F.Sejdiu, Historia e Institucioneve Juridike dhe Shtetërore, Prishtinë , 2009

-I.Zejneli, Delikuenca e Të Miturve, Tetovë/Prishtinë 2018

-M.Škulić,E drejta e procedurës penale, Sërbi 2009,fq.231

BURIME TJERA

-Kodi I Procedurës Penale, Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare, Tetor 2011

-Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr. 37, Prishtinë 2013

-Kodi i Drejtësisë Penale Për të Mitur, Tiranë 2017

-Salihu, Ismet, Zhitia, Hilmi, Hasani, Fejzullah, Komentari i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, botimi i parë, Prishtinë, mars 2014.

-Osmani, Afrim, Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë, (Teksti integral, i përpunuar në gjuhën shqipe me udhëzime dhe sqarime, treguesi alfabetik) Shkup, 2010.

-Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë, Botimi i Qendrës së Botimeve Zyrtare,Tiranë 2002

-Ligji I Procedurës Penale,gazeta zyrtare e RMV nr 150,prej 18.11.2011

-Ligji për Prokurorinë Publike i Republikës së Maqedonisë, “Gazeta Zyrtare e RM-së”, nr.111, datë 03.09.2008.

-Ligji për Gjykatat i Republikës së Maqedonisë, “Gazeta Zyrtare e RM-së”, nr.58/2006, 35/2008, 15/10, 83/18, dhe 198/18, datë 17.05.2019.

-G.Kalajdziev,G.Lazetic,L.Nedelkova,M.Denkovska,M.Trombeva,T.Vitlarov,P. Jankulovska,D.Kadiev

-<http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2018/09/DOKTORATURA-BESIANA-PETANAJ-MUKA.pdf>

-Katerina Kolarevic, Zbatimi praktik i ligjit për procedurën penale, Marrja në pyetje e dëshmitarëve dhe ekspertëve në procedurat penale, Shkup.

-<https://www.scribd.com/doc/300046866/Akademija-ZKP-Modul-3-Priracnik-Glavna-Rasprava>

- http://www.pp.gov.al/web/kodi_i_procedures_penale_date_30_gusht_2017_1201.
- http://www.gjykataelarte.gov.al/web/ligj_per_gjykatën_e_krimeve_te_renda_21.
- http://oak-ks.org/repository/docs/Udhezues_i_Kodit_te_Procedures_Penale_976264.pdf
- http://www.pp.gov.al/web/kodi_proc_penale_202.pdf
- Ligji për Drejtësinë e Fëmijëve, Shkup 2014
- <https://www.riku.fi/en/guides-and-instructions/instructions-for-the-witness-of-a-criminal-case/>
- https://en.wikipedia.org/wiki/United_States_criminal_procedure
- <https://www.mekulipress.com/disa-karakteristika-te-sistemit-juridik-anglez-me-theks-te-vecante-e-drejta-procedures-penale/>